



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME

Bashkitë në procesin e integrit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian

**Raporti i vlerësimit
për vitin 2020**



TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE	13
-KAPITULLI 1- KRITERI POLITIK	15
1.1 Demokracia	15
1.1.1 Qeverisja	15
1.1.2 Administrata Publike	22
1.1.3 Avokati i Popullit	30
1.1.4 Shoqëria civile	31
1.2 Shteti i së drejtës	34
1.2.1 Lufta kundër korrupsionit.....	34
1.3 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave	39
-KAPITULLI 2- KRITERI EKONOMIK	42
2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale	42
-KAPITULLI 3- AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT	46
3.1 Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural	46
3.2 Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare	53
3.3 Kapitulli 14: Politika e transportit	57
3.4 Kapitulli 15: Energjia	64
3.5 Kapitulli 16: Taksat	67
3.6 Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi	72
3.7 Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë.....	79
3.8 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore	81
3.9 Kapitulli 24: Drejtësia, Liria dhe Siguria	95
3.10 Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura	99
3.11 Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës.....	105
3.12 Kapitulli 32: Kontrolli financiar	116

Shkurtime

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri
PV	Plan Veprimi
RV	Raport Vjetor
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AMVV	Agjencia për Mbështetjen Vetëqeverisjes Vendore
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
NjA	Njësi Administrative
BE	Bashkimi Evropian
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
KK	Këshilli Konsultativ për vetë-Qeverisjen Vendore
KM	Këshilli i Ministrave
KE	Komisioni Evropian
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020
DPPS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale
ILKPKDI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të nteresave
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
NjQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
PKVIRE	Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane 2016-2020

PVIRE	Plani Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane
QQ	Qeveria Qëndrore
QV	Qeveria Vendore
MB	Ministria e Brendshme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTE	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
PVMIM	Plan Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve
RAP	Reforma e Administratës Publike
SNDQV	Strategjia Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2015-2020
SKEE	Strategjia Kombëtare për Efiçencën Energjisë
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022
ZIN	Qendra e Integruar me një Ndalesë
SSC	Sistemi i Sigurimit të Cilësisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asocimit
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
RAT	Reforma Administrative Territoriale
SZHAP	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020
GP	Grup Pune
SHBSH	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
SHAV	Shoqata për Autonominë Vendore

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i katërt i vlerësimit kombëtar të performancës të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore përfshin arritjet, problemet dhe sfidat në ushtrimin e funksioneve dhe aktiviteteve të bashkive gjatë vitit 2020, si dhe progresin në zbatimin e politikave sektoriale dhe detyrimeve që rrjedhin në kuadër të zbatimit të axhendës së integritimit evropian, në nivel vendor, në fushat kryesore të cilat lidhen me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe aftësinë për të realizuar detyrimet e anëtarësimit. ¶ Raporti i tretë i Performancës së bashkive për vitin 2019 u prezantua dhe diskutua për herë të parë në takimin e Këshillit Konsultativ në 29 Shtator 2020 si edhe në takime me administratën e bashkive, të zgjedhur vendorë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile në bashkitë e vendit.

KRITERI POLITIK

Demokracia

Përpjekje janë bërë për të përmirësuar koordinimin dhe procesin e konsultimit në Këshillin Konsultativ të projektakteve ligjore që impaktojnë vetëqeverisjen vendore në tre drejtime kryesore të lidhura me konsultimin e projektakteve ligjore, zbatimin e urdhrit të Kryeministrit (nr. 101/2019) “Për hartimin e akteve nënligjore nga ministritë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara të njësive të vetëqeverisjes vendore”, dhe zbatimin e matricës së kompetencave të vetëqeverisjes vendore. Në gjashtë (6) takimet e KK në 2020, janë diskutuar më pak projektakte ligjore kundrejt vitit 2019, gjithsej 36, nga të cilat janë miratuar 23 projektakte ligjore. Shkalla e përfaqësimit të institucioneve qendrore ka qenë më e ulët në takimet e KK.

Përpjekje institucionale dhe ndërveprim më i mirë rekomandohet në drejtim të inicimit më të hershëm të ndryshimeve ligjore për rritje cilësore të procesit të konsultimit të projektakteve ligjore midis institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore, fuqizim të kapaciteteve njerëzore të Sekretariatit të KK, dhe rritja e shkallës së përfaqësimit të institucioneve të qeverisjes qendrore në takimet e KK¹.

Progres është bërë në zgjerimin e kuadrit ligjor për shërbimet e dixhitalizuara dhe thjeshtëzimin e dokumentacionit dhe procedurave të punës; 6 qendra të integruara të reja të Zyrave me Një

Ndalesë (ZNjN) u hapën në 2020, ndërsa numri i shërbimeve të qeverisë qendrore dhe vendore me ndërveprim të përmirësuar u rrit në 820 (48% më shumë krahasuar me 2019). Gjithsej 59 ZNjN ishin funksionale në fund të vitit 2020 krahasuar me 41 qendra funksionale në 2019, të cilat mundësuan rritjen e shkallës dhe të numrit të qytetarëve që morrën shërbime në 2020.

Sfidë për zgjerimin e sistemit të ZNjN është sigurimi i ambienteve të përshtatshme në bashkitë dhe investimet e duhura dhe vijimi i trajnimit të stafit për ZNjN, hartimi i një plani të përgjithshëm për shtrirjen e shërbimeve dhe vendosja e standarteve minimale të shërbimeve publike të ofruara nga qendrat e integruara më një ndalesë², si dhe forcimi i rolit mbikqyrës të ADISA-s për të siguruar që institucionet qeveritare të jenë në përputhje me kërkesat dhe standartet e cilësisë së shërbimit publike³.

Administrata publike

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në lidhje me reformën në administratën publike. Është zhvilluar më tej kuadri ligjor për përmirësimin e ndërveprimit midis institucioneve publike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore nëpërmjet platformës “administrata.al”, klasifikimin e pozicioneve të punës dhe përshkrimeve të punës dhe procesin e monitorimit për zbatimin e legjislacionit të SHC, si dhe është

1 Raport vjetor i KK për v.2020
2 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)
3 Raport Monitorimi për v.2020 (ADISA)

miratuar pashaporta e treguesve për zbatimin e reformës në administratën publike me kontributin e Departamentit të Administratës Publike (DAP). Sistemi digjital për menaxhimin e burimeve njerëzore HRMIS ende nuk po përdoret nga të gjitha bashkitë. Aktualisht raportohet përdormi vetëm nga rreth 50% e bashkive, duke shënuar rënie edhe kundrejt vitit 2019.

Largimet nga administrata vendore vazhdojnë të mbeten një shqetësim i ndjeshëm për sigurimin e një administrate të qëndrueshme. Shkalla e largimeve të nëpunësve vendorë ka qenë rreth 13% në 2020 (ose 1941 të larguar) për arsye të ndryshme.

Shkalla mesatare e përfaqësimit të femrave në cilësinë e nën. kryetarit të bashkisë u rrit në 2020, në 46% (nga 34.9% në 2019), ndërsa përfaqësimi i femrave në pozicione menaxhuese vazhdon të mbetet e ulët. Rreth 22% të pozicioneve drejtuese në bashki raportohet të jenë qenë femra.

Përmirësimi i sistemit të trajnimeve të ASPA ka vijuar me hartimin e metodologjisë së e-kurrikulës, draft strategjisë së ASPA dhe procesin për akreditimin e kurrikulave të trajnimit. Gjithashtu, në 2020 përfundoi trajnimi për trupën e lartë drejtuese⁴. Bashkitë kanë ndjekur 776 programe trajnimi të organizuara nga ASPA (6132 nëpunës vendorë të trajnuar⁵), nga të cilët 312 nëpunës të trajnuar në fushën e legjislacionit të nëpunësit civil. Më shumë fonde të buxhetit vendor janë përdorur për trajnime në 2020 (mesatarisht 1% e buxhetit vendor kundrejt 0.39 % per vitin 2019).

Pavarësisht progresit të administratës vendore, më shumë duhet të bëhet për zbatimin e ligjit të shërbimit civil në nivel vendor, përmirësimin e transparencës për mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore ndërmjet nivelit të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike nga NJVV⁶.

Bashkitë kanë bërë progres të mëtjeshëm lidhur me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen vendore dhe përmirësimin e transparencës së financave vendore. Ndërsa numri i dëgjesave publike në procesin e përgatitjes së buxhetit, gjatë 2020, ka qenë 906 (85% më i lartë krahasuar me vitin 2019), numri i pjesëmarrësve në dëgjesat ka qenë më vogël, rreth 6887 qytetarë. NJVV kanë hartuar dhe dorëzuar në MFE raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit (RMZB) në zbatim të kërkesave të legjislacionit. Rreth 87% e bashkive kanë publikuar buxhetin e bashkisë në faqen zyrtare të bashkisë, dhe 82% e tyre kanë publikuar edhe në faqen ‘financatvendore.al’.

Kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërf-

shirëse ka nevojë për forcim të mëtjeshëm. Zbatimi në nivel vendor i ligjit “Për konsultimin publik” mbetet i pakënaqshëm⁷. Kërkohej forcimi i kapaciteteve institucionale në drejtim të monitorimit dhe raportimit mbi bazë të rezultateve/treguesve si pjesë e raportimeve për ekzekutimin e buxhetit vendor dhe ngritja e një strukture për monitorimin e performancës për fusha të ndryshme, mbi bazën e një modeli të njëjtë për të gjitha bashkitë, në kuadër të zbatimit të PV 2020-2022 SNDQV⁸.

Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për informacion dhe ankesave të tyre si pjesë e forcimit të llogaridhënies së pushtetit vendor ka ulje gjatë 2020. Shkalla mesatare e kthim-përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve ka qenë më e vogël (81% kundrejt 93% në 2019), ndërsa publikimi i akteve vendimmarrëse ka qenë në rritje – mesatarisht 71% kundrejt nivelit 64% në 2019. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka trajtuar 28 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor, të cilat lidheshin me mungesën e dhënies së shërbimeve të nevojshme ndaj individëve të ndryshëm (kryesisht ndaj komuniteteve dhe shtresave vulnerabël). Në 2020, vihet re zgjerim të shtrirjes gjeografike të ankesave me pretendim diskriminimin, të paraqitura pranë KMD.

E drejta e qytetarëve për administrim të mirë është e kufizuar. Institucionet publike nuk zbatojnë në mënyrë sistematike rekomandimet e organeve të mbikëqyrjes. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të ketë kompetenca më të mëdha mbikëqyrjeje. Ekziston një regjistër qendror për kërkesat për informacion, por mbulimi i tij duhet të zgjerohet⁹.

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), ka ndërmarrë veprime lidhur me procesin e hedhjes së të dhënave për rekomandimet e adresuara dhe përditësimin e tyre në kohë reale drejtuar institucioneve të pushtetit ekzekutiv, organeve në nivel qendror dhe vendor në platformën ndërinstitucionale të publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë. Në 2020, AP ka trajtuar 520 kërkesa që lidhen me institucionet e qeverisjes vendore (që përbëjnë 30% të numrit total të ankesave të marra nga ky institucion) në fushat e të drejtës së pronësisë, strehimit, papunësia dhe ankesa që lidhen me problematika si rezultat i situatave të krijuara nga pandemia, nga të cilat 71% e tyre janë adresuar sipas rekomandimeve të institucionit të këtij institucioni. . Nevojitet forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel vendor me synim trajtimin ligjor të rekomandimeve të paraqitura nga Avokatit i Popullit dhe ngritja e një mekanizmi raportimi transparent në nivel vendor nëpërmjet një sistemi të unifikuar on-line për të siguruar mbledhjen e informacionit të

4 Raporti Vjetor DAP 2020

5 Burim: ASPA Raport Progresi PV 2020-2022 SNDQV (MB, 2021)

6 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)

7 Raporti i Progresit I KE për Shqipërinë (2020)

8 Raport Monitorimi PV 2020-2022 SNDQV (MB, 2021)

9 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë 2020

saktë dhe të detajuar nga bashkitë mbi raportet/rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit për NJVV.

Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor mbetet një sfidë. Pavarësisht sfidave për shkak të situatës së pandemisë, OSHC kanë qenë aktive për monitorimin e kuadrit ligjor për të drejtat themelore dhe lirinë e qytetarëve dhe kanë ofruar mbështetje për NJVV për identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes për familjet dhe komunitetet në nevojë. Financimi për OSHC ka qenë rreth 40% më i vogël¹⁰. OSHC kanë ofruar rreth 320 rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes vendore në 2020 (18% më shumë rekomandime krahasuar me 2019), nga të cilat 50% janë marra në shqyrtim. Më pak grante të ofruara nga NJVV për projekte në partneritet me OSHC – gjithsej 59 grante (ose 12 grante më pak se në vitin 2019).

Lidhur me ndryshimet ligjore të inicuar dhe miratuara gjatë vitit 2020¹¹, kërkohet një process konsultimi më i plotë me shoqërinë civile^{10,12}, si dhe angazhim më i madh në zbatimin e plan veprimt të 'Road Map' për politikën e qeverisë për shoqërinë civile⁹. Miratimi i ligjit të prokurimit publik (162/2020) rrit mundësinë e angazhimit të OSHC në ofrimin e shërbimeve në fushën sociale. Lidhur me këtë, rekomandohet të rriten kapacitetet dhe aftësitë e OSHC për prokurimin e shërbimeve sociale siç parashikohen në ligj.

Lufta kundër korrupsionit

Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj Korrupsionit si dhe në zbatimin e kuadrit strategjik dhe ligjor në këtë fushë. Progres është bërë në ngritjen e strukturave për zbatimin e masave antikorrupsion. Në 2020 emërimi i nëpunësit publik, në kapacitetin e koordinatorit vendor anti-korrupsion në zbatim të Planit të Veprimt në luftën kundër korrupsionit, është kryer nga 62% e bashkive. Progres i kufizuar është bërë në forcimin e kapaciteteve të punonjësve të bashkive për çështjet antikorrupsion përmes shtimit të trajnimeve dhe numrit të punonjësve të trajnuar. Në 2020, kanë ndjekur trajnime në fushën e anti-korrupsioni vetëm 42% e bashkive. Miratimi i Planeve të Integritetit në të gjitha Bashkitë si dhe sigurimi i trajnimeve të dedikuara për çështjet antikorrupsion janë elementët kyç për një efikasitet më të lartë të luftës ndaj korrupsionit në nivel vendor.

Është rritur besimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve ndaj transparencës së bashkive në marrjen e vendimeve. Kjo reflektohet në numrin në rritje të ankesave nga biznesi e qytetarët për shkelje të procedurave. Në vitin 2020 janë regjistruar katër herë më shumë ankesa se në 2019. Me po të njëjtin trend pozitiv ka vazhduar deklarimi i konfliktit të interesit nga punonjësit e Bashkisë një proces i cili vlerësohet si tejet i rëndësishëm për parandalimin e rasteve korruptive në menaxhimin e fondeve

publike.

Ngritja dhe bërja funksional i Regjistrin Elektronik të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve të Bashkive ka vijuar me ritme të kënaqshme. Në 2020, numri i Bashkive që kanë ngritur regjistrin elektronik ka një rritje me 59%. Por duhet të theksohet se në 2020 vetëm 50% e bashkive kanë përditësuar periodikisht regjistrin elektronik. Sigurimi i financimeve për ngritjen e regjistrin elektronik dhe trajnimi i stafeve për përdorimin e tij mbetet prioritet.

Të drejtat e njeriut

Progres i limituar është bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të nëpunësve vendor mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Vetëm 36% e bashkive kanë përfutur trajnime në vitin 2020 për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë vendorë për zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut. Numri i trajnimeve për nëpunësit e administratës vendore për aspekte të mbrotjes së të drejtave të njeriut ka ardhur në ulje nga viti 2018, në një kohë kur rastet për shkelje të drejtave të njeriut kanë ardhur në rritje. Ka patur një rritje të theksuar të rasteve të trajtuara por edhe të referuara në nivel vendor në vitin 2020 dhe kryesisht në bashkitë e vogla si Kamëz, Maliq, Kavajë. Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në 2020 janë referuar 3.5 herë më shumë se numri i referuar në vitin 2019. Roli i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të ngritura në nivel vendor ka ardhur në rritje po ashtu edhe bashkëpunimi me strukturat e policisë, institucionet e tjera vendore si ato arsimore dhe organizatat e Shoqërisë Civile. Në 2020 janë raportuar 487 raste të bashkëpunimit me OSHC.

KRITERI EKONOMIK

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Gjatë vitit 2020 ekonomia e vendit dhe bizneset kanë ndjerë efektet e krijuara nga Pandemia COVID 19. Si rrjedhojë edhe puna e bashkive është orientuar në marrjen e masave për të zvogëluar impaktin negativ tek bizneset përmes lehtësirave fiskale të ofruara në një numër të madh të bashkive. Kjo situatë solli ulje të të ardhurave të bashkive dhe kufizime në ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e bizneseve apo dhënien e financimeve.

Në vitin 2020 është shënuar një rritje e ndjeshme në numrin e rekomandimeve të dhëna nga bashkitë në ndihmë të bizneseve të vogla dhe të mesme, me një total prej 642 rekomandime nga 110 rekomandime në vitin 2019. Hapja e bizneseve të reja ka vazhduar me ritme të kënaqshme edhe gjatë vitit 2020 pavarësisht situatës së pandemisë e cila në mënyrë të pashmangshme shkaktoi mbylljen e një numri të konsiderueshëm të bizneseve në disa bashki të vendit. Në vitin 2020, është raportuar kri-

10 Raport "Matrica e monitorimit për një mjedis aftësues për zhvillimin e shoqërisë civile", raport kombëtar (Partnerë për Zhvillim dhe Ndryshim, Qendra Kombëtare Burimore për SHC, Rrjeti I Zhvillimit të SHC të Ballkanit, 2021)

11 Ligj 112/2020 "Për regjistrimin e pronarëve përfitues, Ligj nr.154/2020 për regjistrin kombëtar të llogarive bankare dhe draft ligj për regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse (regjistrimi elektronik)

12

jimi i 10,842 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme kryesisht në bashki të mëdha si Bashkia e Tiranës, Shkodër e Elbasan por edhe në Bashkitë me aktivitet turistik si Bashkitë e Durrësit dhe Sarandës.

AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Përpjekje janë bërë për të plotësuar më tej bazën ligjore për bujqësinë dhe zhvillimin rural, vendimi/dhe udhëzimi mbi masat mbështetëse të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, vkm për miratimin e draftligjit “Për vreshtarinë dhe verën“, për kultivimin, grumbullimin, përpunimin, prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të produkteve të tij”, për regjistrin e fermës dhe Plani Strategjik për Ekstensionin bujqësor.

Shërbimi këshillimor i fermave ka ofruar trajnime dhe disa produkte që përmirësojnë produktivitetin në bujqësi, por shërbimit i mungon një strategji e qartë e miratuar për të përfunduar reformën. Fondi i alokuar për bujqësinë nga NJVV, në 2020, ka qenë më i vogël kundrejt vitit 2019. Përmirësim ka patur lidhur me menaxhimin e sistemit të rrjetit të ujitjes dhe kullimit kundrejt 2019, si rrjedhojë është rritur shkalla e mbulimit të sipërfaqes së tokës bujqësore me ujitje (vlera mesatare e mbulimit raportohet 42% në 2020. Pavarësisht progresit të lehtë në krijimin e grupeve GVV (LAG), vetëm 30% e bashkive kanë ngritur strukturat. Rregjistrimi i titujve të pronësisë (AMTP) është i vonuar kundrejt planifikimit por miratimi i Ligj nr.20/2020¹³ pritet të përmirësojë rezultatet.

Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Progres është bërë lidhur me zbatimin e masave për mbrojtjen e konsumatorëve, sigurinë ushqimore dhe veterinare dhe regjistrin e kafshëve¹⁴. Është zhvilluar më tej kuadri ligjor (ligj për veterinarinë, i ndryshuar dhe ligj “Për ushqimin¹⁵). Në 2020 u kontraktuan 293 veterinerë zyrtarë¹⁶ me fonde të qeverisë, ndërsa zyra për mbrojtjen e konsumatorëve në bashki është ngritur nga 27 bashki (44%) dhe numri i punonjësve ka qenë 187, në nivel vendor.

Lidhur me monitorimin dhe inspektimin nga strukturat e AKU në 2020, janë kryer rreth 164,260 kontrole dhe monitorime në fermat e kafshëve të gjalla si dhe kontrole në farmacitë veterinare dhe depot farmaceutike, dhe 65,604 monitorime në tregje

të tjera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit¹⁷, ndërsa bashkitë kanë administruar 292 ankesa nga qytetarët lidhur me sigurinë ushqimore, për 73% të tyre janë marrë masat përkatesë. Progres i lehtë është bërë me liçensimin e tregjeve të kafshëve të gjalla (shkalla mesatare 23% nga 19% që ishte në vitin 2019), ndërsa liçensimi i tregjeve të shitjes me pakicë ka mbetur në të njëjtin nivel me vitin 2019 (rreth 40%¹⁸). Bashkitë duhet të krijojnë zyrat për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të fuqizojnë kapacitetet e nëpunësve të këtyre strukturave (të fuqizohet roli monitorues/inspektues të shërbimeve bashkiake), dhe të plotësojnë të gjitha standartet për liçensimin e plotë të tregjeve të shitjes me pakicë dhe të tregjeve të kafshëve të gjalla.

Duhet të përfundojë ristrukturimi i sektorit veterinar, për të rritur efikasitetin e shërbimit dhe për të siguruar një nivel të përshatshëm të kapaciteteve administrative, hartimi dhe zbatimin e një metodologjie për planifikimin e kontroleve zyrtarë të sigurisë ushqimore dhe kontrollin e produkteve për mbrojtjen e bimëve¹⁹.

Politikat e transportit

Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje në fushën e politikës së transportit, megjithëse është arritur vetëm progres i kufizuar. Është bërë përparim i mëtëjshëm lidhur me përafrimin e legjislacionit kombëtar për transportin rrugor me acquis-në e BE-së, por nevojiten më shumë përpjekje për të harmonizuar legjislacionin shqiptar për sistemet e menaxhimit të trafikut dhe sigurinë rrugore (përfshirë edukimin dhe zbatimin e sigurisë rrugore)²⁰.

Miratimi i Strategjisë për Aplikimin e Sistemeve Inteligjente në Transportin Rrugor, në 2020, pritet të sjellë përmirësim të sigurisë rrugore; gjithashtu është përmirësuar kuadri rregullator për transportin publik me miratimin e udhëzimeve për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor dhe linjave ndërqytetase.

Progres i lehtë është bërë në 2020 në drejtim të sigurimit të përputhshmërisë të rrjetit rrugor urban dhe rural me standartet e ndërtimit të rrugëve të rrjetit të administruar nga bashkitë dhe përmirësimin e sinjalistikës. Fondi i përdorur nga bashkitë për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve ka qenë më i vogël mesatarisht me -0.25 p.p kundrejt 2019.

Progres i lehtë është bërë në 2020 me rritjen e rrjetit urban të dedikuar për lëvizje më biçikleta në 4.59% të rrjetit total urban, më pak fushata ndërgjegjësimi për promovimin e ecjes në këmbë

13 Ligj për Perfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH

14 Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (2020), kapitulli 12

15 Ligj 16/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa të Ligj 9863/2008 “Për ushqimin”, I ndryshuar

16 Raporti vjetor për v.2020 (MBZHR, 2021)

17 Raporti vjetor për v.2020 (AKU)

18 Matrica e treguesve të BpE

19 Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (2020), kapitulli 12

bë dhe lëvizjes me biçikleta janë kryer në 2020 (24 fushata më pak nga 2019); rreth 52% e bashkive nuk kanë kryer fushata ndërgjegjësimi gjatë 2020. Sfidat për bashkitë janë sigurimi i burimeve alternative të financimit dhe bashkë-financimeve për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor sipas standardeve, përmirësimi i sistemit të transportit publik dhe shtimi i linjave të reja, ndërtimi i terminaleve të mjeteve të transportit publik në përputhje me planet e zhvillimit vendor, si dhe fuqizimi i kapaciteteve njerëzore në sektorin e zhvillimit të projekteve, urbanistikës dhe transportit për hartimin e projekteve të reja për rrugët.

Energjia

Progresi i lehtë është bërë nga bashkitë në zbatimin e politikës së qeverisë në fushën e energjisë, menaxheri për eficientë të energjisë është caktuar vetëm nga 15 bashki, ndërsa plani i veprimit vendor për eficientë të energjisë, është miratuar vetëm nga 19 bashki. Rreth 31% e bashkive (19 bashki) kanë zbatuar 70 projekte sipas kërkesave të eficientë të energjisë dhe 12 projekte, të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë; më shumë kontrolle janë kryer nga bashkitë gjatë vitit 2020 (ose 328 kontrolle më shumë kundrejt vitit 2019).

Sfidat të bashkive mbeten krijimi i strukturave në bashki dhe caktimi i menaxherit për eficientë të energjisë, trajnimi dhe certifikimi i tij, hartimi i planit të veprimit vendor për eficientë të energjisë, fuqizimi i kapaciteteve njerëzore inspektuese për zbatimin e masave të kontrollit në ndërtesat e banimit dhe ndërtesat për shërbimet publike dhe private dhe rritja e kapaciteteve për hartimin e projekteve të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

Taksat

Përparimi është arritur nëpërmjet përfshirjes në kuadrin e OECD për erozionin e bazës dhe zhvendosjen e fitimit dhe krijimit të një zyre qendrore ndërlidhëse për shkëmbimin automatik të informacionit financiar (ligji 4/2020)²⁰. Për mobilizimin e të ardhurave, u përmirësua baza rregullatore me synim lehtësimin dhe thjeshtëzimin e kriterëve me bazë rrisht. Përmirësimi ka patur sistemi i rimbursimit të TVSH (periudha e pagesës u zvogëluar) dhe detyrimi në 2020 u zvogëluar me 16% kundrejt vitit 2019. Gjithashtu rregjistrimi për taksapaguesit u përmirësua më tej.

Bashkitë kanë realizuar të ardhura të veta tatimore dhe jotatimore rreth 24.2 miliard lekë (ose 1.4 miliard lekë më pak se realizimi i të ardhurave gjatë vitit 2019), por kanë qenë me trend rritës me çdo vit paraardhës, me 19% në vitin 2018, 6% në vitin 2019 dhe 1% në vitin 2020. Në raport me të ardhurat publike, të ardhurat vendore janë rritur nga 5.02% në vitin 2019 në 5.16% në vitin 2020²¹.

Në vitin 2020, 49 bashki kanë miratuar programe të politikave tatimore, duke mbetur në nivel të njëjtë me vitin 2019. Për shkak të situatës së COVID-19, më pak kontrolle dhe inspektime janë kryer nga strukturat vendore në bizneset kundrejt vitit 2019, gjithsej 21,897 kontrolle. Rreth 74% e bashkive kanë funksionale databazën e të dhënave për debitorët (më pak kundrejt vitit 2019, ose -8.p.p). Mbeten sfida për bashkitë, 1- rritja e aftësisë inspektuese të strukturës vendore për të mbuluar territorin e zgjeruar të bashkive mbas Reformës Administrative dhe Territoriale, 2-hartimi i politikave tatimore në nivel vendor, 3-sigurimi i bashkëpunimit efektiv me drejtoritë rajonale të tatimeve²².

Politikat sociale dhe punësimi

Politikat sociale dhe të punësimit kanë vijuar të jenë ndër prioritetet kryesore të bashkive në zbatim të reformave strukturore dhe masave për reduktimin e varfërisë dhe nxitjen e punësimit. Viti 2020 solli sfida të paparashikuara, të cilat kërkuan që sistemi i mbrojtjes sociale të reagojë menjëherë. Me shpalljen e situatës të emergjencës dhe zbatimin e masave kufizuese, qeveria qendrore dhe vendore mori disa masa në ndihmë të familjeve të varfra dhe në nevojë.

Progresi është shënuar në ndërmarrjen e reformave për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale. Përmirësimet janë bërë duke filluar nga reformimi rrënjësor i programit të ndihmës ekonomike dhe paaftësisë, sistemi i shërbimeve të integruara të përkujdesit socialë, si dhe plotësimin e programeve të ndihmës ekonomike me programe aftësimi e integrimi social. 90% e Bashkive kanë hartuar planin vendor për përfshirjen sociale. Kapacitetet njerëzore në bashki me nëpunës shtesë për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike (NE) kanë pësuar rritje me gati 50 % nga viti 2019.

Progresi është shënuar në drejtim të rritjes së numrit të personave që dalin nga skema ekonomike dhe ri-integrimit në tregun e punës përmes formimit profesional apo bashkëpunimit me zyrat e punës duke sjellë uljen e tyre me gati 41% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2018.

Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Progresi është shënuar në plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Sistemi i monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në territorin e bashkisë është funksional në 72% të Bashkive duke shënuar progress nga 68.85% që ishte në 2019.

Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm që ka pësuar kuadri ligjor, veçanërisht atij për luftën kundër dhunës në familje, zbatimi efektiv i tij në praktikë mbetet një sfidë, sidomos në lidhje me

20 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)
21 MFE (Raporti vjetor për financat publike vendore, 2021)
22 Matrica e treguesve të performancës së bashkive (MfE), 2021

vlerësimin e riskut dhe lëshimin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme. Për më tepër, mbetet i rëndësishëm ngritja e mekanizmave të përshtatshëm në nivel qendror dhe lokal të përfshirjes efektive të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Sistemet që gjenerojnë të dhëna në lidhje me viktimat e dhunës në familje rezultojnë se nuk janë të sinkronizuara ndërmjet tyre. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, fuqizimi i strukturave të barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje, zgjerimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe buxhetimi i shërbimeve, janë disa nga rekomandimet më të rëndësishme që adresohen në këtë raport si të domosdoshme, me qëllim përmirësimin e zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje. Deri në vitin 2020 vetëm 41 Bashki kanë krijuar sektorin e barazisë gjinore (67.21%), por janë ofruar shërbime rreth 4 herë më shumë në krahasim me 2019.

Megjithëse, gratë dhe vajzat përballesh me diskriminim për shkak të gjinisë dhe/ose të shumëfishtë, përdorimi i mjeteve ligjore si ankesa për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi apo paditë drejtuar gjykatës kanë qenë instrumente të kufizuara dhe pak të përdorur. Në 2020 vetëm 39% e Bashkive që kanë një sistem monitorimi për rastet e diskriminimit brenda territorit të Bashkisë së tyre.

Nuk ka patur progres në miratimin e Planit Vendor për Përfshirjen Sociale të Personave me Aftësi Ndryshe dhe planifikimi i tij në PBA, i cili është kryer nga vetëm 26 bashki.

Drejtësia, liria dhe siguria

Çështjet e lirisë dhe sigurisë në komunitet gjithnjë e më shumë po orientohen drejt prioritetëve të agjendës së Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Në këtë kuadër progres është bërë në ndërtimin e një koncepti të ri të shërbimeve të të gjithë aktorëve në lidhje me sigurinë publike i cili synon të përforcojë përgjegjësitë aktuale të të gjithë aktorëve përkatës të tillë si organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, institucionet ligjzbatuese, Policisë së Shtetit si dhe rolit të qytetarëve, komuniteteve, si dhe institucionet e tjera jo qeveritare, duke përfshirë organizatat jo qeveritare, forumet qytetare, bizneset, institucionet fetare, mediat etj. Progres është bërë nga bashkitë për ngritjen e Këshillit të Sigurisë Vendore gjatë 2020, si një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar tashmë i ngritur në rreth 72% të Bashkive.

Progres i moderuar është bërë lidhur me hartimin dhe miratimin e Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor nga 62% e bashkive. Ky dokument është në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, ku theksohet se siguria në komunitet është përgjegjësi e të gjithë aktorëve përgjegjës në këtë fushë dhe në përputhje me standardet dhe eksperiencat më të mira parëndimore.

Ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet në secilën njësi administrative raportohet në 30% të Bashkive. Ngritja e kësaj strukture në të gjitha bashkitë dhe Njësitë Administrative do të luajë një rol të rëndësishëm në sigurinë publike dhe në garantimin e rendit dhe sigurisë, me një koncept më demokratik duke bërë bashkë të gjithë aktorët institucionalë qendrorë dhe vendorë.

Arsimi dhe Kultura

Është zhvilluar legjislacioni për sektorin e arsimit parauniversitar dhe siguruar decentralizimi i kompetencave në nivel vendor. Megjithë përpjekjet për të rritur pavarësinë e institucioneve vendore në menaxhimin e sistemit të arsimit parashkollor sërish varësia e financiare nga qeveria qendrore mbetet e lartë duke çenuar thellë cilësinë e shërbimeve.

Kapacitetet e pamjaftueshme financiare dhe burimet e kufizuara njëzëzore e bëjnë akoma më sfiduese zbatimin e legjislacionit dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 në nivel vendor. Mungesa e infrastrukturës adekuate dhe standarteve cilësore në ndërtesat e shkollave dhe kopshteve kanë ndikuar në uljen e cilësisë së edukimit. Sërisht, numri mesatar i nxënësve për mësues mbetet e lartë si dhe kapacitetet e shkollave dhe kopshteve në disa bashki vuajnë nga mbipopullimi. Shkalla e regjistrimit të fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor në nivel kombëtar, në 2020 është 67%. Treguesi ka ulje në krahasim me 2019 që ka qënë në nivelet e 75%.

Mbetet sfidë rritja e fondit vendor për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore dhe parashkollore, ulja e madhësisë së grupeve të fëmijëve në kopshte për një edukatorë, rritja e numrit të edukatorëve. Në 2020 ka patur ulje të ndjeshme të fondit të alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja në vetëm 2.36%.

Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore si dhe organizimi i aktiviteteve kulturore ka shënuar progres të ulët. Sërisht bashkitë ndeshen me problematikat e ndërtimeve të paligjshme apo shkelje të legjislacionit për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Në 2020 rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore shënuan rritje me gati 46% në krahasim me vitin 2019.

Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Me gjithë përpjekjet e bëra dhe në nivel qendror dhe vendor sërish ka patur progres të ulët në përbushjen e objektivave dhe treguesve të fushës së Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike nga Njësitë e Qeverisjes Vendore. Ushtrimi i funksioneve të NJQV has në problematika të mëdha që lidhen me kapacitetet e ulëta njëzëzore dhe financiare si dhe mungesa e programeve dhe projekteve zhvillimore të investimit. Në 2020, janë trajnuar gjithsej 90 nëpunës vendorë mbi legjislacionin dhe zbatimin

e masave të politikave qendrore në fushën e mjedisit, duke mbetur në të njëjtat nivele me vitin 2019.

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve është pjesërisht i harmonizuar me atë të BE-së dhe zbatimi i tij është në nivele të ulta. Mbledhja dhe ndarja e mbetjeve dhe futja e instrumenteve ekonomike për të nxitur riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara. Mbyllja e shumë venddepozitimeve të papërshtatshme mbetet problematike edhe në vitin 2020 ku janë raportuar 83 vend-depozitime të paautorizuara nga 17 bashki (ose 27.8% e bashkive).

Pavarësisht investimeve në rrjetin e ujësjellës kanalizimeve sërisht hasen problematika si mungesa e licensimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të zeza, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme, rrjeti i pazhvilluar i kanalizimeve dhe lidhjet shtëpiake. Në vitin 2020 mesatarisht 86.2 % e familjeve janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane dhe 71.2% në zonat rurale. Vetëm 19.7 % e bashkive (ose 12 Bashki) raportojnë se impianti i pastrimit të përpunimit të ujërave të zeza është i ngritur dhe funksional.

Progres i kufizuar evidentohet lidhur me performancën e bashkive për administrimin e fondit pyjor vendor. Mbeten sfida hartimi i planit vendor për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor nga të gjitha bashkitë, parashikimi i tij në buxhetit afat-mesëm (PBA), si dhe rritja e burimeve njerëzore për këtë funksion sipas dispozitave ligjore. Rreth 55.7% e bashkive kanë hartuar në 2020 planin për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor, i cili integron dhe masat e mbarështimit të pyjeve, kullotave dhe bimëve mjekësore.

Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme. Progres është bërë në ngritjen e strukturave të emergjencës civile në vitin 2020, ku rreth 93% e bashkive kanë ngritur shtabin e emergjencave civile dhe 88.5% e bashkive kanë ngritur strukturën e emergjencave civile. Financimi nga qeveria qendrore mbulon mesatarisht 2.24 % e buxhetit të emergjencave civile ndërkohë që 39% e bashkive raportojnë 0 % fond të alokuar nga qeveria për to në vitin 2020.

Kontrolli Financiar

Përparim është bërë nga NJVV në drejtim të planifikimit afatmesëm të buxhetit dhe forcimit të sistemit për kontrollin e brendshëm të financave publike. 14 (katërmbëdhjetë) bashki pilot kanë miratuar Grupin e Menaxhimit dhe Koordinimit të Riskut me rregulloren përkatëse mbi përgjegjësitë e drejtuesve dhe koordinuesve të riskut, procesin e vendimarrjes dhe monitorimit të risqeve deri tek Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Kryetari i Bashkisë. Në vitin 2020, janë trajnuar rreth 160 persona, në kuadër të zbatimit me rigorozitet të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin²³.

KLSH ka evidentuar problematika në menaxhimin e fondeve, asetëve dhe pasurisë publike, si dhe përgjegjësitë përkatëse nga zyrtarët e çdo niveli të qeverisjes qendrore, vendore dhe enteve në varësi të tyre për 91 subjekte, përfshirë qarqe dhe bashki. Detyrimet e prapambetura të bashkive u reduktuan por mbetën mbi nivelin e synuar.

Sfida për bashkitë mbeten realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe ulja e stokut të detyrimeve të prapambetura, ruajtja e standarteve ligjore për buxhetimin mbi bazë program, ofrimi eficient dhe cilësor i shërbimeve publike për qytetarët, zbatimi i rregullave për menaxhimin e financave publike duke siguruar disiplinë fiskale, raportimi i zbatimit të buxhetit mbi bazën e treguesve të performancës, përmirësimi i procedurave të monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe krijimi i një kulture të qëndrueshme në përdorimin më të mirë të fondeve publike.

23 Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (2020), MFE

HYRJE

Ky është raporti i katërt kombëtar i vlerësimit të arritjeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) në funksion të procesit të integritimit evropian në nivel vendor dhe në fushat kryesore të cilat lidhen me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe aftësinë për të realizuar detyrimet e anëtarësimit të Shqipërisë.

Raporti i tretë i performancës së NJVV për vitin 2019 u prezantua në 46 bashki fillimisht nëpërmjet takimeve në 6 bashki e më pas, detyruar nga kufizimet e pandemisë u realizuan mbi 40 takime online të organizuar me autoritete të bashkive, AMVV, përfaqësues dhe specialistë të Delegacionit Evropian në Tiranë, zyrës së projektit BpE dhe ekspertë kombëtarë, në periudhën Shtator – Tetor 2020.

Monitorimi i performancës mbi bazën e analizës së treguesve për sektorë dhe fusha të ndryshme, përfshijnë demokracinë vendore, qeverisjen, shtetin e së drejtës, administratën publike, zbatimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut, ekzistencën e ekonomisë së tregut funksionale dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në fusha specifike, të tilla si bujqësia dhe zhvillimi rural, siguria ushqimore, politikat e transportit, energjia, taksat, gjyqësori dhe të drejtat themelore, arsimit dhe kultura, mjedisi dhe ndryshimi i klimës, financat vendore dhe kontrolli financiar. Ky raporti analizon informacionin për treguesit për vitin e raportimit 2020, duke bërë një krahasim për disa tregues të performancës me vitet 2017 – 2019. Të dhënat e raporteve të vlerësimit duke filluar nga viti 2018 publikohen on-line në adresën <https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/online.aspx>, si dhe në faqen e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore 2015-2020, u miratua, në 2020, plani i veprimit 2020-2022²⁴, i cili planifikon masa dhe aktivitete të pare-

alizuara të Plan Veprimit të parë SNDQV, për shkak të natyrës së tyre komplekse, me qëllim arritjen e objektivave strategjike/ dhe oobjektivave specifike, lidhur me i) Konsolidimin e kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore, (ii) Forcimin e financave vendore, (iii) Promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm vendor, dhe (iv) Forcimin e qeverisjes së mirë në nivelin vendor²⁵.

Krahas progresit të NJQV në disa fusha gjatë 2020, duhet nënvizuar forcimi i kapaciteteve të bashkive lidhur me monitorimin. Bashkitë hartojnë raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit në MFE, bazuar në një sistem të unifikuar të shpenzimeve²⁶ dhe mbi bazën e një udhëzimi²⁷ për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit, si dhe hartojnë raportet e performancës të shërbimeve për programet e buxhetit vendor. Mbetet sfidë zhvillimi i një sistemi të unifikuar të treguesve të performancës së shërbimeve për të gjitha bashkitë dhe raportimi cilësor bazuar në rezultate (ky aktivitet është pjesë e PV 2020-2022 SNDQV).

Komisioni Evropian në raportin vjetor për Shqipërinë (2020) ka cituar që reforma territoriale administrative duhet të konsolidohet më tej si pjesë e agjendës së zgjeruar të decentralizimit. Kjo është e nevojshme për të garantuar autonomi fiskale vendore dhe për ofrimin me cilësi dhe standarte të shërbimeve publike.

Metodologjia dhe Sistemi i të dhënave

Burim parësor i të dhënave në analizën e raportit janë të dhënat e plotësuara nga NJQV për vitin 2020. Raporti i Vlerësimit të NjQV në procesin e integritimit evropian, për vitin 2020, mbulon të 61 bashkitë bazuar në të dhënat e raportuara nga Njësitë e Integritimit Evropian në bashki, nëpërmjet Sistemit On-Line të Raportimit për më shumë se 200 tregues, sipas fushave krye-

24 Vendim nr. 783, datë 07.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020

25 Strategjia Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV), 2015–2020

26 Sistemi COFOG

27 Udhëzim nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”

sore të tre kritereve të anëtarësimit. Duhet theksuar se shkalla e plotësimit të treguesve ndryshon ndërmjet bashkive. Saktësia e të dhënave të raportuara është përgjegjësi vetëm e bashkive. Krahas të dhëna dytësore bazuar në rishikimin e ligjeve dhe akte nën ligjore të miratuara gjatë 2020, mbi bazën e të cilave NJQV kanë rol dhe detyra specifike, si dhe rishikimin e dokumenteve strategjike dhe raporteve të monitorimit të ministrive të linjës për vitin 2020, Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020), të dhëna nga INSTAT (ndonëse statistikat jepen në nivel qarku dhe jo në nivel bashkie).

Raporti bën një analizë krahasuese ndërmjet bashkive sipas fushave të ndryshme, dhe identifikon praktikën e mira, problemet dhe sfidat në realizimin e politikave vendore në përgjigje të sfidave të zhvillimit kombëtar, politikave sektoriale dhe agjendës së integritimit evropian.

Raporti jep të dhëna të llogaritura për shumën, mesataren ose numërimin për tregues të ndryshëm për të cilat janë ofruar të dhëna të vlefshme. Treguesit janë të matshëm (numerike, ose të shprehur në përqindje), afirmative për disa objektiva dhe prioritete që lidhen me zbatimin e politikave të qeverisë qendrore në nivel vendor dhe në kuadër të procesit të anëtarësimit. Treguesit prezantojnë situatën në secilën bashki sipas kritereve të vlerësimit dhe përkundrejt standarteve (ku ka qene e mundur). Bashkitë, që nuk kanë ofruar të dhëna për ndonjë tregues të veçantë, janë paraqitur në hartë (në ngjyrë gri) ose me shpjegime në fund-shënime. Të dhënat e kapitullit të financave vendore / dhe kontrollit financiar janë siguruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- KAPITULLI 1 -

KRITERI POLITIK

Qëndrueshmëria e institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave

1.1 DEMOKRACIA

1.1.1 Qeverisja

“Qeveria ka qenë e angazhuar ndaj procesit të integritimit në BE dhe ka ndjekur përpjekje të mira për t’i çuar përpara reformat e domosdoshme. Tërmeti i datës 26 nëntor 2019 ka patur një ndikim të fortë mbi objektivat e përgjithshëm të veprimtarisë së ekzekutivit. Duhet të përmirësohet koordinimi brenda administratës, në veçanti lidhur me përfshirjen e tyre në proceset e integritimit në BE. Qeveria ka miratuar një plan veprimi për të trajtuar kushtet dhe përparësitë e përcaktuara në Përfundimet e Këshillit të marsit të vitit 2020 (plani i veprimit 2019-2021). Reforma territoriale-administrative vijon të zbatohet me sukses dhe duhet të konsolidohet më tej si pjesë e një agjende më të gjerë decentralizimi. Kjo është në veçanti e nevojshme për të garantuar autonominë fiskale vendore dhe për t’i fuqizuar bashkitë me qëllim ofrimin e shërbimeve publike me cilësi sipas standardeve²⁸”.

Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të qeverisë qëndrore dhe vendore nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit efektiv të Këshillit Konsultativ

“Këshilli Konsultativ ka funksionuar si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore. Ndërsa diskutimet politike dhe ligjore do të kishin përfituar nga një përfshirje e mëparshme e qeverisjes vendore, NJQV-të dhe shoqatat e tyre rrallë arrijnë të vijnë në tryezë me pozicione të konsoliduara²⁹”.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, në kuadër të rolit si një institucion qendror në përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore që impaktojnë drejtpërdrejtë shërbimet dhe kompetencat e çështjeve vendore, dhe në ekzekutim të detyrës së sekretariatit teknik të Këshillit Konsultativ, ka kontribuar në

informimin e bashkive për projektvendimet, projektligjet dhe projekt strategjitë, në organizimin e mbledhjeve të Këshillit Konsultativ dhe miratimin e projektvendimeve që prekin funksionet dhe impaktojnë bashkitë.

AMVV ka mbështetur dhe monitoruar NJQV në marrjen e masave për shkak të situatës Covid-19, në zbatim të ligjeve³⁰ dhe urdhërit të nr. 105, datë 24.02.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në ngritjen e strukturave përkatëse pranë bashkive dhe raportimin e përditësuar mbi zbatimin në terren të asistencës sociale në kohën e pandemisë. Aktivitete të tjera të rëndësishme, kanë qenë takime pune dhe konsultimi me përfaqësues të bashkive, lidhur me zbatimin e VKM nr.369/2019 “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorialë të NJQV, monitorimi i bashkive për planifikimin e PBA, në vijim të udhëzimit nr. 27, datë 10.07.2020 të MFE, takime me ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe paraqitjen e projekt buxhetit në KB; gjithashtu, AMVV ka kontribuar në përgatitjen e Konferencës së Donatorëve (17.02.2020) duke qenë pjesë e grupit të punës për Mbrojtjen Civile dhe Analizën e Riskut


Për aspektet e integritimit evropian, AMVV në bashkëpunim me rrjetin e koordinatorëve të zyrave të integritimit të BE-së ka forcuar përfshirjen e NJQV në procesin e integritimit evropian, në drejtim të koordinimit dhe përfshirjes në një seri aktivitesh në kuadër të zbatimit të projektit të financuar nga fondet IPA “Bashkitë për në Evropë”, përfshirë koordinimin për plotësimin e matricës së treguesve të performancës, pjesëmarrje në rreth 46 takime për prezantimin e raportit të performancës për vitin 2019, me kryetarë të bashkive dhe nëpunës vendore (Shkurt dhe Shtator-Tetor 2020).

AMVV me mbështetjen e projektit STAR 2, ka monitoruar ngushtësisht mirëfunksionimin dhe zgjerimin e sistemit të zyrave me një ndalesë. Me mbështetje të projektit Bashkitë e

28 Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)

29 Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)

30 Ligj nr. 1038, datë 11.05.2009, për “Shëndetin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.15/2016, datë 10.08.2016 “Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive”, si dhe ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.



Grafiku 1: Numri i aplikimeve në Konkursin e Praktikave të Mira, 2017- 2020
Burim: BtF / Helvetas (SDC); <http://praktikatemira.qeverisjavendore.gov.al/>

Forta, MB dhe AMVV drejtuan organizimin e Konkursit të Praktikave të Mira (KPM) edicioni 2020³¹ në të cilën morrën pjesë 39 bashki me 64 aplikime në fushat e administrimit dhe menaxhimit të arsimit parashkollor, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja dhe emergjencat civile, dhe aktiviteti përfaqësues dhe legjislativ i Këshillit Bashkiak. Aktiviteti final u zhvilluar në Dhjetor 2020 me dhënien e 8 çmimeve nga katër juritë dhe 4 çmime nga publiku nëpërmjet votimit online. Siç shihet edhe nga grafiku nr.1 interesi i bashkive për të marrë pjesë në KPM ka ardhur në rritje në tre vitet e fundit, duke pësuar një rritje të aplikimeve më gati 2 herë në vitin 2020 krahasuar me vitin 2017.

Këshilli Konsultativ midis Qeverisë Qendrore dhe asaj Vendore

Drejtimet kryesore të veprimtarisë së Këshillit Konsultativ (KK) përshkruhen nëpërmjet katër grupe treguesish: (i) Mbi diskutimin e projektakteve ligjore, (ii) Mbi zbatimin e urdhrat të Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019 “Për hartimin e akteve nënligjore nga ministratë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, për funksionet e deleguara të njëjve të vetëqeverisjes vendore”, (iii) Mbi zbatimin e Matricës së Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore, (iv) Mbi përfaqësimin në KK të Qeverisë Qendrore dhe NJQV.

Në vitin 2020, Këshilli Konsultativ³² (KK) morri në shqyrtim dhe konsultim 36 projektakte ligjore, nga të cilat 9 projektligje dhe 27 projektvendime. Këshilli miratoi 23 projektakte ligjore, nga të cilat 18 janë diskutuar, që përbën rreth 67% të akteve të paraqitura për diskutim e shqyrtim nga KK (6 projektligje dhe 12 projektvendime). Numri më i madh i akteve të dërguara në KK është dërguar nga Ministria e Financave.

Kutia 1: Roli i Këshillit Konsultativ

Për të çuar më tej përpara axhendën e decentralizimit dhe kontributin e qeverisjes lokale në procesin e integritit të Shqipërisë në BE, Delegacioni i Bashkimit Evropian ka ofruar asistencë teknike në 2020 për të forcuar dialogun institucional në vetë Këshillin Konsultativ dhe për ti siguruar mbështetje në formulimin dhe avokimin e pozicioneve të dobishme për komunitetet lokale.

“Ne duam që të forcojmë efikasitetin dhe efektivitetin e Këshillit Konsultativ i cili është i rëndësishëm për agjendën e decentralizimit, por edhe për procesin e integritit të Shqipërisë duke ditur që gati 70 për qind e Acquis është e lidhur drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë me qeverisjen vendor”.

Nga fjala e Z.Orlando Fusco, Menaxher i Programit për Qeverisjen e Mirë në Delegacionin e BE në Shqipëri në mbledhjen e KK, Dhjetor 2020.

Ndër projektaktet ligjore të konsultuara në KK janë projektligjet: Për vlerësimin e ndikimit në mjedis³³, projektligj për tregjet e kapitalit, për sipërmarrjet e investimeve kolektive, për zhvillimin rajonal dhe kohezionin, për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit, për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar³⁴, për taksat kombëtare³⁵ të ndryshuar, për Buxhetin vendor 2021 dhe për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve Inovative, dhe projektvendimin për rastet dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe NJQV për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale, për mbështet-


31 KPM është një instrument që mundëson shkëmbimin e informacionit mbi praktika dhe iniciativa të ndërmarra nga NJVV, në nivel ekzekutiv dhe legjislativ (KB), dhe në zbatim të reformës së decentralizimit dhe qeverisjes së mirë në nivel vendor. KPM drejtohet nga zëv. Ministri për vetëqeverisjen vendore dhe zbatohet nga AMVV.

32 Veprimtaria e Këshillit Konsultativ është e bazuar në VKM nr. 910, datë 21.12.2016, “Për çështjet, objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, dhe VKM Nr. 751, datë 19.12.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”, si dhe në Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe të Strategjisë Kombëtare Ndër-sektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SKNDQV).


33 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në Mjedis”

34 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar


35 Për një ndryshim në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar



Grafiku 2: Projekt-akte ligjore të iniciuara nga Qeverija Qëndrore të diskutuara në KK, 2020
Burim: AMVV



Grafiku 3: Numri i akteve ligjore të miratuara që kanë kaluar procedurën e konsultimit në KK, 2017-2020




Grafiku 4: Projektaktet e konsultuara në KK, 2018-2020
Burim: AMVV

jen financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe procedurat e kompensimit financiar për zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian”, për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave dhe projektvendime të tjera³⁶. Gjithashtu është konsultuar draft Strategjia e zhvillimit të kujdesit shëndetësor 2020-2025, Plani Kombëtar i Veprimit mbi Deinstitutionalizimit 2020-2023.

Shqetësues mbetet pjesëmarrja e ministrive në Këshillin Konsultativ edhe gjatë vitit 2020. Niveli i përfaqësimit të ministrive në 6 takimet e KK ka qenë i ulët përkundrejt kërkesave ligjore për praninë në mbledhje dhe nivelin hierarkik të përfaqësuesit. Niveli i përfaqësimit me zv/ministrin nuk ka qenë i plotë, shpesh në takime ministrinë e linjës përfaqësohen me nëpunës


të niveleve të tjera të hierarkisë (më të ulëta); Mesatarisht, në 2020, në takimet e KK, kanë marrë pjesë 40% e ministrive të linjës. Programi i transparencës së AMVV ofron informacion të aktivitetit të AMVV dhe KK, dhe projektaktet ligjore të konsultuara <https://keshillikonsultativ.qeverisjavendore.gov.al/>. Niveli i përfaqësimit të institucioneve të vetëqeverisjes vendore - mesatarisht 12 bashki kanë qenë të pranishme në mbledhjet e vitit 2020 (20% të bashkive), por në një shkallë të ndryshueshme nga 2 në 28 bashki të pranishme; Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë dhe Shoqata për Autonominë Vendore kanë qenë të pranishme në pesë takime nga gjashtë të KK, ndërsa Shoqata e Bashkive të Shqipërisë është përfaqësuar nëpërmjet drejtorit ekzekutiv të saj. Mesatarisht, 9 bashki kanë qenë të pranishme me përfaqësues kryetarin e bashkisë³⁷.

36 Raporti vjetor AMVV, 2020
37 Raporti vjetor 2020 (AMVV)



Grafiku 5: Numri i mbledhjeve të KK brenda 1 viti (2017-2020)

Burim: Matrica e treguesve “Bashkitë në procesin e Integrimit Evropian”, 2020



Grafiku 6: Niveli mesatar i përfaqësimit të QQ dhe QV në takime e KK, 2018-2020

Burim: AMVV

KK dhe Sekretariati Teknik i tij është mbështetur me asistencë teknike (fonde të BE) gjatë 2020 me synim rritjen e rolit të KK në procesin e zhvillimit të kuadrit ligjor dhe kornizën buxhetore për vetëqeverisjen vendore, rritjen e kapacitetit të AMVV/MB në lidhje me menaxhimin e KK dhe fuqizimin e rolit të bashkive në propozimet ligjore. Në 2020, u hartua strategjia e komunikimit dhe dukshmërisë për KK si një organ që mundëson konsultimin dhe dialogun për çështje kryesore midis QQ dhe QV dhe filloi të hartohet draft rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KK³⁸

Konkluzione


- Procesi i konsultimit është zhvilluar rregullisht për pjesën më të madhe të projektakteve ligjore me ndikim në vetëqeverisjen vendore.
- Niveli i përfaqësimit të institucioneve të QQ në gjashtë takimet e KK ka rënë krahasuar me 2018 dhe 2019, jo vetëm si nivel hierarkie por edhe në numër. Pjesëmarrja e nivelit drejtues (zv/ministry) ka qenë e ulët duke mos respektuar pjesëmarrjen e përcaktuar në aktin ligjor të themelimit të KK.
- Përfaqësimi i vetëqeverisjes vendore nga bashkitë dhe shoqatat e vetëqeverisjes vendore ka qenë në shkallë të plotë.

Rekomandime

- Konsultimet për çdo ndryshim ligjor që ndikon në vetëqeverisjen vendore duhet të iniciohen që në fillim të procesit për të ndihmuar për një analizë më të plotë të ndikimeve social-ekonomike. AMVV duhet të mundësojë lehtësimin e analizës dhe të konsultimit më NJQV.
- AMVV duhet të ketë një qasje më proaktive për monitorimin se si janë reflektuar, në aktet e miratuar, rekomandimet /kommentet e dhëna nga NJQV, gjatë konsultimit në KK. Për realizimin sa me efektiv të këtij roli, AMVV në rolin e Sekretariatit të KK, duhet të fuqizohet me personel. Rekomandohet të ketë nëpunës të dedikuar dhe me njohuri të thella mbi aspektet ligjore, për të mundësuar analizën e akteve ligjore pas miratimit të tyre.
- Të rritet cilësia e konsultimeve dhe përfaqësimi i institucioneve të QQ në takimet e KK.

Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
1515	1515	2849	6967

Tabela 1 Numri i shërbimeve të ofruara nga ZNjN



Grafiku 8: Numri i qytetarëve që kanë aplikuar për shërbime on-line, 2020

Numri i Njësive Administrative të Bashkisë që kanë funksionale Zyrë me Një Ndalesë (OSSH) në raport me numrin total të NJA të Bashkisë është rritur me 11 bashki krahasuar me vitin 2019. Ndërsa ZNjN janë ngritur në rreth 97% të bashkive, shkalla e zgjerimit të tyre në njësitë administrative (NJA) ndryshon nga zero (0) deri në 100%. Në nivelin kombëtar shtrirja e ZNjN në nivelin e njësisve administrative në fund të vitit 2020 ka qenë në nivelin 26% të gjithë njësisve administrative. Gjithsej, në 2020, janë ofruar 6967 shërbime nga ZNjN për qytetarët nga 53 bashki, ose mesatarisht 131 shërbime.

Numri gjithsej i qytetarëve që kanë aplikuar për shërbime on-line gjatë 2020 ishte 87,372. Vlera e treguesit duhej të ishte më e lartë sepse 11 bashki (Tropoje, Vau i Dejës, Pustec, Polican, Patos, Libohovë, Kurbin, Gjirokastrë, Finiq, Divjake, Cërrik) kanë raportuar zero shërbime online ose nuk kanë të dhëna (rreth 34% e bashkive kanë mangësi në regjistrimin dhe raportimin për treguesin). Ky është tregues i ri që raportohet për vitin 2020. Bashkia Shkodër dhe Kukës raportojnë numrin më të madh të qytetarëve që kanë marrë shërbime nga ZNjN. Edhe pse Bashkia Tiranë raporton numrin më të madh të shërbimeve të ofruara, numri i qytetarëve që kanë marrë shërbim është raportuar shumë i vogël në raport edhe më numrin e popullsisë.

Probleme dhe sfida

- Plani i shtrirjes së zyrave të ADISA shoqërohet me sfidën e sigurimit të ambienteve të përshtatshme në bashkitë përkatëse. Kërkohe mbështetje për kalimin në administrim të ambienteve përmes akteve ligjore. Realizimi i investimeve në kohë për të mundësuar shtrirjen e ZNjN në gjithë territorin⁴².
- Vijimi i shtrirjes në territor të ZNjN për të mundësuar asistimin e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve online apo të shërbimeve që e kanë të nevojshme prezencën fizike të qytetarëve.
- Rritja e numrit të shërbimeve administrative dhe publike që ofrohen nga ZiNjN.
- Trajnimi i stafeve në ato bashki ku janë ngritur qendrat e integruara me nje ndalesë me synim që të sigurohet efikasitet më e lartë dhe shërbim më cilësor ndaj qytetarëve.
- Edukimi qytetar për të kapërcyer hendekun dixhital

dhe përdorimin e platformave për të marrë shërbimet online.

- Mbajtja e të dhënave të sakta në mënyrë sistematike për treguesit e shërbimeve të ofruara nga ZNjN.

Rekomandime⁴³

- Krijimi dhe zbatimi i një kornizë të menaxhimit të cilësisë nga ADISA në të gjitha Qendrat e Integruara për ofrimin e shërbimeve publike.
- Forcimi i rolit mbikqyrës të ADISA-s për të siguruar që institucionet qeveritare të jenë në përputhje me kërkesat dhe standartet e cilësisë së shërbimit publike.
- Krijimi i strukturave dhe planeve të trajnimit në secilin institucion të administratës shtetërore dhe vendore, me qëllim trajnimin e punonjësve që trajtojnë procesin e shërbimit dhe punonjësve në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarin ose biznesin.

42 Raport vjetor për 2020 (ADISA)

43 Raporti Vjetor (ADISA, 2021)

Rritja e Transparencës së Financave Vendore

Bashkitë kanë bërë progres të mëtjshëm lidhur me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen vendore, veçanërisht në fushën e buxhetimit me pjesëmarrje. Megjithatë, kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse ka nevojë për forcim të mëtjshëm. Zbatimi në nivel vendor i ligjit “Për konsultimin publik” mbetet i pakënaqshëm. Një numër në rritje i bashkive e botojnë informacionin për publikun, me të gjitha 61 bashkitë që kanë emëruar një koordinator lokal për të drejtën për informimin⁴⁴.

Rritja e transparencës së financave vendore vlerësohet nga tre grupe treguesish: (i) përgatitja nga bashkia e buxhetit vendor për qytetarët, (ii) buxheti vendor i publikuar në faqen e internetit të bashkisë dhe në faqen financatvendore.al dhe (iii) rritja e transparencës.

Programi i transparencës në faqet zyrtare të bashkive ofron informacion mbi organizimin e brendshëm të bashkisë, transparencën në financat vendore, shërbimet e bashkive dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje; të dhënat e plota të kontaktit të Koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik shfaqen në eëbсите të bashkisë/programi i transparencës. Gjithashtu, rubrika për pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje ofron informacion mbi ‘planin vjetor’ për procesin e vendimarrjes me pjesëmarrje, aktet për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit, procedurat e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve të qytetarëve nga nëpunësi vendor dhe procedurat e ankimimit, si dhe Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimarrjes.


Në 2020, 43 bashki (70% e bashkive) kanë përgatitur buxhetin vendor në një format të kuptueshëm për qytetarët.

Publikimi i buxhetit të bashkisë në faqen financatvendore.al është realizuar nga 50 bashki (82% e bashkive), 9 bashki nuk e kanë publikuar buxhetin e tyre, ndërsa 2 bashki të tjera nuk kanë raportuar për treguesin. Treguesi është në të njëjtin nivel me 2019.

Në 2020, janë organizuar 906 dëgjesa publike me qytetarët gjatë përgatitjes së buxhetit nga 60 bashki raportuese ose mesatarisht 15 dëgjesa për bashki (ose 85% më shumë dëgjesa krahasuar me 2019).

Në dëgjesat publike të organizuara nga bashkitë gjatë përgatitjes së buxhetit kanë marrë pjesë rreth 6887 qytetarë nga 27 bashki raportuese, ose mesatarisht 209 qytetarë, që rezulton më I vogël krahasuar me vitet 2017-2019, siç paraqitet në tablën më poshtë. Kjo pjesëmarrje e ulët është pasojë edhe e situatës së shkaktuar nga Covid-19. Bashkitë kanë organizuar 683 dëgjesa publike me kategoritë e grupeve vulnerabel me të rinj, gratë dhe komunitetet në nevojë, përfshirë pakicat etnike dhe personat më aftësi të kufizuara (mesatarisht 13 dëgjesa). Shkodra, Kolonja, Elbasani dhe Korça janë bashkitë që kanë raportuar një numër më të madh pjesëmarrjeje të qytetarëve në dëgjesat publike.


Në 2020, mesatarisht, 25% e rekomandimeve të grupeve të interesit dhe qytetarëve janë reflektuar në dokumentin e PBA në 2020.



Grafiku 9: Numri i dëgjesave publike mbi projekt-buxhetin nga NJQV

Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020
55491	55500	32895	6887

Tabela 2: Numri i qytetarëve pjesëmarrës në dëgjesat publike për buxhetin vendor



Grafiku 10: Numri i qytetarëve në dëgjesat publike mbi projekt-buxhetin, 2020

Probleme dhe Sfida

- Bashkitë ofrojnë informacion për buxhetin dhe shpenzimet por ofrojnë pak informacion mbi rezultatet/treguesit e shërbimeve publike të kryera me fondet publike.
- Një sfidë e rëndësishme mbetet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm⁴⁵.

Rekomandime

- Kuadri institucional në NJQV për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse të qytetarëve në proceset vendimmarrës dhe të buxhetimit ka nevojë për forcim të mëtejshëm.⁴⁶
- Kërkohej vemendje e shtuar nga autoritetet e ministrive dhe bashkive për të zhvilluar një sistemi të unifikuar të treguesve të performancës së shërbimeve dhe formateve të raportimit të NJQV (statistika të përmirësuara për sektorë dhe shërbime të ndryshme që rrit transparencën e financave vendore).
- Forcimi i kapaciteteve institucionale në drejtim të monitorimit dhe raportimit mbi bazë të rezultateve/treguesve;
- Ngritja e një strukture për monitorimin e performancës për fusha të ndryshme mbi bazën e një modeli të njëjtë për të gjitha bashkitë.
- Përdorimi i metodave dhe instrumentave që sigurojnë ofrimin e informacionit lehtësisht të kuptueshëm nga qytetarët i buxhetit të bashkisë së tyre.

1.1.2 Administrata Publike

“Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në lidhje me reformën në administratën publike. Është bërë ca progres sa i takon rritjes së numrit të shërbimeve elektronike dhe përmirësimit të transparencës për mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore ndërmjet nivelit të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore. Progres është bërë nga administrata vendore por më shumë duhet të bëhet për rritjen e cilësisë së shërbimeve publike⁴⁷.”

Në 2020, arritjet kryesore në drejtim të ndërveprimit të administratës publike, ishte miratimi i bazës ligjore⁴⁸ për përdorimin e platformës së bashkëpunimit “administrata.al”, e cila shërben për: (i) përmirësimin e ndërveprimit midis institucioneve publike; (ii) lehtësimin e komunikimit dhe raportimin e informacionit në kohë reale; (iii) unifikimin e praktikave administrative dhe (iv) përmirësimin e cilësisë së punës në drejtim të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore për institucionet e administratës publike. Pplatforma ka të integruar disa module të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore mbi rekrutimin, përshkrimet e punes, vlerësimin e performancës, nevojat për trajnim, proceset gjyqesore, etj). Deri në dhjetor 2020, u trajnuan rreth 700 përdorues të platformës⁴⁹. Gjithashtu për NJQV, do të jetë në përdorim Manuali i delegimit të kompetencave (hartuar në 2020), për të cilin janë parashikuar trajnime për nëpunësit e burimeve njerëzore të administratës shtetërore dhe të NJQV në vitin 2021. Objektivi në vijim është shtrirja e sistemit informatik të menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) në njësitë e vetëqeverisjes vendore⁵⁰.

45 Raport vjetor i financave publike vendore (MFE, 2021)

46 Raporti i KE për Shqipërinë (2020)

47 Raport Progresi i KE për Shqipërinë, 2020

48 Vendim Nr.833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e hollësishme për përmbajtjen dhe administrimin e dosjeve të personelit e te regjistrit qendror të personelit.

49 Raporti progresi PV 2020-2022 SNDQV (MB, 2021)


50 Burim: Raporti i Monitorimit të DAP (2020)

Në 2020, është miratuar VKM nr.90 / 17.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021-2023, dhe VKM nr.290 datë 11.04.2020 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (IPSIS). Është kryer një vlerësim për ngritjen e një sistemi të unifikuar për mbledhjen periodike të informacionit nga NJQV dhe për zbatimin e sistemit IPSIS në nivel vendor për 6 dimensione, midis të cilave ofrimi i shërbimeve publike, menaxhimi financiar, aftësitë dhe kapacitetet e administratës vendore, transparenca dhe llogaridhënia⁵¹. Nuk ka patur progres gjatë 2020, zbatimi i një masë të planit të veprimit 2020-2022 të SNDQV mbi hartimin e formateve standarte për raportimin e informacionit mbi zbatimin e politikave sektoriale nga NJQV dhe zhvillimin e një sistemi unik të mbledhjes së të dhënave. Bashkitë nuk kanë një sistem të unifikuar të vjetarit statistikor⁵² si dhe nuk kanë sisteme të informatizuara të mbajtjes së statistikave, të cilat do të ndihmonin në mbajtjen dhe raportimin e të dhënave në mënyrë sistematike.


Punësimi në administratën vendore dhe shërbimet publike në bashki

Në total i punonjësve të 61 bashkive ishte 29873 në 2020, nga të cilët 11098 (ose 37% të numrit të përgjithshëm) i përkasin administratës vendore dhe 14802 është numri gjithsej i punonjësve në shërbimet bashkiake (n=60).

Sic shihet nga grafiku i mëposhtëm nuk ekziston një raport i drejtë i përbërjes së personelit të bashkisë lidhur me numrin e punonjësve në administratën bashkiake dhe numrin e punonjësve të punësuar në sektorët e shërbimeve bashkiake. Në nivel kombëtar administrata bashkiake zë rreth 39%. Bashkia Fushë-Arrëz raporton numrin më të vogël të administratës së bashkisë me 30 persona (13%), e ndjekur nga Bashkia Mirditë (15%), kursë Bashkitë Peqin (89%) dhe Pogradec (85%) janë bashkitë që rezultojnë me raportin më të madh të të punësuarve në administratën qëndrore të bashkisë kundrejt numrit total të punonjësve.



Grafiku 11: Numri total i punonjësve të bashkive, 2020



Grafiku 12: Shkalla e punësimit në administratë dhe shërbime publike sipas bashkive, 2020


51 Me mbështetje të projektit STAR 2 (Raport i progresit PV 2020-2022 SNDQV, MB, 2021).
52 Raport progresi PV 2020-2022 SNDQV (MB, 2021)

Shkalla mesatare e nëpunësve me status të nëpunësit civil në raport me numrin total të punonjësve në administratën vendore ishte rreth 39% në 2020 (ose 4,625 nëpunës civil), por ky tregues ndryshon nga 5% deri 90% për bashki të ndryshme (n=56). Treguesi rezulton me vlerë më të vogël si % ndaj totalit por është numër më i lartë në numër në krahasim me vitin 2019 (45% të administratës vendore, ose 4,275 nëpunës civil në 2019). Korça, Kruja dhe Kurbini raportojnë % më të lartë të stafit të mbuluar nga ligji i shërbimit civil. Kurse Bashkitë, Vlorë, Maliq, Malësia e Madhe dhe Vorë nuk kanë dhënë asnjë të dhënë për këtë tregues.


Në administratën vendore, numri gjithsej femrave në shërbim civil ishte 3744, në 2020, me nivel mesatar 34% (n=56).

Treguesi rezulton më i lartë krahasuar me vitin 2019 (2,595 nëpunëse femra). Kruja dhe Mirëdita janë bashkitë që paraqiten më mirë lidhur me këtë tregues.


Numri gjithësej i stafit në nivel drejtues në administratën vendore (Sekretar i Përgjithshëm, drejtor, përgjegjës sektori, administrator njësie vendore) ishte 2096 në 2002, nga të cilat 462 femra (ose 22% të numrit total të pozicioneve drejtuese, n=58). Rreth 24% është niveli mesatar i femrave në pozicione drejtuese por treguesi ndryshon mjaft nga një bashki në tjetrën (në v.2019 është raportuar 1,808 nëpunës në pozicione drejtuese, nga të cilat 650 femra). Saranda rezulton të jetë bashkia që ka nivelin më të lartë të femrave në pozicionet drejtuese.



Grafiku 13: Shkalla e nëpunësve vendore me status kundrejt numrit të administratës vendore (në %)



Grafiku 14: Shkalla e punësimit të femrave me status në raport me numrin total të nëpunësve me status, sipas bashkive, 2020 (në %)



Grafiku 15: Shkalla e punësimit të femrave në nivel drejtuesi në raport me numrin e pozicioneve drejtuese, sipas bashkive, 2020 (në %)


Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të administratës vendore nëpërmjet trajnimeve

Trajnimet e organizuara nga ASPA janë kryer mbi bazën e analizës së nevojave individuale për trajnime. ASPA përgatiti 61 raporte individuale për trajnime për bashkitë e vendit. Disa nga trajnimet e organizuara nga ASPA me mbështetje të projekteve me financim të huaj, gjatë 2020, lidhen me buxhetimin e përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane (192 pjesëmarrës⁵³), financat vendore dhe buxhetimi i përgjigjshëm gjinor në PBA, mbështetje për mundësi të barabarta në politikat vendore⁵⁴ (116 pjesëmarrës) Integrimi Evropian në nivel vendor⁵⁵, dhe trajnime të tjera.


55 Bashki kanë marrë pjesë në 776 programe trajnimi të organizuara nga ASPA (mesatarisht 14 programe trajnimi për bashki). Rreth 1,460 nëpunës vendor janë trajnuar gjatë 2020 nga ASPA, sipas raportimit të burimeve njerëzore të bashkive (n=60)⁵⁶. Bashkia e Tiranës ka patur numrin më të lartë të punonjësve të trajnuar nga ASPA në 2020 (34% të numrit total).

Punonjësit e Bashkive kanë marrë pjesë edhe në trajnime nga ofrues të tjerë përveç ASPA, sipas raportimit nga zyrat e burimeve njerëzore në bashki, gjithsej 1131 nëpunës vendor të trajnuar (mesatarisht 20 nëpunës vendore për bashki, n=57). Mesatarisht, bashkitë kanë buxhetuar 1% të buxhetit të tyre vendor për trajnime për nëpunësit vendorë në 2020. Ky nivel edhe pse I vogël ka pësuar një rritje gati 3 fish në krahasim me vitin 2019 (mesatarisht 0.39% të buxhetit, 2019).

Një nga fushat kryesore të trajnimeve për administratën vendore ka qenë njohja e legjislacionit të shërbimit civil (ligj 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (NC), i ndryshuar dhe aktet nën.ligjore të tij). Në 2020, janë trajnuar 312 nëpunës vendorë, mesatarisht 6 nëpunës për bashki (n=56). Bashkitë Kamëz, Lezhë, Pukë, Skrapar dhe Tiranë kanë patur numrin më të lartë të punonjësve të trajnuar për legjislacionin e NC (treguesi është më I vogël kundrejt 2019 (1089 nëpunës të trajnuar). Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS) edhe pse ka qenë funksional është përdorur vetëm nga 56% e bashkive raportuese, në 2020.



Harta 2: Sistemi HRMIS funksional



Grafiku 16 Nëpunës vendor të trajnuar nga ASPA, 2020

53 ROMACTED II (BE, CoE)
 54 Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS)
 55 Projekti IPA “Bashkitë në procesin e integritimit Evropian” BpE
 56 Nga ASPA është raportuar 6130 nëpunës vendor të trajnuar në 2020.


Largimet nga administrata vendore

Qëllimi i ligjit për NC (152/2013) dhe i reformës së administratës publike është krijimi i një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike. Një nga fushat e vlerësimit të performancës së administratës vendore përkundrejt treguesve të performancës janë largimet nga administrata vendore. Ndryshimi i strukturave të administratës dhe shërbimeve, daljet në pension, migracioni, influencat politike dhe masat administrative përkundrejt veprimeve që bien ndesh me ligjin dhe parimet e etikës janë shkaqet kryesore të largimeve nga administrata.


Në 2020, janë larguar 410 nëpunës vendorë për shkak të daljes në pension, ose mesatarisht 7 punonjës për bashki (n=56), ndërsa numri total i të larguarve për shkaqe të ndryshme ishte 1491 (mesatarisht 26 të larguar, n=56).

Nga informacioni i raportuar nga strukturat e bashkive, ka patur nivel të lartë të largimeve nga bashkia Lezhë (194 largime, 6% për shkak të daljes në pension), bashkia Përmet (125 largime, 16% largime për shkak të daljes në pension), bashkia Pogradec (119, 13% dalje në pension), bashkia Kavajë (107 largime, 3% dalje në pension), Bashkia Klos (81 largime, 1% dalje në pension), Bashkia Fier (60 largime, 83% dalje në pension) dhe bashkia Berat (58 largime, 34% dalje në pension).

Numrin më të madh të punonjësve vendorë të larguar në raport me numrin total të punonjësve të bashkisë, në 2020, e ka patur bashkia Përmet (40%), Bashkia Pogradec (39%), Bashkia Klos (34%), Bashkia Lezhë (26%), Bashkia Rrogozhinë (22%), Bashkia Kavajë (18%), Bashkia Bulqizë dhe Prrenjas (13%).



Grafiku 17 Numri i përgjithshëm i të larguarve nga administrata vendore, 2020



Grafiku 18 Shkalla e largimeve (në % të numrit total të punonjësve të bashkisë), 2020

Probleme dhe sfida

- Vonesa në miratimin e legjislacionit zbatues dhe ndryshimin e legjislacionit sektorial⁵⁷.
- Koordinimi i strategjive kombëtare sektoriale me planet vendore është i dobët⁵⁷.
- Sigurimi i qëndrueshmërisë në administratën vendore dhe ofrimi i trajnimeve cilësore.
- Konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative që lidhet me bashkëpunimin ndërbashkiak për tipe të ndryshme shërbimesh, si pjesë e synimeve të SNDQV PV 2020-2022.
- Përmirësimi i sistemeve të monitorimit të zbatimit të politikave në nivel vendor; krijimi i strukturave të menaxhimit të performancës në bashki, si pjesë e synimeve të SNDQV dhe PV 2020-2022.
- Sistemi i informacionit për menaxhimin e burimeve njerëzore (HRMIS) nuk është plotësisht funksional dhe duhet të shtrihet në gjithë nivelin vendor.
- Bashkitë alokojnë pak fonde për qëllime trajnime të punonjësve dhe nëpunësve vendorë.
- Mungesa e një sistemi të unifikuar të treguesve për shërbime të ndryshme të ofruara nga NJQV që vështirëson monitorimin efektiv të ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët.

Rekomandime


- Përmirësimi i kuadrit rregullator për planifikimin dhe monitorimin e politikave dhe aplikimi i sistemit të integruar të politikbërjes edhe në nivel vendor.
- Nevojitet trajnim më i madh për të përmirësuar kapacitetet e administrates vendore për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin.
- Monitorimi i treguesve të reformës në administratën publike të shtrihet edhe në NJQV, dhe të bëhet publikimi i të dhënave në platformën “administrata.al”.
- Hartimi dhe konsultimi i një seti të unifikuar treguesish për monitorimin e ofrimit të shërbimeve publike nga NJQV përkundrejt kërkesave ligjore dhe dokumentave strategjike⁵⁸.
- Hartimi i modeleve “template” të procedurave të monitorimit dhe raportimit të NJQV për performancën e shërbimeve në vijim të procesit të lidhur me Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit, me syllim raportimin e standartizuar zbatimin koherent të procedurës për monitorimin e performancës nga të gjithë NJQV dhe përmirësimin cilësor të Raportit të Performancës së bashkisë.
- Ngritja e njësisë së monitorimit dhe performancës të jetë mbi bazën e një modeli të rekomanduar dhe konsultuar në KK dhe NJQV dhe shoqatat e vetëqeverisjes vendore.
- NJQV të hartojnë një rregullore dhe përshkrime pune të përditësuara mbi bazën e formatit të ri të DAP e cila të synojë përmirësimin e përgjegjësive të përgjithshme të strukturës kryesore koordinatore për monitorimin e zbatimit të politikave në nivel vendor dhe për të rritur kontrollin e cilësisë të raporteve dhe treguesve të performancës në fusha/funksione të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.
- Rritja e trajnimeve për administratën vendore dhe krijimi i regjistrit në bashki për punonjësit e trajnuar.

Objektivi specifik: përmirësimi i llogaridhënies së administratës vendore


Performanca e NJQV lidhur me objektivin specifik vlerësohet mbi bazën e tre treguesve të performancës: (i) numri i përgjigjeve të dhëna për kërkesat e qytetarëve ndaj numrit të përgjithshëm të dorëzuar pranë bashkisë⁵⁹, (ii) numri i akteve të vendimmarrësve vendor të publikuar në regjistrin elektronik të bashkisë, mbi numrin total të akteve të miratuar nga bashkia gjatë vitit të raportimit, (iii) numri i raporteve mbi konstatimet/ rekomandimet nga Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit të cilat bashkia i ka refuzuar kundrejt numrit të përgjithshëm të raporteve të dorëzuara në bashki nga KMDDHP.

Në 2020, shkalla mesatare e kthim-përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve rezulton 81% në 2020 (n=57); treguesi është me trend zbritës kundrejt 2019 (mesatarja 93%; në 2018 ishte 82%). Rreth 50% e bashkive kanë patur një shkallë të kthim përgjigjeje 95%-100%. Mungesa e raportimit për këtë tregues nga 4 bashki mund të jetë faktor në vlerën e ulur të treguesit.


Mesatarisht, raporti i publikimit të akteve të vendimmarrësve vendor (vendime të kryetarit dhe KB) në regjistrin elektronik të bashkisë kundrejt numrit total të akteve të miratuar ishte 70% (n=51).



Grafiku 19: Shkalla e përgjigjeve të administratës vendore ndaj ankesave të qytetarëve



Grafiku 20 Shkalla e publikimit të akteve të organeve vendimmarrëse (kryetari dhe KB), 2020



Grafiku 21: Trendi i publikimit të akteve të organeve vendimmarrëse, 2017-2020 (në %)

59 Rregullimi i procesit dhe standartet për regjistrimin, shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve dhe kthim-përgjigjet për çështje administrative bazohen në ligj 139/2015 dhe ligj 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Shkalla e publikimit të akteve të organeve vendimmarrëse në 2020 rezulton më e lartë krahasuar me periudhën 2017-2019, çfarë tregon për një rritje të transparencës në vendimmarrje. E drejta e qytetarëve për administrim të mirë është e kufizuar. Institucionet publike nuk zbatojnë në mënyrë sistematike rekomandimet e organeve të mbikëqyrjes. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të ketë kompetenca më të mëdha mbikëqyrjeje.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)⁶⁰ gjatë 2020 ka trajtuar gjithsej 226 çështje, janë pritur 125 qytetarë të interesuar për të marrë informacion për mënyrën e paraqitjes së një ankese dhe 380 telefonata (hyrëse dhe dalëse). Numri i çështjeve të rregjistruara në fushën e të mirave dhe shërbimeve për vitin 2020 ka qenë 70. Nga 60 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 32 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 28 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor të cilat lidheshin kryesisht me mos dhënien e shërbimeve të nevojshme nga NJQV ndaj individëve të ndryshëm, që u përkasin komuniteteve dhe shtresave vulnerabël⁶¹. Në 2020, vetëm 10 bashki kanë raportuar mbi marrjen e rekomandimeve nga KMD.

Gjatë vitit 2020, ka patur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, të paraqitura pranë KMD. Bashkitë, nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave janë: Tiranë, Fier, Korçë, Shkodër, Elbasan, Berat, Mat, Durrës, etj. Në 57 ankesa, ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.


Shkalla mesatare e refuzimit të rekomandimeve të KMD, si raport i numrit të përgjithshëm të dorëzuar nga KMD në bashki ishte 6% në 2020. Treguesi ka rritje të lehtë nga 5% për 2017-2018 dhe 4% në 2019.

Probleme dhe sfida

- Vlerësimi i raporteve të KMD nga ana e menaxherëve të lartë dhe administratës bashkiake dhe plotësimi i kërkesave dhe rekomandimeve e proceseve⁶².
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore në nivel rajoni dhe institucioneve vendore për adresimin e çështjeve të rekomanduara nga KMD.
- Mbeshtetja ligjore dhe sociale e grupeve në nevojë për të eliminuar format e diskriminimit⁶³.
- Sfide është infrastruktura e vjetër, që nuk ka lejuar vendosjen e sinjalistikës për personat që nuk dëgjojnë dhe shikojnë⁶⁴.

Rekomandime

- Forcimi i kompetencave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për rritjen e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.
- Zgjerimi i mbulimit të rregjistrit qendror për kërkesat për informacion⁶⁵.



Grafiku 22: Shpërndarja e ankesave sipas bashkive
Burim: Raporti vjetor 2020 KMD

60 Në kuadër të ushtrimit të kompetencave Ligj nr.10221 / 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
61 Raport KMD, 2020
62 Bashkia Kamëz, Patos, Kavajë, Berat, Tropojë
63 Bashkia Mirditë
64 Bashkia Kurbin.
65 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë 2020


1.1.3 Avokati i Popullit

E drejta e qytetarëve për administrim të mirë është e kufizuar. Numri i rekomandimeve të Avokatit të Popullit që zbatohen mbetet i ulët.⁶⁶

Institucioni i Avokatit të Popullit⁶⁷, në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik të institucionit⁶⁸ për periudhën 2019-2022, synon krijimin dhe zhvillimin e një kulture të qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve të Shqipërisë, si dhe forcim të përgjithshëm të sundimit të ligjit, elementë të domosdoshëm për funksionimin e demokracisë. Rregjistri i rekomandimeve tek rubrika e transparencës përditësohet rregullisht në faqen avokatipopullit.gov.al/sq/article/transparency.

Qeverisja Vendore është një nga fushat kryesore të angazhimit publik të AP në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve shqiptarë nga organet e qeverisjes vendore. Nga 1797 ankesa të marra në 2020, rezultojnë se rreth 520 prej tyre (ose rreth 30% e rasteve) janë adresuar ndaj institucioneve në nivel qarku dhe organeve të Njësisë të Qeverisjes Vendore. Ankesa lidhen kryesisht me fushat: e drejta e pronësisë, zgjidhja e problemit të strehimit (përfshirë dhe problematikat e krijuara nga tërmeti), papunësia, ndërprerje e ndihmës ekonomike, të drejtat e fëmijëve, personat me AK, dhe ankesa që lidhen me problematika të krijuara si rezultat i situatave të krijuara nga pandemia (në arsim, shëndetësi, etj), ofrimin e shërbimeve publike dhe mungesën e investimeve në infrastrukturë, etj⁶⁹.

Në vitin 2020, NJQV kanë marrë gjithsej 460 raporte/rekomandime nga institucioni i AP (n=53), ose mesatarisht 9 raporte/rekomandime. Treguesi ka qenë me rritje (190 raporte më shumë në 2020 kundrejt 2019).



Grafiku 23 Numri i raporteve dhe rekomandimeve nga institucioni i Avokatit të Popullit për NJQV, 2020

66 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë, 2020

67 Avokati i Popullit (AP) vepron në bazë të Ligjit nr.8454/1999, plotësuar me ligjin 8600/2000, ndryshuar me Ligjin 9398/2005, shtuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 155/2014. AP trajton ankesa të cilat grupohen në: (i) ankesa jashtë juridiksionit, (ii) ankesa jashtë kompetencave, (iii) ankesa të pabazuara, (iv) ankesa me rekomandime të pranuar, (v) ankesa të pranuar pa rekomandim (të zgjidhura në favor të qytetarit, ankesa me heqje dore.

68 Me mbështetjen e Zyrës së Ombudsmanit Danez dhe Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut

69 Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit , 2020 <https://avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëebsite/reports/>

Kutia 2:


Niveli i zbatimit të rekomandimeve

Për vitin 2020, institucioni i AP ka konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut në 256 raste për të cilat ka bërë dhe rekomandimet përkatëse drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve rezultojnë se:

- 142 rekomandime ose 55 % e tyre janë pranuar;
- 24 rekomandime ose 9% e tyre janë refuzuar;
- 34 rekomandime ose 13% e tyre janë pa përgjigje;
- 49 rekomandime ose 19 % e tyre janë në proces;
- 7 rekomandime ose 3% e tyre janë me status të papërcaktuar.

Vihet re se bashkitë Fier dhe Sarandë janë ndër bashkitë që kanë marrë numër të lartë të raporteve/rekomandimeve të adresuara nga AP për vitin 2019 dhe 2020.

Për 71% të raporteve/rekomandimeve të adresuara nga AP për NJQV, janë marrë masa nga bashkitë për adresimin e tyre (327 raporte nga 460 raporte në total), ndërsa 192 raporte/rekomandime janë në proces shqyrtimi brenda afateve kohore ligjore.



Grafiku 24: Raporte / rekomandime të adresuara nga Avokati i Popullit për NJQV, të pranuar nga bashkitë

Problemet dhe sfidat

- Forcimi i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit për ndjekjen e rasteve të referuara në kohë.
- Vëmendje më e madhe nga autoritetet dhe strukturat e bashkive për adresimin në kohë sa më të shkurtër të raporteve dhe rekomandimeve të adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për NJQV.

Rekomandime

- Të ngrihet një mekanizëm raportimi transparent në nivel vendor nëpërmjet një sistemi të unifikuar on-line për të siguruar mbledhjen e informacionit të saktë dhe të detajuar nga bashkitë mbi raportet/rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit për NJQV.
- Rritja e transparencës ndaj publikut lidhur me zbatimin e rekomandimeve të AP nëpërmjet publikimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në faqen e internetit të bashkisë si dhe në Platformën Ndërinstitucionale të faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë⁷⁰.


1.1.4 Shoqëria civile

Në Raportin e Progresit të KE për Shqipërinë (2020) citohet se: “Nuk është bërë progress lidhur me zbatimin e udhërrëfyesit për një mjedis mundësues për shoqërinë civile. Nevojiten përpjekje thelbësore për të siguruar konsultime kuptimplote dhe sistematike me shoqërinë civile si pjesë e një dialogu për politika gjithëpërfshirëse për reformat”.

Progresi në arritjen e objektivit “forcimi i rolit të shoqërisë civile dhe rritja e bashkëpunimit në nivel vendor” vlerësohet nëpërmjet 4 treguesve kryesorë:

Në 2020, numri i përgjithshëm i rekomandimeve të ofruara nga OSHC gjatë procesit të vendimmarrjes vendore dhe çështje të tjera mbi mirëqeverisjen vendore kanë qenë 320 ose mesatarisht 6 rekomandime (n=53). Treguesi rezulton me rritje (18%) krahasuar me 2019 (270 rekomandime). OSHC të bashkisë Durrës kanë dhënë numrin më të lartë të rekomandimeve, gjithsej 114, pasuar nga bashkia Peqin 56 rekomandime.

Nga 320 rekomandime të dhëna nga OSHC gjatë 2020, 236 rekomandime janë marrë në shqyrtim nga bashkia (ose 74% e tyre), nga të cilat janë pranuar 225 rekomandime (70% të totali të rekomandimeve). Të dy treguesit janë më të lartë krahasuar me vitin 2019 (50%).



Grafiku 25: Rekomandime të OSHC të ofruara dhe të shqyrtuara/ të pranuar nga NJQV 2020

Ndërmjet bashkive raportuese, vihet re se bashkia Durrës ka marrë 114 rekomandime por raporton zero rekomandime të marra në shqyrtim / dhe të pranuar nga bashkia, Bashki Berat (3 rekomandime), Devoll (3), Dimal (5), Elbasan (5), Kamëz (5), Lushnjë (1), Përmet (10) kanë reflektuar të gjitha rekomandimet në vendimmarrjen vendore, Bashkia Tiranë (nga 12 ka reflektuar 9), dhe bashkia Peqin (nga 56 ka reflektuar vetëm 2).

59 grante janë dhënë nga bashkitë për projekte në partneritet me Organizatat e Shoqërisë Civile në 2020, nga 18 bashki (30% e bashkive). Projektet kanë qenë kryesisht në çështje të rinisë, punësimit, përkrahjës sociale, mbështetje për pakicat romë dhe egjiptiane dhe aftësia e kufizuar. Numri i granteve krahasuar me vitin 2019 (71 grante) është më i ulët, si rezultat edhe i mobilizimit të fondeve për përballimin e pandemisë Covid-19.


Bashkitë me numër më të lartë të granteve ishin Bashki e Tiranës me 15 grante, bashkia Shkodër (11 grante), bashkia Përmet (6 grante) dhe Bashkia Gjirokastrë (4 grante). Bashkitë e tjera kanë dhënë nga 1-3 grante, ndërsa 35 bashki (57%) nuk kanë dhënë asnjë grant në 2020.

Problemet dhe sfidat

- Burime financiare të vogla nga bashkitë për projekte zhvillimi me interes vendor për organizata të shoqërisë civile.
- Vihet re rënie e angazhimit të shoqërisë civile si dhe cilësia e diskutimeve publike shpesh ka të bëjë me një mungesë profesionalizmi për sa i përket qasjes dhe performancës.

Rekomandime

- Disa nga rekomandimet e raportit të mëparshëm mbetën të vlefshme.
- Të forcohet partneriteti me organizatat e shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse të NJQV
- Të rritet angazhimi i bashkive për të rregjistruar dhe bërë publike në programin e transparencës rekomandimet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile dhe reflektimi i tyre në vendimmarrjen vendore.



Grafiku 26: Grante nga NJQV për projekte në partneritet me OSHC, 2020

KONKLUZIONE MBI DEMOKRACINË

Këshilli Konsultativ (KK) ka vijuar të kryejë rolin dhe detyrat lidhur me konsultimin e projektakteve ligjore që impaktojnë institucionet e vetëqeverisjes vendore. Vazhdon të mbëtët shqetësim angazhimi serioz i institucioneve qendrore në pjesëmarrjen dhe forcimin e dialogut me vetëqeverisjen. Vëmendja nga niveli vendor është më e lartë ndaj nevojës për këtë dialog, por cilësia e diskutimeve mbetet ende për t'u përmirësuar. Konsultimet për çdo ndryshim ligjor me ndikim në vetëqeverisjen vendore duhet të iniciohen që në fillim të procesit të hartimit të akteve ligjore dhe jo në fund të këtij procesi. Kapaciteti i Sekretariatit të KK duhet të forcohet me burime njerëzore të kualifikuara në fushën ligjore.

Progresi i lartë është bërë në drejtim të digjitalizimit të shërbimeve. Është thjeshtëzuar dokumentacioni dhe procedurat e punës. Në 2020 u ngriten 6 qendra të integruara të reja të ZNjN duke arritur në 59 ZNjN në total, ndërsa numri i shërbimeve të qeverisë qendrore dhe vendore me ndërveprim të përmirësuar u rrit rreth 2.5 here. Numri i qytetarëve që kanë aplikuar për shërbime online ishte 87,372 gjatë 2020. Sfidë për zgjerimin e sistemit të ZNjN është sigurimi i ambienteve të përshtatshme në bashkitë dhe investimet e duhura dhe vijimi i trajnimit të stafit të ZNjN. Mbetet e nevojshme shtrirja e shërbimeve në gjithë territorin dhe vendosja e standarteve minimale të shërbimeve publike të ofruara nga qendrat e integruara më një ndalesë. Roli mbikqyrës i ADISA-s për të siguruar standartet e cilësisë së shërbimit publike të ofruara nga bashkitë duhet të forcohet.

Pavarësisht progresit të administratës vendore më shumë duhet të bëhet për zbatimin e ligjit të shërbimit civil në nivel vendor, përmirësimin e transparencës për mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e burimeve njerëzore ndërmjet nivelit të qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike nga NJQV. Ndonëse është zhvilluar më tej kuadri ligjor për përmirësimin e ndërveprimit midis institucioneve publike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore nëpërmjet platformës "administrata.al" përdorimi i sistemit dixhital për menaxhimin e burimeve njerëzore HRMIS HRMIS nga ana e bashkive mbetet problematik. Është rritur numri i trajnimeve të ofruara nga ASPA si dhe numri i nëpunësve vendorë të trajnuar. Më shumë fonde të buxhetit vendor janë përdorur për trajnime në 2020, por ka ende bashki që nuk planifikojnë fond për trajnime të stafit në buxhetin e tyre.

Bashkitë kanë bërë progres të mëtjshëm lidhur me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen vendore dhe përmirësimin e transparencës së financave vendore duke rritur numrin e dëgjësive publike në procesin e përgatitjes së buxhetit edhe pse numri i pjesëmarrësve në dëgjesat ka qenë më vogël, si rezultat i situatës së pandemisë. Duhet më shumë transparence në drejtim të llogaridhënies mbi realizimin e të ardhurave dhe shpen-

zimeve. Numri i dëgjësive publike në këtë drejtim ka pësuar rënie. Është rritur ndjeshëm numri i bashkive që kanë publikuar buxhetin e bashkisë në faqen zyrtare të bashkisë si dhe në faqen e internetit 'financatvendore.al'.

Zbatimi në nivel vendor i ligjit "Për konsultimin publik" mbetet i pakënaqshëm. Kërkohej forcimi i kapaciteteve institucionale në drejtim të monitorimit dhe raportimit mbi bazë të rezultateve/treguesve si pjesë e raportimeve për ekzekutimin e buxhetit vendor dhe ngritja e një strukture për monitorimin e performancës për fusha të ndryshme, mbi bazën e një modeli të njëjtë për të gjitha bashkitë.

Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për informacion dhe ankesave të tyre si pjesë e forcimit të llogaridhënies së pushtetit vendor ka pësuar ulje gjatë 2020. Ka përmirësim në drejtim të transparencës së vendimmarrjes së këshillave bashkiakë nëpërmjet publikimit të akteve vendimmarrëse. Mbetet shqetësim trajtimi i rekomandimeve të nxjerra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me mungesën e dhënies së shërbimeve të nevojshme nga NJQV ndaj komuniteteve dhe shtresave vulnerabël. Në 2020, vihet re zgjerim të shtrirjes gjeografike të ankesave me pretendim diskriminim, të paraqitura pranë KMD, dhe rritje e lehte e shkallës së refuzimit të rekomandimeve të KMD nga ana e NJQV. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të ketë kompetenca më të mëdha mbikqyrjeje. 1/3 e ankesave drejtuar nga qytetarët pranë Avokatit të Popullit janë për bashkitë. Bashkitë bëjnë përpjekje për adresimin e rekomandimeve të AP por duhet të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional në nivel vendor me synim trajtimin ligjor të rekomandimeve të paraqitura nga Avokatit i Popullit dhe ngritja e një mekanizmi raportimi transparent nëpërmjet një sistemi të unifikuar online për të siguruar mbledhjen e informacionit të saktë dhe të detajuar nga bashkitë mbi raportet/rekomandimet e adresuara nga Avokati i Popullit për NJQV.

Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor mbetet një sfidë. Organizatat e shoqërisë civile, gjatë vitit 2020, në kushtet e pandemisë dhe kufizimit të lirisë kanë patur shumë vështirësi por kanë qenë aktive për monitorimin e kuadrit ligjor për të drejtat themelore dhe lirinë e qytetarëve dhe kanë ofruar mbështetje për NJQV për identifikimin dhe ofrimin e mbështetjes për familjet dhe komunitetet në nevojë. Financimi për OSHC ka pësuar rënie, ndërkohë që duhet të rriten kapacitetet e OSHC për përfshirje në procedurat e tenderimeve të fushës sociale (mundësi më të mëdha angazhimi).

1.2 SHTETI I SË DREJTËS

1.2.1 Lufta kundër korrupsionit

“Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje sa i takon luftës kundër korrupsionit. Autoritetet shqiptare kanë forcuar kapacitetet operacionale, koordinuese dhe monitoruese në luftën kundër korrupsionit. Kapaciteti i rrjetit kundër korrupsionit në ministrinë e linjës, në nivel lokal dhe në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (NCAC) është i dobët⁷¹”.

Prej vitit 2015 Shqipëria zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020 (SNKK). Me Vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 të Këshillit të Ministrave afati i zbatimit të strategjise dhe Planit të Veprimit u zgjat deri në vitin 2023. Vizioni i SNKK-së 2015-2023 është: “Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”. Plani i Veprimit 2020-2023 është një dokument me 83 masa që përfshin 22 institucione, të cilat do të punojnë së bashku për më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efencë në ritmin e luftës kundër korrupsionit në vend.

Objektivi specifik: Përmirësimi i efijencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit, matet nëpërmjet vlerësimit katër treguesve të performancës:

Numri i rasteve të ankimuar nga biznesi dhe qytetarët për shkelje të procedurave administrative dhe korrupsion (përfshirë prokurimin publik): Në 2020, janë regjistruar gjithsej 627 ankesa (N=57), ose mesatarisht 11 ankesa për bashki. Numri ankesave është katër herë më i lartë se në 2019 (162), ku Bashkia Tiranë zë vendin kryesor me 50% të totalit të ankesave të regjistruara⁷².

Numri i nëpunësve të administratës vendore që kanë deklaruar pasurinë, sipas mënyrës së kërkuar me ligj (raportuar nga Burimet Njerëzore). Të paktën 1zyrtar i zgjedhur në bashki ka kryer deklarimin e pasurisë në përputhje me ligjin⁷³. Nga raportimi për këtë vit vihet re një ulje nga 2019 ku kanë deklaruar mesatarisht 2 persona, kjo për arsye të faktit që detyrimi ligjor për deklarim të pasurisë është vetëm për Kryetarin e Bashkisë⁷⁴.

Numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga nëpunësit vendorë dhe Këshilli Bashkiak gjatë marrjes së vendimeve. Në 2020, janë raportuar gjithsej 627 raste të konfliktit të interesit nga 9 bashki, ose mesatarisht 11.2 raste për bashki. Bashkia Tiranë ka patur numrin më të madh të rasteve (363), pasuar nga Bashkia Kolonjë (225), Kruja dhe Peqini me nga 15 raste secila⁷⁵.

Ngritja e një rrjeti të koordinatoreve vendorë anti-korrupsion në bashki. Caktimi i nëpunësit publik në kapacitetin e koordinatorit vendor anti-korrupsion në zbatim të Planit të Veprimit në luftën kundër korrupsionit është kryer nga 62% e bashkive. Në vitin 2020 caktimi i koordinatorit vendor është kryer edhe nga 10 bashki të tjera⁷⁶, pra në total 37 bashki (N=60).⁷⁷ Sic jepet edhe nga grafiku i mëposhtëm ngritja e rrjetit anti-korrupsion në nivelin vendor po ndodh me hapja shumë të ngadaltë.



Grafiku 27: Koordinator anti-korrupsion i emëruar në bashki, 2017-2020

71 1 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)

2 Bashkitë Vlorë, Shijak, Vorë e Maliq nuk kanë raportuar të dhëna

3 Ligji nr.9049/2003, i ndryshuar “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”

72 Bashkitë Vlorë, Shijak, Vorë e Maliq nuk kanë raportuar të dhëna

Ligji nr.9049/2003, i ndryshuar “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”

74 Bashkia Malësi e Madhe nuk ka raportuar të dhëna për këtë tregues

75 47 Bashki raportojnë se nuk kanë patur asnjë rast të deklarimit të konfliktit të interesit (0)

76 Dibër, Dimal, Gramsh, Klos, Kucovë, Memaliaj, Patos, Pogradec, Rrogozhinë, Sarandë

77 Bashkia Maliq nuk ka raportuar të dhëna për këtë tregues

Kutia 3: Praktika të mira në përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe ankesave


Bashkia Shkodër: Përditësimi i të dhënave bëhet në menyre periodike. Gjithashtu është ndërtuar platforma e transparencës së buxhetit, kjo platformë është integruar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër. Të gjithë qytetarët e Shkodrës, të gjithë të interesuarit mund të marrin informacion në kohë reale mbi atë çfarë ndodh në territorin e Bashkisë Shkodër. Instrumenti hedh dritë mbi atë çfarë Bashkia realizon por njëkohësisht shërben për marrjen e mendimeve, sugjerimeve dhe kritikave, në mënyrë që të përmirësohet puna e Bashkisë.

Bashkia Mirditë: Regjistri i kërkesave dhe ankesave përditësohet cdo 3 muaj.


Bashkia Përmet: Regjistri i kërkesave për informacion përditësohet minimalisht çdo muaj.

Bashkia Pogradec: regjistri elektronik është përditësuar 100% në vitin 2020.

Bashkia Kuçovë nuk ka regjistër elektronik por një regjistër manual i cili përditësohet çdo ditë dhe protokollohet nga zyra e protokollimit.




Harta 4 Ngritja e regjistrimit elektronik të bashkisë




Grafiku 29: Shkalla e përditësimit të rregjistrimit elektronik të NJQV, 2020

Objektivi specifik: miratimi i politikave anti-korrupsion në nivel vendor

Në 2020 numri i Bashkive që kanë miratuar Planin e Integritetit Vendor mbetet ende 6 Durrës, Elbasan, Gjirokastrë, Mallakaster, Mat dhe Patos⁷⁹, ndërsa 14 bashki janë në fazën e hartimit të tij. Nga 19 bashki që kanë të miratuar planin vendor të integritetit në 2020, vetëm 3 prej tyre Bashkitë e Dropullit, Policanit dhe Shkodrës kanë përfshirë në buxhet mjetet financiare për zbatimin e masave të planit vendor. Ky tregues mbetet ende në nivele jo të kënaqshme pasi mungesa e burimeve financiare vë në rrezik zbatimin e planit dhe arritjen e progresit në këtë drejtim.



Harta 5: Plani i Integritetit në nivel vendor



Harta 6: Planifikimi në buxhetin e fondit për politikën antikorrupsion

Problemet dhe sfidat:

- Vonesa në caktimin e koordinatorit vendor anti-korrupsion mbetet problematikë në një numër të konsiderueshëm të Bashkive.
- Numri i ulët i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore në luftën ndaj korrupsionit.
- Mungesa e informacionit dhe ndergjegjësimi i ulët i bizneseve dhe qytetarëve për të ankmuar mbi shkeljet e procedurave administrative.
- Mungesa e planifikimit të fondeve në buxhetet e Bashkive për zbatimin e planeve vendore antikorrupsion.
- Burimet njerëzore të pamjaftueshme për zbatimin në nivel vendor të masave të strategjisë kombëtare kundër korrupsionit si edhe planeve vendore antikorrupsion.
- Mungesa e fondeve në buxhet dhe stafeve të bashkive për ngritjen e regjistrit elektronik po ashtu edhe e trajnimeve të posaçme për përdorimin e regjistrit elektronik.

Rekomandime

- Forcimi i transparencës së autoriteteve publike dhe shtimi i shërbimeve publike online në mënyrë progresive.
- Përmirësimi i ndërveprimit të autoriteve që marrin denoncime kundër korrupsionit dhe deri në ndërshkrimin e tij⁸⁰;
- Përmirësimi i aksesit në regjistrat elektronikë kombëtar për autoritetet e zbatimit të Ligjit⁸¹.
- Ofrimi i asistencës teknike për hartimin e Planeve Vendore Kundër Korrupsionit për bashkitë që ende nuk e kanë përmbushur këtë detyrim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023.
- Monitorim më i ngushtë nga Ministria e Drejtësisë lidhur me caktimin e koordinatorit/pikës së kontaktit antikorrupsion nga Bashkitë që ende se kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.
- Pajisja me një regjistër elektronik për bashkitë që nuk e kanë ende funksional.
- Sigurimi i bashkërendimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore për zbatimin e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit Anti-korrupsion 2020-2023.

80 Plani i Veprimit Anti-korrupsion 2020-2023

81 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)

KONKLUZIONE MBI SHETIN E SË DREJTËS

Ka progres të ngadalshëm nga Njësitë e Qeverisjes Vendore për rritjen e efektivitetit në luftën ndaj korrupsionit si dhe në zbatimin e kuadrit strategjik dhe Ligjor në këtë fushë. Emërimi i nëpunësve publik, në kapacitetin e koordinatorit vendor anti-korrupsion në zbatim të Planit të Veprimit në luftën kundër korrupsionit, është vetëm kryer nga 62% e bashkive.

Duhet të bëhet më shumë progres në forcimin e kapaciteteve të punonjësve të bashkive për çështjet antikorrupsion përmes shtimit të trajnimeve dhe numrit të punojësve të trajnuar. Hartimi i Planeve të Integritetit në të gjitha Bashkitë si dhe sigurimi i trajnimeve të dedikuara për çështjet antikorrupsion janë elementët kyç për një efikasitet më të lartë të luftës ndaj korrupsionit në nivel vendor.

Është rritur ndërgjegjësimi i qytetarëve ndaj transparencës së bashkive në marrjen e vendimeve. Kjo reflektohet në numrin në rritje të ankesave nga biznesi e qytetarët për shkelje të procedurave. Ngritja dhe bërja funksional i Regjistrat Elektronik të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve të Bashkive ka vijuar me ritme të kënaqshme, por duhet të theksohet se jo të gjitha bashkitë i kushtojnë vëmendje përditësimit periodik të regjistrat elektronik. Sigurimi i financimeve për ngritjen e regjistrat elektronik dhe trajnimi i stafëve për përdorimin e tij mbetet prioritet.

1.3 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E PAKICAVE

“Gjatë vitit 2020 Shqipëria bëri disa përpjekje për të përm-bushur detyrimet që dalin nga instrumentet ligjore ndërkom-bëtare të lidhura me: Zbatimin e Ligjit për Strehimin Social me nëntë akte nënligjore të miratuara pas një procesi të gjerë konsultimi. Kuadri ligjor në fushat e të drejtave të fëmijëve dhe drejtësisë për të miturit janë përmirësuar gjithashtu me akte nënligjore⁸²”.

Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

22 Bashki kanë përfituar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë vendorë për zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut në vitin 2020. Në total janë kryer 116 programe trajnimi, ose mesatarisht 2 trajnime për çdo bashki duke mbetur në të njëjtat nivele me vitin 2019. Numri më i madh i trajnimeve raportohet nga Bashkia Kamëz (30) pasuar nga bashkia Berat (20), Tirana (11) dhe Peqini (10) ndërkohë që 21 Bashki ose 40 % e totalit raportojnë 0 trajnime për 2020⁸³.

Në 2020 janë trajnuar 126 nëpunës vendorë mbi zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut. Trajnimet për këtë vit kanë qenë rreth 8% më shumë në krahasim me 2019. Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e kanë Bashkia Pogradec (25), Bashkia Tiranë (23), Bashkia Berat (15) dhe Elbasan (15).

Nga grupet ndërinstitucionale që funksionojnë në nivel vendor me përfaqësimin e stafit të bashkisë, në vitin 2020 janë trajtuar gjithsej 515 raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut, ose mesatarisht 9 raste për 58 bashki raportuese; Vihet re një rritje e theksuar e rasteve të trajtuara por edhe të referuara në nivel vendor në vitin 2020 dhe kryesisht në bashkitë e vogla. Rastet e referuara janë kryesisht në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe dhunës në familje kryesisht ndaj grave dhe fëmijëve.

Kutia 4- Bashkëpunimi i me organizatat e shoqërisë civile

Bashkia Kavajë: 48 raste janë evidentuar dhe trajtuar në bashkëpunim me OSHC-të liçensuar në 2020

Bashkia Shkodër: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka aktive 16 marrëveshje bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile të cilat në fokus të punës së tyre kanë edhe trajtimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Bashkia Dibër: ka 2 OSHC që bashkëpunojnë me bashkinë për të trajtuar rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut në kuadër të projekteve të ndryshme që ato zbatojnë në Dibër.

Bashkia Tiranë: Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, ka trajtuar 90 kërkesa në bashkëpunim me OSHC dhe institucione për shkelje të të drejtave të njeriut, 37 prej të cilave janë shkelje të të drejtave të fëmijëve.

Bashkia Kavajë: 48 raste të evidentuara dhe trajtuar në bashkëpunim me OSHC-të liçensuar

82 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)

83 Bashkitë Cerrik, Dibër, Fushë Arrëz, Has, Himarë, Malësi e Madhe, Maliq, Memaliaj, dhe Sarandë, nuk kanë raportuar për këtë tregues

Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në 2020 janë referuar nga 16 bashki, gjithsej 557 raste, ose rreth 3.5 herë më shumë se numri i referuar në vitin 2019 (166). Bashkia Kamëz ka raportuar numrin më të madh të shkeljeve të të drejtave të njeriut (287 raste), pasuar nga Bashkia Maliq (52) dhe Bashkia Kavajë (48 raste); rreth 59% e bashkive nuk kanë patur raste të referuar të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Edhe gjatë 2020 është raportuar një bashkëpunim në rritje me organizata të shoqërisë civile në nivel vendor por edhe me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në mbrojtje dhe për zbatimin e të drejtave të njeriut. Janë raportuar 487 raste të bashkëpunimit me OSHC ose mesatarisht 9 raste për Bashki (N=53). Bashkia Kamëz ka numrin më të madh (287 raste) gati 50 % të totalit të rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut në 2020 e ndjekur nga Bashkia Tiranë (90 raste).

Kutia 5: Praktika të mira në trajtimin e rasteve të shkeljes të të drejtave të njeriut nga grupet ndër-institucionale

Bashkia Kamëz: Në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Koordinatorit Vendor Kundër Dhunës janë trajtuar 287 raste të dhunes në familje dhe fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Pjesa më e madhe e rasteve janë trajtuar në nivel ndër-sektorial duke ndare detyrat dhe funksionet sipas parashikimeve në ligj. Rastet janë referuar nga institucione si policia, organizata, psikologe të shkollave etj.

Bashkia Tropojë: Ka ndjekur të gjitha procedurat sipas marrëveshjes së bashkërendimit të koordinimit të punës Mekanizmit të Koordinuar për Rastet e dhunës dhe anetarët e Grupit Teknik Ndërinstitucional.

Bashkia Klos: Ka referuar 3 raste dhune brenda Mekanizmit të Koordinuar për menaxhimin e rasteve të dhunes në familje, për të ofruar atyre shërbim sipas nevojave.

Bashkia Gramsh: Ka trajtuar 11 raste dhe i është dhënë ndihmë sipas nevojave.

Problemet dhe sfidat

- Organizatat e Shoqërisë Civile që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut në Bashkitë e vogla janë të krijuara rishtazi. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë ende të pa licensiuara.
- Funksionimi jo i duhur i koordinimit ndërinstitucional për referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe trajtimin e tyre në kohë dhe me efektivitet dhe mungese e një dialogu permanent dhe transparent midis tyre dhe komunitetit në monitorimin e zbatimit të detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Mungesa e të dhënave të sakta mbi rastet e dhunës dhe statistikave zyrtare të rasteve të trajtuara dhe shërbimet e dhëna.
- Bashkëpunim ende i ulët dhe jo i strukturuar me OSHC të specializuara kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Kapacitetet e kufizuara të strukturave në varësi të Bashkisë që ndjekin rastet e dhunës në familje dhe të të miturve sic janë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve të ngritura pranë Bashkive.

Rekomandime

- Përmirësimi i punës së grupeve ndërinstitucionale që trajtojnë rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut.
- Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve dhe OS-HC-ve për trajtimin e rasteve të referuara me ekspertizën e tyre si dhe për të përfituar nga trajnimet që u ofrohen nëpunësve vendorë.
- Përmirësimi i njohurive dhe rritja e vetëdijes për standardet e të drejtave të njeriut për zyrtarët vendorë përmes trajnimeve dhe pjesëmarrësjes në konferenca kombëtare e rajonale.
- Përmirësimi i mëtejshëm i mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen e viktimave të dhuna në familje, promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, garantimi i gjinisë barazinë dhe ofrimin e shërbimeve minimale shëndetësore dhe sociale, veçanërisht në nivelin lokal⁸⁴;
- Rritja e alokimeve financiare për trajtimin e problematikave të fëmijëve dhe përmirësimi i instrumentave për të realizuar buxhetimin me qendër fëmijën në nivel qendror dhe vendor.
- Forcimin e kapaciteteve të punonjësve që mbulojnë fushën e mbrojtjes dhe shërbimeve të fëmijëve dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara dhe njohura nga institucionet koordinuese lidhur me këtë fushë⁸⁵.

KONKLUZIONE MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Ka patur një rritje të theksuar të rasteve të referuara dhe trajtuara në nivel vendor në vitin 2020 dhe kryesisht në bashkitë e vogla. Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në 2020 janë referuar 3.5 herë më shumë se numri i referuar në vitin 2019. Rastet e referuara janë të lidhura me dhunën në familje kryesisht ndaj grave dhe fëmijëve. Vlen për tu theksuar roli në rritje i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve të ngritura në nivel vendor si dhe bashkëpunimi në rritje me strukturat e policisë, institucionet e tjera vendore si ato arsimore dhe organizatat e Shoqërisë Civile. Ka një bashkëpunim në rritje me organizatat të shoqërisë civile në nivel vendor por edhe me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në mbrojtje dhe për zbatimin e të drejtave të njeriut.

Progres i limituar është bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të nëpunësve vendor mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Vetëm 36% e bashkive kanë përfituar trajnime në vitin 2020 për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë vendorë për zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut. Numri i trajnimeve për nëpunësit e administratës vendore për aspekte të mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka ardhur në ulje nga viti 2018, në një kohë kur rastet për shkelje të drejtave të njeriut kanë ardhur në rritje.

84 Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)


85 Raporti i zbatimit "Agjenda Kombëtare e Mbrojtjes së Fëmijëve" MSHMS Dhjetor 2020

- KAPITULLI 2 - KRITERI EKONOMIK

2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Ekonomi tregu funksionale dhe aftësia për të trajtuar konkurrencën e BE-së dhe forcat e tregut

“Për sa u përket kritereve ekonomike, Shqipëria ka bërë disa përparime dhe është e përgatitur në mënyrë të moderuar për zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale dhe ka një lloj niveli përgatitjeje lidhur me aftësinë e saj për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Konkurrenca e Shqipërisë pengohet nga mungesa e ekspertizës sipërmarrëse dhe teknologjike, një hendek i konsiderueshëm aftësisë, institucione të dobëta dhe nivele të ulëta të investimeve dhe cilësisë së infrastrukturës⁸⁶”.




Harta 7 Miratimi i Planeve të Zhvillimit Vendor, 2020

Objektivi specifik: përmirësimi i mjedisit të biznesit

Progresi mbi objektivin specifik vlerësohet nga pesë (5) tregues përformance:

Në 2020 janë gjithsej 50 bashki që kanë hartuar dhe miratuar planin e zhvillimit vendor në Këshillin Bashkiak (ose 82% e bashkive). Treguesi tregon rritje të konsiderueshme me 13 p.p. krahasuar me vitin 2019 dhe 15 p.p. krahasuar me 2018. Janë 9 Bashki⁸⁷ të cilat nuk e kanë miratuar Planin e Zhvillimit Vendor si një instrument tejet i rëndësishëm për identifikimin e prioritetëve vendore dhe planifikimin e fondeve buxhetore për financimin e tyre. Bashkitë Shijak e Devolli nuk kanë dhënë asnjë informacion për këtë tregues.



Grafiku 30: Miratimi i Planit të Zhvillimit Vendor në Këshillin Bashkiak 2017-2020

Në vitin 2020 vetëm 22 Bashki (36%) kanë realizuar aktivitete stimuluuese për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla në zbatim të planeve të zhvillimit vendor. Janë ndërmarrë 89 aktivitete stimuluuese (mesatarisht 1.75 për bashki). Treguesi ka ulje nga viti 2019 me një total prej 110 aktivitete stimuluuese. Numrin më të madh të aktiviteteve stimuluuese e ka ofruar Bashkia e Beratit (20) pasuar nga Bashkia Selenicë (11) dhe Bashkia Shkodër (8)⁸⁸.

86 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)

87 Bulqizë, Durrës, Divjakë, Finiq, Fushë-Arrëz, Këlcyrë, Libohovë, Maliq, Vorë

88 Bashkitë Durrës, Kavajë, Memaliaj, Patos, Polican, Rroskovec, Shijak, Tiranë, Vlorë dhe Vorë nuk kanë raportuar për këtë tregues

Vihet re ulje e numrit të aktiviteteve stimuluere për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla në vitin 2020 kjo për shkak të situatës me pandeminë COVID 19 ku edhe vetë aktiviteti i SME-ve ka qënë më i ulët në nivel kombëtar. Disa bashki kanë parashikuar lehtësira fiskale për SME-të e reja si dhe heqje të tarifës së regjistrimit për subjektet e reja apo krijimi i zonave depresive ekonomike me lehtësira fiskale për subjekte ekzistuese si dhe të reja në këto zona⁸⁹.

Gjithashtu është mundësuar falja e tarifave vendore për subjektet e transportit publik apo shtyrja e afatit të pagesave të taksave dhe tarifave vendore⁹⁰. Përjashtimin nga taksa dhe tarifa vendore për një periudhë 3-mujore të vitit 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve individë, familje, persona fizik dhe juridik, ambulant, OJF, Institucione publike⁹¹. Lehtësimi i faljes së tarifave për bizneset turistike përgjatë 6 muorit të parë të vitit 2020 si kontigjent i prekur më shumë nga pandemia.⁹² Bashki të tjera të cilat kanë ndërmarrë lehtësira fiskale për SME gjatë vitit 2020 për shkak të situatës së pandemisë janë: Roskovec, Bulqizë, Dropull, Kamëz, Kolonjë, Konispol, Përmet, Tropojë.

Në vitin 2020 janë raportuar në total 150 shërbime në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ose mesatarisht 3.41 për bashki (N=44). Janë 26 Bashki që kanë ofruar shërbime ku numrin më të madh e raporton Bashkia Kukës me 52 shërbime të ofruara përmes Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Zyrës me një Ndalesë (OSSH) të Bashkisë. Bashkia Tiranë rendidet e dyta me 25 shërbime të cilat janë ambjente tregtare të dhëna me qira (Pazari i Ri) dhe 1 grant financiar për biznese të gjelbërta. Bashkitë e tjera raportojnë dhënie të shërbimeve kryesisht për pastrimin, gjelbërimin, transportin, parkimin dhe ndricimin e hapësirave publike.

Kutia 6. Aktivitete stimuluere në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Bashkia Cërrik: Ka organizuar disa panaire dhe fushata të ndryshme të mbjelljes dhe shtimit të haëesiravë të gjelbëruara;

Bashkia Kamëz: ka organizuar 3 aktivitete stimulese për ngritjen e bizneseve të reja me pjesëmarrës gra dhe të rinj.


Bashkia Këlcyrë: Ka organizuar panairin e prodhimeve blegtorale dhe bujqësore karakteristike të zonës Këlcyrë.

Bashkia Korçë: Ka zhvilluar disa aktivitete në fushën e artizanatit, ICT (teknologji e informacionit, në fushën e arsimit privat si dhe trajnime dhe kualifikime në fusha të ndryshme profesionale.

Bashkia Pogradec: Ka organizuar “Festën e Verës” me traditë kulinare, folklorike dhe kulturore si dhe Festa e “Teto Ollgës” ku janë promovuar shërbimeve dhe produkte artizanale.

Bashkia Selenicë: Ka ndërmarrë disa aktivitete në njësitë administrative, Brataj, Armen, Kotë, Vllahinë, Sevaster dhe Selenicë për promovimin e biznesit të vogël.

Bashkia Tropojë: Ka realizuar tre aktivitete stimuluere si: hapja sezonit turistik në Valbonë, Lekbibaj dhe në Sylbice me panaire të ndryshme tradicionale.



Grafiku 31: Aktivitete stimuluere në mbështetje të biznesit të vogël e të

89 Bashkia Berat
90 Bashkia Gramsh
91 Bashkia Shkodër
92 Bashkia Gjirokastrë


Në vitin 2020 është shënuar një rritje e ndjeshme në numrin e rekomandimeve të dhëna nga bashkitë në ndihmë të bizneseve të vogla dhe të mesme me një total prej 642 rekomandime (N=50) ose mesatarisht 12.84 rekomandime për bashki nga mesatarja prej 2.34 në vitin 2019. Bashkia Shkodër ashtu si edhe në vitin 2019, sërisht raporton numrin më të madh të rekomandimeve (345) ose 50% e totalit të rekomandimeve, pasuar nga Bashkia Mat (150) dhe Bashkia Peqin (20).

Në vitin 2020, është raportuar krijimi i 10,842 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ose mesatarisht 190.2 (N=57), që rezultojnë më shumë se në vitin 2019 (7402 ndërmarrje të reja). Bashkia e Tiranës raporton numrin më të madh të kompanive të vogla dhe të mesme të krijuara në 2020 (5696), pasuar nga Bashkia Durrës (1151), Bashkia Sarandë (730), Bashkia Shkodër (483) dhe Bashkia Elbasan (390). Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë filluar aktivitetin në territorin e bashkive ka ardhur në rritje nga viti 2018 në 2020 me një rritje prej 40%⁹³.

Gjatë Vitit 2020 edhe numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat kanë mbyllur aktivitetin në territorin e Bashkisë ka qënë i konsiderueshëm. Në total janë mbyllur 6745 ose mesatarisht 132.25 NVM/bashki. Kjo shpjegohet edhe nga situata e pandemisë COVID 19 ku një numër i madh biznesesh të vogla e të mesme nuk i mbijetuan dot krizës financiare të krijuar nga mbyllja e aktivitetit. Numrin më të madh të ndërmarrjeve të mbyllura e kanë sërisht bashkitë e përmëndura më lart të cilat kanë raportuar edhe numrin më të të bizneseve të hapura.

Bashkia e Tiranës raporton numrin më të madh të kompanive të vogla dhe të mesme të mbyllura në 2020 (2477), pasuar nga Bashkia Durrës (1151), Bashkia Shkodër (768), Bashkia Sarandë (520), Bashkia Korçë (379) dhe Bashkia Elbasan (168).

Shkalla e ndërlidhjes së prioriteteve të Programit Buxhetor afat-mesëm me prioritetet e Planit të Zhvillimit Vendor është raportuar në nivelin mesatar prej 70%. Raportimi për këtë tregues është bërë vetëm nga 40 Bashki.



Grafiku 32: Shkalla e ndërlidhjes së prioriteteve të PBA me Planin e Zhvillimit Vendor

93 Në vitin 2017 ka patur një mungesë të theksuar raportimi

Problemet dhe sfidat

- Sitata e pandemisë ka afektuar pjesën më të madhë të Bashkive ku të ardhurat financiare janë reduktuar ndjeshëm. Kjo ka çuar në uljen e buxheteve për shërbime dhe mbështetje financiare në stimulimin e SME-ve e cila ka qënë e kufizuar.
- Lehtësirat fiskale të ofruara nga Bashkitë për SMETë në përmballimin e krizës financiare për shkak të COVID 19 kanë ulur të ardhurat e bashkive.
- Kapacitetet e ulta të bashkive për të ofruar këshillime dhe orientime të bizneseve të reja dhe mundësitat që egzistojne për ngrijen e sturt-upeve.
- Mungesa e burimeve financiare dhe teknike për hartimin e planve vendore të zhvillimit.
- Niveli i ulët në mbledhjen e taksave dhe tarifave nga bashkitë si dhe borxhet e prapambetura kanë reduktuar ndjeshëm buxhetin e bashkive për financimin e projekteve strategjike.
- Mungojnë mekanizmat e qëndrueshëm të bashkëpunimit mbidis qeverisjes vendore dhe bizneseve.

Rekomandime

- Përfundimi i hartimit dhe miratimit të Planeve të Përgjithshme Vendore nga Bashkitë që ende nuk e kanë realizuar. Planet vendore janë një instrument shumë i rëndësishëm planifikimi dhe orientimi për rallokimin e financimeve drejt prioriteteve më kryesore të tyre.
- Ndërtimi i mekanizmave dhe programeve për mbështetjen e NVM-ve si dhe krijimin e incentivave për t'ju qasur sektorëve më prioritarë dhe potencialeve të zhvillimit në territorin e Bashkisë.
- Bashkëpunimi më i ngushtë me institucionet ndërkombëtare dhe donatorët që mbështesin me programe të dedikuara zhvillimin e NMV-ve egzistuese si dhe krijimin e Start-up-ve.
- Përmirësimi i shërbimeve vendore për komunitetin e biznesit duke lehtësuar procedurat administrative përmes sistemit të zyrës me një ndalesë.
- Krijimi i mekanizmave efektivë të konsultimit me bizneset dhe partnerët socialë në nivelin vendor për të garantuar transparencën dhe parashikueshmërinë e masave mbështetëse dhe legjislacionit;

KONKLUSIONE MBI EKZISTENCËN E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

Gjatë vitit 2020 ekonomia e vendit dhe bizneset kanë ndjerë efektet negative të krijuara nga Pandemia COVID 19. Si rrjedhojë edhe puna e bashkive është orientuar në marrjen e masave për të zvogëluar impaktin negativ tek bizneset përmes lehtësirave fiskale të ofruara në një numër të madh të bashkive. Kjo situatë solli ulje të të ardhurave të bashkive dhe kufizime në ofrimin e shërbimeve për përmirësimin e bizneseve apo dhënien e financimeve. Kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të orientuar dhe këshilluar NVM-të mbi mundësitë dhe potencialet për zhvillim, sidomos në situatën kritike të vitit 2020.

Hapja e bizneve të reja ka vazhduar me ritme të kënaqshme edhe gjatë vitit 2020 pavarësisht situatës së pandemisë e cila në mënyrë të pashmangshme shkaktoi mbylljen e një numri të konsiderueshëm të bizneseve në disa bashki të vendit. Krijimi i NVM-ve raportohet për bashki të mëdha si Bashkia e Tiranës, Shkodër e Elbasan por edhe në Bashkitë me aktivitet turistik si Bashkitë e Durrësit dhe Sarandës.

Forcimi i qeverisjes së mire, përmirësimi i proceseve të planifikimit strategjik dhe orientimi i bizneseve lokale drejt prioriteteve lokale të zhvillimit duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm janë vendimtare për mbështetjen e zhvillimit ekonomik në nivelin vendor. Në këtë këndvështrim kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të përmirësuar proceset e planifikimit dhe adresimit të prioritetve përmes hartimit të planeve të Zhvillimit Vendor nga 50 Bashki. Po ashtu edhe shkalla e ndërlikohjes së Programit Buxhetor Afatmesëm me planet zhvillimore raportohet në rritje, por mbetet ende në nivele jo të kënaqshme. Konsultimi i planeve vendore dhe prioriteteve të programeve buxhetore afatmesme me komunitetin e biznesit mbeten procese shumë të rëndësishme të cilat duhet të marrin vëmendjen dhe angazhimin e organeve drejtuese në nivelin vendor.

AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

3.1 Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Politika e përbashkët bujqësore (PPB) mbështet fermerët dhe zhvillimin rural. Kjo kërkon sisteme të forta menaxhimi dhe kontrolli. Ka gjithashtu edhe rregulla të përbashkëta të BE-së për politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike.

“Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje në bujqësi dhe zhvillim rural. Gjatë periudhës së raportimit, pati ca progres lidhur me miratimin dhe zbatimin e kuadrit të ri ligjor për politikën e cilësisë; sigurimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e instrumentit për ndihmën e paraanëtarësimit për programin e zhvillimit rural (IPARD II)”⁹⁴.

Çështje të tjera të rëndësishme horizontale të vlerësuara / rekomanduara në raportin e progresit për Shqipërinë (2020) janë ndërtimi me përparësi i regjistrimit të fermave, si element i sistemit të integruar të administrimit dhe kontrollit, mungesë të rrjetit të të dhënave të kontabilitetit të fermave.

Në 2020, është punuar për zhvillimin e mëtejshëm të bazës ligjore⁹⁵: është hartuar vendimi dhe udhëzimi për masat mbështetëse të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, vkm për “Miratimin e draftligjit “Për vreshtarinë dhe verën”, vendimi për “Kultivimin, grumbullimin, përpunimin, prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të produkteve të tij”, dhe draft udhëzimi/vkm për regjistrimin e fermës. Gjithashtu, në KK për vetëqeverisjen vendore është diskutuar projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1108, datë 30.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë të Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, të ndryshuar”. Synimet e politikës për bujqësinë dhe zhvillimin rural në nivel vendor dhe në kuadër të integritimit ev-


ropian, të cilat janë objekt vlerësimi, në kuadër të këtij raporti lidhen me katër objektiva specifike: (i) forcimi i kapaciteteve të administratës të vetëqeverisjes vendore për sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor, (ii) përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, (iii) zbatimi i qasjes LEADER dhe (iv) regjistrimi i titujve të pronësisë në bujqësi (AMTP).

Rritja e kapaciteteve të administratës vendore në sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor: Shërbimi këshillimor publik, në nivel qendror organizohet nga Sektori Këshillimit dhe Kooperimit Bujqësor në Ministrinë e Bujqësisë, ndërsa në nivel rajonal përfaqësohet nga Sektorët e Shërbimit Këshillimor në përbërje të Drejtorive të Bujqësisë, ku në përputhje me specifikat e çdo rajoni, janë 3-4 specialistë të profilizuar (Hortikulturë, Mbrojtje bimësh, Zooteknik dhe Ekonomistë). Në nivel terreni zhvillojnë veprimtarinë e tyre Qendrat e Informacioni Bujqësor dhe ekstensionistët ku operon një specialist bujqësie/ekstensionist. Veprimtari e rëndësishme e shërbimit këshillimor është edhe nxitja e organizimit të fermerëve. Për këtë realizohen aktivitete ndryshme si trajnime dhe aktivitete për promovimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore, regjistruar sipas Ligjit “Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor”, Nr.38, datë 05.04.2012, dhe forma të tjera të organizimit të fermerëve⁹⁶.

Në 2020, sipas raportimit të bashkive, Zyrat e Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB), kanë qenë funksionale vetëm në 38 bashki, ose 8 bashki më shumë krahasuar me vitin 2019. ZIKB të reja janë ngritur në bashkinë Lezhë, Kurbin, Peqin, Korçë, Skrapar, Lushnjë dhe Poliçan.

Mesatarisht, fondi bujqësor për zhvillimin rural ka qenë 5.3% i buxhetit vendor të bashkisë në 2020, i cili rezulton më i vogël krahasuar me vitin 2019 (7.7%). Përqindja më e madhe dedikuar fondit bujqësor raportohet nga bashkitë Pogradec, Selënice, Gramsh e Peqin.


94 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)
95 Ligji 9817/2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin
96 Burim: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural




Grafiku 33: Fondi vendor për zhvillimin bujqësor dhe rural, 2020

Çdo vit, nëpërmjet një programi trajnimi, realizohet kualifikimi i ekstensionistëve, fermerëve dhe të interesuarve të tjerë. Shërbimi këshillimor publik bashkëpunon dhe me ofrues të tjerë të shërbimit këshillimor siç janë ofruesit publikë (QTTB, Universiteti Bujqësor), ofruesit privat të shërbimeve, organizatat prodhuese dhe organizatat jo qeveritare. Në 2020, kanë marrë pjesë 28 bashki në trajnime të ofruara nga ZIKB për prioritetet kombëtare në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në përputhje me procesin e integritimit në BE (mbi konkurrueshmërinë e sektorit të bujqësisë dhe përmirësimin e teknikave të prodhimit, IPARD (ose 4 bashki më pak se 2019). Numri i trajnimeve ka qenë 105 (më i larte krahasuar me vitin 2019 (91 trainime).

Llojet e shërbimeve të ofruara janë dhënia e informacionit mbi teknikat dhe teknologjitë për prodhimin bimor dhe blegtoral, inpute cilësore, legjislacionin, menaxhimin e fermës, kooperimin e fermerëve, plane biznesi, mundësitë e kreditimit, marketingun e prodhimeve bujqësore, çmimet e tregjet, potencialet prodhuese, mundësitë e përpunimit, prognoze-sinjalizimin i sëmundjeve dhe dëmtuesve, sigurinë ushqimore. Shërbimi këshillimor organizohet me forma të ndryshme komunikimi dhe me aktivitete të programuara si: demonstrime, ditë e fushe, takime individuale dhe takime në grup, vizita, trajnime, panaiere, seminare, ëorkshope, fletëpalosje, botime, aktivitete për zhvillimin e shoqatave të fermerëve, shkryme, emisione dhe kronika televizive, video etj. Në 2020, nga ZIKB kanë marrë shërbime rreth 29,842 persona.



Grafiku 34: Trajnime të punonjësve të Zyrave të Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor, 2020



Grafiku 35: Numri i përfituesve që kanë marrë shërbime nga zyrat e këshillimit në bujqësi, 2020

Objektivi specifik: përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, përmirësimi i infrastrukturës rurale, zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale.


Qëllimet kryesore të qeverisë për bujqësinë janë rritja e prodhimit për njësi sipërfaqe dhe gradualisht rritja e sasisë së ujit të destinuar për ujitje, si dhe rritja e punësimit në sektorin bujqësor dhe të ardhurave që gjenerohen nga ky sektor. Ujitja dhe kullimi janë faktorë kyç në arritjen e këtyre qëllimeve. Aktualisht në Shqipëri, sipërfaqja që mund të ujitet vlerësohet në rreth 360,000 ha.

Treguesit e performancës në lidhje me këtë objektiv specifik përfshijnë: (i) përmirësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, (ii) përmirësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit (iii) grante të dhëna për fermerët. Për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, në 2020, qeveria ka kryer 3.6 miliard lekë (1.6 miliard leke investim i huaj dhe 2 miliard lekë investim i brendshëm). Me investimet e brendshme në ujitje janë zbatuar 67 projekte, nga të cilat 53 i përkasin rehabilitimit të skemave ujitëse, ndërsa


14 rehabilitimit të digave (8 projekte i përkasin Drejtorive të Ujitjes dhe të Kullimit, ndërsa 59 projekte i përkasin bashkive). Investimi në ujitje është i shtrirë në dy vite (2020-2021) dhe për vitin 2020 impakti i tyre është rreth 10 000 ha me infrastrukturë ujitëse të përmirësuar.

Me Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes të Bankës Botërore, gjate vitit 2020, kanë përfunduar rehabilitimi i 7 skemave ujitëse, vazhdim nga viti 2019 (Dega e Lushnjës dhe Dega e Çukazit në Lushnjë, skema Leminotit në Maliq, Skema e Slanicës në Urën Vajgurore, skemat Tregtan nr.2 dhe në Has. Gjithashtu janë realizuar rreth 80% e punimeve në skemën ujitëse të Janjarit, që shtrihet në bashkitë Konispol e Finiq. Rezultati është që sipërfaqja ujitëse me infrastrukturë të rehabilituar arriti në 21,000 ha.

Mesatarisht rreth 78% e rrjetit ujitës dhe kullues është marrë në dorëzim nga bashkitë, por niveli i inventarizimit është i ndryshëm për bashkitë që raportojnë nga 10% në 100%; 12 bashki nuk kanë raportuar për treguesin.



Grafiku 36: Shkalla e mirëmbajtjes së rrjetit ujitës, 2020



Grafiku 37: Shkalla e marrjes në inventar nga bashkitë të rrjetit të ujitjes dhe kullimit


Sistemi i rrjetit të ujitjes është mirëmbajtur nga bashkitë në një nivel mesatar prej 54% (n=58); shkalla e mirëmbajtjes ka qenë më e lartë në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 (36% si nivel mesatar i mirëmbajtjes). Bashkitë që kanë një mbulim të lartë të rrjetit në 2020 kanë qenë: Bashkia Devoll (90% mbulim në 2020 krahasuar me 30% në 2019), Bashkia Lezhe (95% në 2020 krahasuar me 10% në 2019), Bashkia Bulqizë (100% në 2020 krahasuar me 68% në 2019), Bashkia Mat (100% në 2020 krahasuar me 50% në 2019), dhe bashkia Maliq (100% në 2020 krahasuar me 30% në 2019).

Mirëmbajtja e sistemit të kullimit nga bashkië ka përmirësuar në 2020, në një nivel mesatar 61% (n=49), krahasuar me 38% në vitin 2019. Rreth 57% e bashkive kanë patur një nivel mirëmbajtje të rrjetit kullues më të larë se 60%. Sic vihet re nga grafiku më poshtë bashkitë po tregojnë një përpjekje më


të shtuar në drejtim të mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes dhe kullimit të tokës.

Në 2020, niveli mesatar i mbulimit me ujitje të sipërfaqes së tokës bujqësore ka qenë 42%.


Drejtoritë Rajonale të U&K dhe bashkitë, në bashkëpunim me OPU-të, duhet të hartojnë buxhetin vjetor të sistemit ujitës bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve të përshkruara në Planin e Shërbimit të Ujitjes, i cili hartohet sipas një performace standarde, e cila garanton funksionimin normal të skemës ujitëse. Çdo skemë ujitëse do të menaxhohet si një njësi e pandarë financiare. Çdo skemë ka koston e saj dhe buxhetin e saj, në varësi të specifikave të veta⁹⁷. Pritshmëria është që për të gjitha skemat ujitëse të hartohen dhe zbatohen buxhete “bazuar mbi nevoja” ose buxhete “bazuar në performancë”.



Grafiku 38: Shkalla e mirëmbajtjes së sistemit kullues, 2020



Grafiku 39: Sipërfaqja e tokës bujqësore që ujitet në raport me totalin e sipërfaqeve



Grafiku 40: Shkalla mesatare e mirëmbajtjes së rrjetit të ujitjes dhe kullimit të administruar nga bashkitë

Kutia 7:

Sfida për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit

Bashkia Blesh, Berat: Kërkohen investime që të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes ekzistuese për kanalet ujitëse.

Bashkia Devoll: Për të vënë në funksion të plotë infrastrukturën ujitëse nevojiten më shumë mjete mekanike të përshtatshme sipas terrenit, fuqi punëtore të përhershme, sezonale dhe fonde. Kjo në Bashkinë Devoll do të bënte të mundur funksionimin 100% të këtij shërbimi.

Bashkia Dibër: Formalizimi i dokumentacionit sipas marrjes në dorëzim duke hequr nga lista e inventarit skemat që nuk janë ekzistuese.

Bashkia e Dropull: Mungese fondesh dhe infrastruktura rurale e vështirëson akoma me shumë punën.

Bashkia Kamëz: Percaktimi i buxhetit specifik për mirëmbajtjen dhe vënien në funksion të sistemit.

Bashkia Korçë: Te zgjerohet sistemi ujites nga 70% - 80%.


Bashkia Lezhë: Të bëhet lirim i kanaleve kulluese të zëna, të fillojë puna për rikonstruksion në fillim të vitit.

Bashkia Shkodër: Ekzistojnë projekte zbatimi për të cilat duhet mbështetje me financime.

Objektivi specifik: zbatimi i metodës LEADER

Edhe pse ka patur progres të lehtë lidhur me zbatimin e përqa-sjes LEADER⁹⁸ nga Bashkitë në vitin 2020, ende numri i bashkive që kanë ngritur Grupet Vendore të Veprimit (GVV/LAG) mbetet i vogël, 18 nga 12 që ishin në vitin 2019, ose me pak se 20% e bashkive.

Bashkitë që kanë ngritur GVV për zhvillimin rural në vitin 2020 kanë qenë bashkia Vau i Dejës, Dibër, Bulqizë, Kurbin, Prrrenjas, Gjirokastrë, Delvinë, ndërsa Bashkitë Kukës dhe Krujë kanë raportuar mbi ngritjen e GVV në 2019, por nuk raportojnë ekzistencën e tyre për 2020.



Harta 8: Ngritja e Grupit Vendor të Veprimit për zhvillimin rural


98 Metoda LEADER lidhet me fuqizimin vendor nëpërmjet zhvillimit të strategjisë vendore në bujqësi dhe rritjes së mundësisë për përthithjen e fondeve. Instrument për zbatimin e metodës është krijimi i Grupit Vendor të Veprimit (GVV), i cili është me përfaqësi nga aktorë të ndryshëm: sektori publik, sektori privat (fermerë, etj) dhe shoqëria civile. Qëllimi është të mbështeten fermerët dhe aktorët tjerë të rëndësishëm nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të strategjisë së integruar të zhvillimit rural

Objektivi specifik: përsheptimi i regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi⁹⁹ (AMTP)

Regjistrimi i titujve të pronës në bujqësi dhe marrja e titullit të pronësisë në bujqësi (AMTP) është një prioritet i politikës në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe PV 2020-2022 të SNDQV. Në 2020 ka hyrë në fuqi ligj nr. 20/2020¹⁰⁰ “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”, i cili i kaloi kompetencat për trajtimin e AMTP-ve Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me synim përfundimin e procesit të inventarizimit të pronave të paluajtshme të shtetit, përditësimin e inventarëve të pronave të paluajtshme të pushtetit qendror dhe atyre të transferuara njësive të vetëqeverisjes vendore përpara hyrjes në

fuqi të këtij ligji, si dhe të regjistrimit në regjistrin publik, si dhe trajtimin e mbivendosjeve dhe problemeve të krijuara si pasojë e gabimeve materiale, parregullsive në zbatimin e ligjit apo mosveprimit të organeve shtetërore në fushën e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkitë, rezultojnë se ka patur progres të lehtë në regjistrimin dhe marrjen e aktit të pronësisë; shkalla mesatare e numrit kumulativ të titujve në fund të 2020 ka qenë 41% (n=53) nga 35% që ka qenë në vitin 2019.



Grafiku 41: Tituj të pronësisë në bujqësi (AMTP) të rregjistruar/certifikuar

99 Ligj Nr. 20/2020, neni 4, pika 2 “Akt i Marrjes së Tokës në Pronësi” ose “AMTP” është akti administrativ i lëshuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nga organet kompetente të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore për pronësinë mbi tokën bujqësore, që kishte për qëllim kalimin e pronësisë mbi tokën shtetërore, në favor të subjekteve të së drejtës private.

100 “Aktet ligjore e nënligjore për pronësinë mbi tokën bujqësore” janë ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, i ndryshuar; ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar; ligji nr. 57/2012, “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”; ligji nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore, që kanë rregulluar marrëdhëniet juridike të ndarjes apo dhënies në përdorim të tokës bujqësore pas vitit 1991.

Probleme dhe sfida

- Mungesë të investimeve të mjaftueshme dhe punonjës të shërbimeve për mirëmbajtjen e plotë të sistemit të ujitjes dhe kullimit.
- Formalizimi i dokumentacionit sipas marrjes në dorëzim duke hequr nga lista e inventarit skemat që nuk janë ekzistuese; inventarizimi i plotë i rrjetit ujitës dhe kullues të bashkive.
- Vënia në funksionim dhe rikonstruktimi i stacioneve të pompimit dhe mbulimin i shpenzimeve për energjinë elektrike.
- Cilësia e ulët e shërbimit të ujitjes, mirëmbajtje e pamjaftueshme e rrjeteve të ujitjes.
- Nivel i ulët i pagesës për tarifën e shërbimit të ujitjes, menaxhim financiar i dobët apo jo transparent, pasiviteti i Organizatave të Përdoruesve të Ujit (OPU-ve);
- Sensibilizimi i fermerëve për regjistrimin e pasurisë.
- Disa bashki kanë mungesë të stafit të kualifikuar për mbështetje të procesit të regjistrimit të titujve të pronësisë për tokat bujqësore.
- Sfidë për regjistrimin e titujve të pronësisë në bujqësi mbeten konfliktet e shumta mes pronarëve të tokave dhe proceset gjyqësore.

Rekomandime

- Të rritet alokimi i fondit të qeverisë për bujqësinë krahas fondet të IPARD. Rritja e alokimit të buxhetit për sektorin e bujqësisë nga buxheti vendor.
- Drejtoritë Rajonale të U&K dhe bashkitë, në bashkëpunim me OPU-të, duhet të hartojnë buxhetin vjetor të sistemit ujitës bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve të përshkruara në Planin e Shërbimit të Ujitjes.
- Hartimi i skemave ujitëse bazuar në buxhete “bazuar mbi nevoja” ose buxhete “bazuar në performancë”.
- Planifikimi i fondeve specifike në buxhetin vendor për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit dhe raportimi mbi shpenzimet për këtë funksion i shoqëruar me tregues të performancës për të llogaritur kosto-efektivitetin e shërbimit.
- Të vijojë progresi lidhur me krijimin e një sistemi identifikimi të parcelave të tokës (SIPT)⁹².
- Përsheptimi dhe përfundimi i procesit të regjistrimit të AMTP.
- Forcimi i kapaciteteve të ZIKB nëpërmjet trainimeve dhe ristrukturimit sipas modeleve më të mira.
- Ngritja e GVV /LAG në të gjitha bashkitë të vendit dhe operacionalizimi efektiv i tyre.

KONKLUZIONE MBI BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Në 2020, është punuar për të plotësuar më tej bazën ligjore për bujqësinë dhe zhvillimin rural, mbi masat mbështetëse të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Shërbimi këshillimor i fermave në nivel rajonal u riorganizua në katër rajone kryesore. Ende nuk ka një strategji të qartë të miratuar për të përfunduar reformën e sistemit këshillimor. Ka vijuar puna për krijimin e sistemit të informacionit për tokën (LIS) dhe integrimin e tij në Sistemin e Informacionit Gjeografik (GIS) për disa NJA për 7 bashki¹⁰¹ (për një sipërfaqe 25,083 ha).

Mesatarisht, fondi i alokuar për bujqësinë dhe zhvillimin rural ka qenë më i vogël 5.4% (ose -2.4 p.p kundrejt 2019). Zyrat e Informacionit dhe Këshillimit Bujqësor kanë qenë funksionale vetëm në gjysmat e bashkive. Përmirësim ka patur lidhur me menaxhimin e sistemit të rrjetit të ujitjes dhe kullimit kundrejt 2019, që ka sjellë përmirësim të mbulimit të sipërfaqes së tokës bujqësore, shkalla mesatare e mbulimit rezultoi 42% në 2020.


Progresi shumë i ngadaltën vërehet në krijimin e GVV/ LAG edhe pse në 2020 raportohet krijimi i tyre në 6 bashki të tjera, si dhe procesin e regjistrimit të AMTP (41%) i cili mbetet peng i konflikteve të shumta mes pronarëve të tokave dhe proceseve gjyqësore të papërfunduara.

101 Bashkinë Durrës, Këlcyrë, Përmet, Lezhë, Malesi e Madhe dhe Tirane (Kavajë/Golem)


3.2 Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

Rregullat e higjienës në BE për prodhimin e produkteve ushqimore sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria ushqimore me origjinë shtazore garantojnë së bashku me cilësinë e farave, materialin për mbrojtjen e bimëve, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve¹⁰².

Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje në këtë fushë. Shqipëria ka bërë ca progres lidhur me zbatimin e masave përkatëse në sektorin e sigurisë ushqimore dhe veterinarë, si dhe në regjistrin e kafshëve. Megjithatë, deri tani, ristrukturimi i sektorit veterinar mbetet ende për t'u zbatuar. Shqipëria duhet të hartojë një udhërrëfyes koherent për të siguruar harmonizimin, ndërtimin e kapaciteteve dhe zbatimin e acquis-it të BE-së mbi kontrollin zyrtar, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve në kuadrin e një politike të konsoliduar të sigurisë ushqimore¹⁰⁷. Politika¹⁰³ në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së, hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve në kafshë e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore, monitorimit të ujërave e molusqeve bivale, identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, forcimin e karantinës veterinarë e fitosanitare, përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve, fuqizimin e rrjetit laboratorik, fuqizimin e inspektimeve mbi sigurinë ushqimore, vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe informimin në kohë të konsumatorit.



Grafiku 42: Mbulimi i tregjeve të kafshëve të gjalla nga veterinerë



Grafiku 43: Numri i rasteve të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore të raportuara nga NJQV, 2020

102 Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)

103 Për sigurinë ushqimore, është hartuar dokumenti sektorial për Sigurinë Ushqimore dhe Veterinarinë (me mbështetje të programit IPA II dhe buxheti i shtetit).

Kuadri ligjor është zhvilluar më tej (miratuar ligj për veterinarinë, i ndryshuar dhe ligji “Për ushqimin¹⁰⁴). Në KK për vetëqeverisjen vendore është diskutuar dhe konsultuar projektvendimi “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve, që nuk synohen për t’u konsumuar nga njeriu».


Progresi i bashkive në kuadër të këtij raporti vlerësimi të performancës së NJQV, vlerësohet nga dy objektiva specifike (9 tregues performance).

Objektivi specifik: përmirësimi i kushteve sanitare dhe veterinare me qëllim që të mbrohet shëndeti i konsumatorëve


Numri i veterinerëve në tregjet e kafshëve të gjalla në raport me numrin total të tregjeve të bashkisë. Në nivel kombëtar vetëm

60% e bashkive mbulojnë tregjet e kafshëve të gjalla me veterinerë. Në 2020 kanë qenë 284 veterinerë¹⁰⁵ ose mesatarisht 5 veterinerë në raport me numrin e tregjeve të bashkisë (n=52). Vetëm 2 bashki (3%) raportojnë mbulim të plotë (krahasuar me nivelin 21% në 2019). Rreth 41% e bashkive raportojnë zero vlerë.


Numri i rasteve të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinare të raportuara nga bashkia tek autoritet qendrore në 2020 gjithsej janë 116 raste, ose mesatarisht 2 shkelje (n=58). Treguesi mbetet në nivele të njëjta me ato të raportuara në 2019 (120 shkelje të raportuara). Nga të dhënat rezulton se vetëm 9 bashki kanë raportuar shkelje, nga të cilat 50 raste i përkasin bashkisë Tiranë.



Grafiku 44: Shkalla e licencimit të tregjeve të kafshëve të gjalla në NJQV, 2020



Grafiku 45: Shkalla mesatare e licencimit të tregjeve në NJQV, 2017-2020



Grafiku 46: Numri i punonjësve të NJQV për sigurinë ushqimore, 2020

104 Ligji 16/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa të Ligji 9863/2008 “Për ushqimin”, I ndryshuar
 105 Matrica e treguesve të performancës së bashkive për v.2020

Numrit të tregjeve të kafshëve të gjalla të licensura kundrejt numrit total të tregjeve të kafshëve të gjalla është 23% (n=58), që evidenton një përmirësim kundrejt vitit 2019 (19% shkalla mesatare). Treguesi ndryshon nga 10% në 100. Vetëm 18% e bashkive (11 bashki) raportojnë se tregjet e tyre janë plotësisht të licensuara.


Shkalla e konformitetit të tregjeve publike të shitjes me pakicë në përputhje me standartet e higjienës dhe shërbimit (e shprehur në % të numrit total të tregjeve në territorin e bashkisë), ka qenë 40% mesatarisht (n=57); treguesi është në të njëjtin nivel me atë të vitit 2019.

Ngritja e qendrave për kafshët e abandonuara nga bashkia raportohet vetëm nga pesë (5) bashki (8%), edhe pse mbetet një detyrim i legjislacionit të sektorit.


Në nivel kombëtar dhe bazuar në raportimin e bashkive, rezulton se numri total i punojnësve të bashkisë në lidhje me sigurinë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare ka qenë 187 (mesatarisht 3 punonjës, n=59). Tirana raporton numrin me të madh, kurse bashkitë Divjake, Polican, Himarë e Cerrik nuk raportojnë asnjë person të ngarkuar me sigurinë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare.

Objektivi specifik: Funksonimi eficient i sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve

Ngritja e zyrave të konsumatorit vazhdon të mbetet me ritme të ngadalta. Në 2020, 27 bashki kanë raportuar se zyrat e konsumatorit ka qenë e ngritur dhe funksionale pranë bashkisë. Numri total i ankesave të dorëzuara nga qytetarët mbi sigurinë ushqimore pranë zyrës së konsumatorit në bashki ka qenë 292 në vitin 2020 (ose mesatarisht 5, n=55). Ky numër ndryshon midis bashkive: bashkia Bulqizë (50 ankesa), Bashkia Devoll (45 ankesa), bashkia Kamëz (36), Bashkia Sarandë dhe Peqin (30), ndërsa tetë bashki të tjera (më pak se 20 ankesa). 47 bashki (77%) raportojnë zero ankesa të qytetarëve lidhur me sigurinë ushqimore gjatë vitit 2020. Bashkitë kanë vepruar me marrjen e masave për 212 ankesa të qytetarëve (73% të numrit total të ankesave).



Harta 9 Zyra për mbrojtjen e konsumatorit



Grafiku 47: Numri i ankesave të qytetarëve për të cilat janë marrë masat përkatëse

Probleme dhe sfida

- Riskonstruksioni i tregjeve për të siguruar përputhshmëri me standartet higjeno-sanitare.
- Mbulim jo i plotë të tregjeve të kafshëve të gjalla me veterinerë dhe tregjet nuk janë të gjitha të licënuara.
- Krijimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare në bashki për ofrimin e shërbimeve të veterinarisë dhe shërbimeve ushqimore sipas standarteve dhe kërkesave të legjislacionit.
- Kapacitetet e monitorimit dhe kontrollit të bashkive në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinarisë janë të vogla për të eliminuar rasteve abuzive dhe ndërveprimi e koordinimi me drejtoritë rajonale të AKU dhe inspektoriatin shtetëror.

Rekomandime

- Të përfundojë riorganizimi i shërbimit veterinar për të rritur efikasitetin dhe për të siguruar një nivel të përshtatshëm të kapaciteteve administrative¹⁰⁷.
- Miratimi i një metodologjie të re të bazuar në rrezikun për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore; kontrollet zyrtare të kryhen sipas planeve vjetore të përditësuara të inspektimit mbështetur në një metodologji të përmirësuar të bazuar te rreziku për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore.
- Përfundimi i mgritjes së zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve i shoqëruar me trajnime për fuqizimin e kapaciteteve të nëpunësve të këtyre strukturave (fuqizimi i rolit monitorues/inspektues të shërbimeve bashkiake).
- Linçensimi i plotë i të gjitha tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë dhe të tregjeve të kafshëve të gjalla në përputhje me protokollet dhe standartet e kërkuara.
- Ndërrmarrja e fushatave ndërgjegjësuese për qytetarët për të paraqitur ankesat e tyre lidhur me sigurinë ushqimore.
- Adresimi i plotë i ankesave të qytetarëve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe bërja transparente e masave të mara në përgjigje të ankesave të qytetarëve.

Konkluzione mbi politikat e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare

Progres i ngadalshëm është bërë lidhur me zbatimin e masave për mbrojtjen e konsumatorëve, sigurinë ushqimore dhe veterinarë dhe rregjistrin e kafshëve. Në 2020 u kontraktuan 293 veterinerë zyrtarë¹⁰⁶ me fonde të qeverisë, ndërsa zyra për mbrojtjen e konsumatorëve në bashki është ngritur nga 27 bashki (44%) dhe numri i punonjësve ka qenë 187, në nivel vendor. Progres i lehtë është bërë me licënsimin e tregjeve të kafshëve të gjalla (shkalla mesatare 23% nga 19% që ishte në vitin 2019),

ndërsa licënsimi i tregjeve të shitjes me pakicë ka mbetur në të njëjtin nivel me vitin 2019 (rreth 40%).

Mbetet sfidë krijimi i zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të fuqizimi i kapaciteteve të nëpunësve të këtyre strukturave (fuqizimi i rolit monitorues/inspektues të shërbimeve bashkiake), si plotësimi i të gjitha standarteve për linçensimin e plotë të tregjeve të shitjes me pakicë dhe të tregjeve të kafshëve të gjalla.


106 Raporti vjetor për v.2020 (MBZHR, 2021)

107 Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (2020), kapitulli 12


Shkalla mesatare e përputhshmërisë të rrjetit rrugor rural (të fshatrave) me standartet ligjore të ndërtimit ka qenë 35% (n=54), që evidenton përmirësim kundrejt vitit 2019 (32.2%). Për 35 bashki (57% e bashkive), shkalla e përputhshmërisë është më e ulët se 50%. Tetë bashki nuk kanë ofruar asnjë të dhënë për treguesin: Bashkia Tiranë, Tepelenë, Pustec, Fushë-Arrëz, Shijak, Maliq dhe bashkia Kamëz).

Numri i fshatrave të lidhura me qendrën e Bashkisë nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues është në nivelin 77.2%, por 34 bashki (56% e bashkive) kanë rrjet rrugor që mundëson lidhjen e më shumë se 90% të fshatrave të bashkive. Treguesi ka përmirësim në krahasim me 2019 (73.2%), ndërsa lidhja e fshatrave të njëjësive administrative ndërmjet tyre vlerësohet me një shkallë mesatare prej 76.8% (+2 p.p)


Ka patur përmirësim të vendosjes së sinjalistikës sipas standarteve gjatë 2020. Shkalla mesatare e përputhshmërisë është vlerësuar 42.3% (n=55), që evidenton rritje me 6.2 p.p kundrejt 2019. Siç duket nga grafiku pjesa më e madhe e bashkive janë nën mesataren lidhur me plotësimin e standarteve të sinjalistikës.



Grafiku 49: Shkalla e përputhshmërisë të rrjetit rural me standartet, 2020



Grafiku 50: Ndryshimi i përputhshmërisë të rrjetit urban dhe rural me standartet kombëtare, 2018- 2020



Grafiku 51: Shkalla e plotësimit të sinjalistikës sipas standarteve, 2020

Përmirësimi i transportit publik vlerësohet nëpërmjet tre treguesve të performancës: Publikimi i planit/hartës të transportit të publikuar në stacionet e autobusëve. Në 2020, 19 bashki raportojnë që publikimi i hartës të transportit publik ka qenë i vlefshëm për qytetarët gjatë 2020.

Konstatohet që ka një mungesë kuptimi nga ana e bashkive lidhur me raportimin e këtij treguesi. Ndonëse në nivel të përgjithshëm, vetëm 19 bashki raportojnë për hartën e transportit publik të afishuar në stacionet e autobusëve (numri total është i

njëjtë 2020/2019), 6 bashki të reja raportojnë “Po” (kanë kryer afshimin e hartës) gjatë vitit 2020 (bashkitë Tropojë, Kurbin, Lushnjë, Korçë, Devoll dhe Kolonjë), ndërsa 6 bashki të tjera raportojnë “Jo” në 2020 edhe pse kanë raportuar “Po” gjatë vitit 2019 (bashkitë Tiranë, Cërrik, Mallakastër, Himarë, Këlcyrë dhe Dibër).


Publikimi i orareve të lëvizjes së autobusëve urban dhe inter-urban¹¹⁶ në stacione të autobusëve është kryer nga 26 bashki (43% e bashkive).

Objektivi specifik: nxitja e ecjes në këmbë dhe përdorimit të biçikletës


Shkalla mesatare e rrjetit urban të dedikuar për lëvizje me biçikleta ka qenë 4.59% të rrjetit total urban në 2020, ose +1.23 p.p. kundrejt 2019 (n=57). Vetëm tre bashki kanë një nivel mbi 29% të rrjetit urban: Bashkia Tiranë (29.4%), Bashkia Vlorë (50%) dhe Bashkia Fier 53%.

Sipas kodit rrugor, të gjitha rrugët në zonat urbane duhet të kenë trotuarë. Në 2020, raportohet se shkalla mesatare e trotuarëve në zonat urbane në përqindje të rrjetit rrugor të brendshëm të bashkisë ka qenë 61.12% ose +5.12 p.p kundrejt 2019. Vetëm bashkitë Tiranë, Libohovë, Shijak dhe Delvinë nuk kanë raportuar asnjë të dhënë lidhur me këtë tregues.

Në kuadër të politikave miqësore ndaj mjedisit dhe reduktimit të efekteve negative me impakt ndaj ndryshimeve të klimës, bashkitë kryejnë fushata ndërgjegjësimi me qytetarët e tyre për promovimin e ecjes në këmbë dhe lëvizjes me biçikleta. Nje iniciativë e tillë është edhe java/dita e levizshmërisë pa makina. Në 2020, janë organizuar 63 fushata ndërgjegjësimi (n=56), pra mesatarisht 1 fushatë për bashki, por në fakt rreth 50% të bashkive kanë organizuar disa fushata ndërgjegjësimi, nga të cilat bashkia Shkodër (7 fushata), bashkia Tiranë (6 fushata) dhe Bashkia Cërrik (5 fushata), ndërsa 20 bashki të tjera kanë organizuar 1 deri 2 fushata.



Grafiku 55: Shkalla e rrjetit urban të dedikuar për lëvizjen me biçikleta, 2020



Grafiku 56: Shkalla e rrjetit rrugor të zonave urbane të paisur me trotuarë

¹¹⁶ Tregues i ri, prandaj nuk mund të bëhet krahasim me vitin 2019

Kutia 9:

Sfida të bashkive për administrimin e rrugëve dhe transportin publik gjatë vitit 2020

Bashkia Berat, Mallakastër, Kurbin: Gjetja e burimeve alternative të financimit dhe bashkë-financimeve dhe shtimi i burimeve njerëzore administrative në sektorin e zhvillimit të projekteve.

Bashkia Delvinë, Berat, Mat, Përmet, Tropojë: Sfidë mbetet investimi për të realizuar standartin ligjor për rrjetin rrugor.

Bashkia Devoll: Realizimi 100% i standarteve të rrugëve rurale në territorin e bashkisë.

Bashkia Dimal, Patos: Shtrirja e rrjetit rrugor rural edhe në fshatrat më të largët të bashkisë .

Bashkia Dropull: Në disa zona rurale kërkohen investime të mëdha për ndërtimin e rrugëve dhe bashkia nuk ka kapacitete financiare të mjaftueshme.

Bashkia Gjirokastrë: Duhet të jepen investime për të përmirësuar infrastrukturën në zonën rurale.

Bashkia Kamës: Rritja e sigurisë rrugore.

Bashkia Kavajë, Prrenjas, Selenicë: Mbulimi 100% i rrjetit rrugor ekzistues rural në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit.

Bashki Kolonjë: Rritja e kapaciteteve financiare për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor rural.

Bashkia Korçë: Rritja e rrjetit rrugor ekzistues në territorin e bashkisë deri në 70%.


Bashkia Librazhd: Përmirësimi i standarteve ligjore të ndërtimit të rrugëve rurale në masen 50%.

Bashkia Mirditë: Vazhdimi i punës për të rehabilituar rrugët rurale, por pengesë në realizimin e objektivave ka qene pandemia dhe pasojat e termetit.

Bashkia Sarandë: Rritja e standarteve për vitin pasardhës.

Bashkia Roskovec: Sfidë është përfundimi i të gjithë rrjetit rrugor në territorin e Bashkisë në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit.

Bashkia Shkodër: Transferta nga qeveria e pamjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës.



Grafiku 57: Numri i fshatave ndërgjegjësuese për promovimin e ecjes në këmbë dhe levizjes me biçikleta

Problemet dhe sfidat

- Gjetja e burimeve alternative të financimit dhe bashkë-financimeve dhe mungesa e burimeve njerëzore administrative në sektorin e zhvillimit të projekteve.
- Realizimi i plotë i standarteve të rrugëve rurale në territorin e bashkisë.
- Shtirja e rrjetit rrugor rural edhe në fshatrat më të largët të bashkisë, për të mundësuar lëvizjen e lehtë të qytetarëve dhe aksesin në treg.
- Transfera nga qeveria e pamjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës.
- Shtimi i linjave të reja të transportit ndërurban.
- Mungesa e sistemeve të infrastrukturës që sigurojnë publikimin e hartës së linjave të transportit publik të bashkisë në stacionet e autobusëve, dhe orarit të mbërritjes së autobusëve në stacionet urbane e ndërurbane.
- Ndërtimi i terminaleve të autobusëve në secilën ashki dhe sistemi i parkimit për autobusët.
- Mungesa e sistemeve inteligjente dhe kompjuterizimi i stacioneve të autobusëve për të monitoruar cilësinë e shërbimit në drejtim të respektimit të afateve kohore të lëvizjeve.

Rekomandime

- Kërkohet zbatim i duhur nga autoritetet e bashkisë për kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe udhëzimeve të miratuara në vitin 2020 lidhur me kuadrin rregullator për dhënien e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërqytetase dhe ndërkombëtar rrugor.
- Zbatimi efektiv e Strategjisë për Sigurinë Rrugore dhe Strategjisë për Aplikimin e Sistemeve Inteligjente në Transportin Rrugor sipas planeve të veprimit respektivë.
- Parashikimi i financimit për ndërtimin/rehabilitimin, dhe mirëmbajtjen dhe plotësimin e sinjalistikës së rrugëve gjatë procesit të planifikimit të buxhetit afat-mesëm të bashkisë
- Rritja e financimit nga qeveria për rehabilitimin e rrugëve të rrjetit rural sipas standarteve të ndërtimit.
- Shtimi i burimeve njerëzore në strukturën e zhvillimit të projekteve/sectorit të urbanistikës dhe rrugëve në bashki për përgatitjen cilësore të projekt-propozimeve në kuadër të financimit nga qeveria dhe thirrjeve për aplikime në kuadër të programeve të financuar nga donatorë të ndryshëm në Shqipëri.
- Mbështetje financiare për ndërtimin e terminaleve të reja të mjeteve të transportit publike / stacione multimodale (ose përmirësimi i terminaleve ekzistuese), në përputhje me Planin e Zhvillimit të Territorit të bashkisë.
- Shtimi i linjave të reja të transportit public urban e ndërurban.
- Forcimi i monitorimit nga qytetarët dhe OSHC lidhur me respektimin e të drejtës së informimit dhe cilësisë së shërbimeve nëpërmjet monitorimit të publikimit të hartave të transportit publik dhe oraret për qëllim të informimit të qytetarëve, si një standart i kërkuar i shërbimit.
- Shtimi i rrjetit të korsive për lëvizjen me biçikleta dhe përmirësimi i fushatave të ndërgjegjësimit për lëvizjet e qytetarëve në këmbë dhe biçikleta, dhe mbi rregullat e lëvizjeve të tyre në rrugët urbane.

KONKLUZIONE MBI POLITIKËN E TRANSPORTIT

Progres i lehtë është bërë në 2020 në drejtim të sigurimit të përputhshmërisë të rrjetit rrugor urban dhe rural me standartet e ndërtimit të rrugëve të rrjetit të administruar nga bashkitë. Nivelet e përmushjes së standarteve të rrugëve të rrjetit urban (59%) dhe rural (35%) dhe sinjalistikës sipas standarteve (42.3%) janë ende në nivele të ulëta, edhe pse janë bërë përpjekje nga bashkitë që të investojnë në rrjetin rrugor e sigurinë në rrugë.

Lidhja e rrjetit rrugor rural që lidh fshatrat me qendrën e bashkisë dhe ndërmjet fshatrave (Njësi Administrative të ndryshme) kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2019. Më shumë vëmendje është kushtuar nga bashkitë për mirëmbajtjen e rrugëve, por më pak mundësi financimi vërehet për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve ka pësuar rënie kundrejt kundrejt 2019.

Ende nuk bëhen përpjekje për publikimin e hartës të transportit publik në stacionet e autobuzëve për të lehtësuar lëvizjen e qytetarëve dhe turistëve të huaj sidomos në qytetet e mëdha. Progres i lehtë është bërë në 2020 me rritjen e rrjetit urban të dedikuar për lëvizje më biçikleta, ndërkohë fushatat e ndërgjegjësimit për promovimin e ecjes në këmbë dhe lëvizjes me biçikleta mbeten në nivele minimale.

Sfida për bashkitë janë sigurimi i burimeve alternative të financimit dhe bashkë-financimeve për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor sipas standarteve, përmirësimi i sistemit të transportit publik, shtimi i linjave të reja, dhe ndërtimi i termialeve të mjeteve të transportit publik në përputhje me planet e zhvillimit vendor, si dhe fuqizimi i kapaciteteve njerëzore në sektorin e zhvillimit të projekteve, urbanistikës dhe transportit për hartimin e projekteve të reja për rrugët.

3.4 Kapitulli 15: Energjia

Politika energjetike e BE-së përfshin furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, energjinë dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

“Shqipëria është përgatitur mesatarisht në këtë fushë. Shqipëria ka bërë ca progres lidhur me përgatitjen e kuadrit rregullator për energjinë e rinovueshme. Synimi kryesor i planeve të veprimit të eficiencës së energjisë për 2017-2020 është kursimi kumulativ i 6.8% të energjisë së përdorur në Shqipëri deri në vitin 2020.¹¹⁷”


Në 2020, është miratuar Ligji nr. 61/2020 datë 14.5.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015”, për sektorin e energjisë elektrike. Disa produkte të zhvilluara në kuadër të programit që qeverisë për energjinë, të cilat ndërlihdhen edhe më rolin e qeverisjes vendore, gjatë 2020, kanë edhe “Studime për përmirësimin e sektorit energjistik, përmirësimin e eficiencës së energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme”, Studimi i plotë i fisibilitetit për vendosjen e Kullave të Karikimit për makinat elektrike në Republikën e Shqipërisë, dhe Projekti LED - Mënyra kryesore për të përmirësuar e eficiencën e energjisë në shkollat publike dhe përhapja e përdorimit të shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme.¹¹⁸

Objektivat specifike të zhvillimit në kuadër të agjendës së integritimit evropian, në nivel vendor, në fushën e energjisë janë (i) Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë, (ii) përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat, shërbimet publike dhe private dhe (iii) rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe politikat promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme.


Objekivi specifik: Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë.

Progres i pakët është bërë në drejtim të caktimit të menaxherit për eficiencën e energjisë, në bashki, si pjesë e politikës për energjinë dhe masë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Eficiencën e Energjisë, 2019-2030. Pesëmbëdhjetë (15) bashki kanë caktuar nëpunësin vendor në cilësinë e menaxherit të energjisë, nga 13 në vitin 2019. Midis 15 bashkive që raportojnë “Po” për treguesin, në 2020, janë katër bashki të reja si, Bashkia Korçë, Dibër, Klos dhe Gjirokastrë, ndërsa 3 bashki, të cilat kanë raportuar për plotësimin e kërkesës në 2019, raportojnë se nuk e kanë më menaxherin për eficiencën e energjisë (bashkia Vau i Dejës, Gramsh dhe Vlorë).

Në trajnimin e organizuar për çertifikimin e menaxherit të energjisë në 2020, kanë marrë pjesë 10 bashki.



Harta 10: Menaxheri për eficiencën e energjisë



Harta 11: Plan Veprimi për eficiencën e energjisë

117 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)
 118 Raporti vjetor për vitin 2020 (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 2021)

Plani i Veprimit vendor për eficiencën e energjisë, si kërkesë e PV kombëtar, është hartuar dhe miratuar nga 19 bashki ose 31% e bashkive, duke shënuar një rritje të lehtë kundrejt vitit 2019 (14 bashki ose 23% me PV të miratuar).

Rreth 31% e Bashkive kanë zbatuar 70 projekte sipas kërkesave të eficiencës së energjisë (n=46). Bashkitë Patos, Shkodër dhe Korçë kanë zbatuar 7 deri 13 projekte gjatë vitit 2020; rreth 69% e bashkive nuk kanë raportuar për këtë tregues.


Objektivi specifik: Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë: përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat dhe shërbimet publike.

Në zbatim të detyrimeve që bashkitë kanë në kryerjen e kontrolleve mbi zbatimin e masave dhe kërkesave, të përcaktuar në ligjin për eficiencën e energjisë (ligj nr.124/2015), në ndërtesat për shërbimet publike dhe private, si dhe ndërtimet për banesa, anë kryer 548 kontrolle nga shërbimet e bashkive në vitin 2020 (n=47), ose mesatarisht 12 kontrolle (më shumë kontrolle kundrejt vitit 2019 - 328 kontrolle më shumë se 2019), ku


janë janë konstatuar gjithsej 146 raste (n=57) ose mesatarisht 3 raste. Në vitin 2020, nuk është raportuar mbi organizimin e trajnimeve për eficiencën e energjisë dhe përmirësimin e zbatimit të kërkesave minimale në ndërtesat publike dhe të banimit.

Objektivi specifik: Rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe politikat promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme

Dhjetë (10) bashki kanë zbatuar 12 projekte, të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Të ardhura të realizuara nga shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë që ndodhen në territorin e bashkisë (hidrocentralet) kanë qenë 9.91% (n=43), por 12 bashki raportojnë të ardhura pozitive, si bashkitë Kolonjë, Pogradec, Kurbin, Prrenjas, Mirditë, Kukës, Pukë, Librazhd, Peqin, Gramsh, Finiq dhe Mat. Nuk raportohen patur politika fiskale specifike dhe lehtësuese të ndërmarra nga bashkia ndaj biznesit, të cilat të promovojnë përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë gjatë 2020.



Grafiku 58: Numri i kontrolleve mbi zbatimin e masave për eficiencën e energjisë të kryera nga bashkitë
Burim: Matrica e treguesve “Bashkitë në procesin e Integritimit Evropian”, 2020



Grafiku 59: Bashkitë që kanë zbatuar projekte në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë

Kutia 10: Sfida të bashkive për zbatimin e politikave për eficientë e energjisë gjatë vitit 2020

Bashkia Berat dhe Dropull: Ka nevojë për rritje kapacitetesh; bashkia ka kapacitete të ulëta financiare; kontrollet kryhen vetëm në godinat që i përkasin nën pronësi bashkisë.

Bashkia Kolonjë: Rritja e kapaciteteve financiare për rekrutimin e menaxherit të eficientës së energjisë në Bashki dhe hartimin e planit të veprimit.

Bashkia Mallakastër: Sfidë është gjetja e burimeve njerëzore sipas kriterëve që duhet të ketë menaxheri për eficientë e energjisë dhe trajnimi sipas standardeve për kryerjen e këtij funksioni.

Bashkia Përmet: Mungesa e personave të dedikuar për këtë pozicion.

Bashkia Klos: Mundësitë financiare të individëve që aplikojnë për ndërtime të reja, janë të limituara, për të mbuluar shpenzimet për specialistët auditues të energjisë dhe për realizimin me materiale që për të siguruar eficientë e energjisë; Mungesa e specialistëve në tregun e zbatimit të punimeve të ndërtimit për zonën tonë për realizimin e punimeve me materiale eficientë.

Bashkia Selenicë, Prrerjas, Shkodër, Tropojë: Hartimi i një plani vendor për eficientë e energjisë dhe emërimi i menaxherit për energjinë.

Bashkia Korçë dhe Mat: Të gjitha projektet në ndriçimin rrugor, rinovimin e ndërtesave bashkiake si dhe ato private do të projektohen duke zbatuar masat për eficientë e energjisë.

Problemet dhe sfidat

- Caktimi i menaxherit për eficientë e energjisë (miratimi i strukturës përkatëse), trajnimi dhe çertifikimi sipas kërkesave.
- Hartimi dhe miratimi i plan veprimit në nivel vendor për eficientë e energjisë.
- Parashikimi i fondeve në PBA për zbatimin e masave të planit të veprimit për eficientë e energjisë.
- Kapacitete njerëzore inspektuese të vogla në bashkitë për zbatimin e masave të kontrollit në ndërtesat për shërbimet publike dhe private dhe ndërtime për banesa sipas kërkesave të ligjit (Ligji Nr. 124/2015 “Për eficientë e Energjisë”, ndryshuar).
- Hartimi i projekteve të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.
- Mungesë kapacitetesh për të realizuar inspektime lidhur me zbatimin e masave të eficientës së energjisë në godinat publike dhe private.

Rekomandime

Disa rekomandime të dhëna në raportin e mëparshëm janë të vlefshme meqënëse pak progres është bërë në nivel vendor, si:

- Caktimi i menaxherit për eficientë e energjisë në të gjitha bashkitë, trajnimi dhe çertifikimi i tij.
- Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit vendor, në kuadër të Planit Kombëtar për eficientë e energjisë dhe parashikimi i tij në PBA.
- Organizimi nga bashkitë i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese për qytetarët në lidhje me përdorimin eficient të energjisë, dhe sigurimin e bashkë-financimit nga bashkitë për projekte që sjellin përdorimin eficient të energjisë në banesat me pronësi të përbashkët.
- Rritja e kapacitetit kontrollues dhe inspektimit të shërbimeve bashkiake në zbatimin e masave të kontrollit dhe kërkesave në ndërtesat për shërbimet publike dhe private dhe ndërtimet për banesa.

PËRFUNDIME MBI ENERGJINË

Progres shumë i ngadaltë është bërë nga bashkitë në zbatimin e politikës së qeverisë në fushën e energjisë. Emerimi i menaxherit për eficiencën e energjisë është caktuar vetëm në 25% të bashkive rejt vitit 2019), ndërsa plani i veprimit vendor për eficiencën e energjisë, është miratuar vetëm nga 19 bashki. Numri i projekteve të realizuara sipas kërkesave të eficiencës së energjisë dhe të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë mbetet në nivele modeste në shkallë vendi.

Vëreht tendencë pozitive në drejtim të kontrolleve të kryer nga bashkitë lidhur me respektimin e kërkesave të eficiencës së energjisë. Sfida të bashkive mbeten krijimi i strukturave në bashki dhe caktimi i menaxherit për eficiencën e energjisë, trajnimi dhe çertifikimi i tij, hartimi i planit të veprimit vendor për eficiencën e energjisë, fuqizimi i kapaciteteve njerëzore inspektuese për zbatimin e masave të kontrollit në ndërtesat e banimit dhe ndërtesat për shërbimet publike dhe private dhe rritja e kapaciteteve për hartimin e projekteve të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

3.5 Kapitulli 16: Taksat

Rregullat e BE-së mbi taksimin mbulojnë taksën mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës, si dhe aspektet e taksimit të korporatave, si dhe me bashkëpunim midis administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për të parandaluar evazionin fiskal.

“Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e taksave. Përparim është arritur nëpërmjet kuadrit përfshirës të OECD në erozionin e bazës dhe zhvendosjen e fitimit dhe krijimit të një zyre qendrore ndërlidhëse për shkëmbimin automatik të informacionit financiar. Në vitet e ardhshme, Shqipëria duhet të thjeshtëzojë systemin e taksave për të përmirësuar përputhshmërinë dhe të adresojë në mënyrë sistematike vonesat në rimbursimin e TVSH¹¹⁹.”

Pavarësisht nga pasojat e tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë COVID-19, Shqipëria ka bërë përparim të mirë në shumicën e shtatë objektivave të Strategjisë të Menaxhimit Financiar Publik¹²⁰. Mëgjithatë reforma e taksimit të pronës – objektivi i synuar për 2020 për vendosjen e taksës mbi pronën, bazuar në vlerën fiskale të zonës në ndërtesa, dhe operacionalizimi i mbledhjes së taksave nuk u arrit. Ligji I rishikuar për taksën e pronës nuk u miratua në 2020. Asistencë është dhënë për sistemin teknologjisë së informacionit për taksat në nivel vendor dhe trajnimin e stafit të bashkive.

Të ardhurat e pushtetit vendor kanë patur luhatje në realizimin e tyre gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë Covid-19, duke krijuar në shumë raste disbalanca të cilat janë mbuluar nga përdorimi i burimeve të tjera si transferata nga buxheti qendror, psh në gjashtëmujorin e parë, pushteti vendor mblodhi vetëm 32% të totalit të të ardhurave vendore (prej 21.9 miliard lekë), ndërsa gjatë pjesës së dytë u realizuan rreth 14.9 miliard lekë.

Reforma administrativo-territoriale dha një efekt të konsiderueshëm në potencialin fiskal të pushtetit vendor, duke rritur jo vetëm kapacitetet për mbledhjen e të ardhurave të veta vendore por gjithashtu edhe në rritjen e shpenzimeve për shërbimet vendore. Të ardhurat nga taksat vendore kanë patur një trend rritës krahasuar me çdo vit paraardhës, përkatësisht 23% në vitin 2017, 19% në vitin 2018, 6% në vitin 2019 dhe 1% në vitin 2020.


Në raport me të ardhurat publike, të ardhurat vendore janë rritur nga 5.02% në vitin 2019 në 5.16% në vitin 2020. Krahasuar me vitin 2015, ku raporti i të ardhurave vendore me të ardhurat publike ishte rreth 3.09%, rritja e rolit dhe fuqisë fiskale të pushtetit vendor në vitin 2020 u shoqërua me rritje të këtij raporti me rreth 2.07%. Nga ana tjetër, pushteti vendor ka rritur rolin e tij në vite përmes kontributit në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto duke ndryshuar raportin nga 0.82% e PBB në vitin 2015 në 1.51% në vitin 2020, me një rritje prej 0.58% e PBB-së¹³⁹.

Për shkak të situatës së pandemisë, në vitin 2020 janë kryer 21,897 kontrolle, të ndërmarra nga bashkia me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale në territorin e tyre (mesatarisht 391 kontrolle, n=56). Numri i kontrolleve në vitin 2020 ka qenë mjaft më i vogël nga viti 2019 (raportuar 48,068 kontrolle).

Trend rritës ka patur puna e bashkisë në vitin 2020 në drejtim të organizimit të dëgjësive publike dhe konsultimit me grupet e biznesit, gjithsej janë organizuar 342 dëgjesa ose mesatarisht 6 dëgjesa (n=57), kundrejt 258 dëgjësive të organizuara nga bashkitë në vitin 2019.

119 Raport Progresi KE për Shqipërinë (2020)

120 Objektivi 1: Kuadri fiskal i qëndrueshëm dhe i kujdesshëm, objektivi 2: Planifikimi i buxhetit eficient dhe mirë integruar, objektivi 3: Mobilizimi i të ardhurave, objektivi 4: Ekzekutim eficient të buxhetit, objektivi 5: transparencë e financave publike, Objektivi 6: kontroll i brendshëm efektiv, objektivi 7: kontroll i jashtëm efektiv




Grafiku 60: Realizimi të ardhurave në nivelin vendor
Burim: MFE (Raporti vjetor i financave publike vendore (2020))




Grafiku 61 Ndryshimi i të ardhurave tatimore dhe jotatimore 2020/2019

Objektivi Specific: Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme.


Në vitin 2020, 49 bashki (ose 80.33%) kanë miratuar programe të politikave tatimore, duke mbetur në nivel të njëjtit me vitin 2019.




Harta 12



Harta 13: Bazë të dhënash mbi debitorët e NJQV



Grafiku 62: Numri i dëgjësive publike të organizuara nga bashkia me bizneset



Grafiku 63: Rritja e të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, në 2020

Vetëm 45 bashki kanë raportuar mbi ndërtimin dhe operacionalizimin e bazës së të dhënave për debitorët (74% e bashkive) për vitin 2020 (ose 5 bashki më pak kundrejt vitit 2019). Bashki të reja që raportojnë për plotësimin e objektivit në 2020 janë bashkitë Elbasan, Bashkia Kamëz dhe Bashkia Korçë, ndërsa bashki të cilat kanë raportuar se e kanë ndërtuar bazën e të dhënave në 2019, por e raportojnë negativisht këtë tregues në 2020, janë bashkitë Vorë, Kavajë, Peqin, Lushnjë, Cërrik,

Roskovec, Memaliaj, Prrerjas dhe bashkia Pogradec. Kjo mungesë konsistencë në raportimin e treguesit tregon mungesë vëmendje dhe serioziteti në raportim nga ana e këtyre bashkive. Mesatarisht, të ardhurat tatimore vendore janë rritur me 20.58% në vitin 2020 kundrejt vitit 2019 (n=55), pra rritja ka qenë më e vogël kundrejt vitit 2019 (vlera mesatare e rritjes me 25,4% për vitin 2019/2018). Kjo situatë është e kuptueshme nëse kemi parasysh impaktin e krijuar nga situata e Covid -2019.

Kutia 11: Probleme dhe sfida të bashkive në zbatimin e politikave tatimore dhe administrimin e të ardhurave tatimore

Bashkia Berat, Dropull: bashkëpunimi me drejtorinë rajonale si dhe drejtorinë brenda bashkisë për formalizimin e biznesit.

Bashkia Cërrik: Rritje e ndergjegjësisë për formalizim vullnetar të biznesit.

Bashkia Devoll: Sfidat kryesore për vitet në vazhdim janë ulja e informalitetit dhe ndergjegjësimi i bizneseve, si dhe nevojitet një bashkëveprim me Drejtorinë Rajonale Tatimore në lidhje me liçensimin e bizneseve sepse gjatë 2020 ka munguar plotësisht.

Bashkia Dibër: Hartimi i një strategjie në pajtueshmëri të përputhje me kërkesat e ligjit për financat vendore, ligjet për taksat vendore dhe udhëzimet përkatëse.

Bashkia Dimal: Konsolidimi i procedurave për nxitjen e formalizimit të bizneseve.

Bashkia Elbasan: Rritja e kapaciteteve profesionale të Sektorit të Terrenit në drejtorinë e tatimeve vendore, informimi i biznesit nëpërmjet fletëpalosjeve apo ëeb-it të Bashkisë Elbasan.

Bashkia Kolonjë: Bashkëpunim me organet e tatimeve qëndrore, taksë forcën dhe hetimin tatimor.

Bashkia Kamëz: Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore.

Bashkia Lezhë: termeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia COVID 19 kanë sjellë probleme në të ardhurat e bashkisë por megjithatë bashkia ka ndërmarrë politika tatimore me qëllim nxitjen e ekonomisë.

Bashkia Mat: Vazhdimi i metejshëm i uljes së barrës fiskale dhe fiskalizimi i gjerë.

Bashkia Mallakastër: Sfidë është ngritja e një sistemi eficient për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe rritja e bashkëpunimit midis pushtetit vendor dhe qendror për të parandaluar ekonominë joformale.

Bashkia Mirditë: Në vazhdim kemi përparësi evidentimin në të gjithë territorin, të bizneseve të paligjshme.

Bashkia Selenicë: Përmirësimi i politikave dhe mbështetja e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Bashkia Shkodër: Procesi i implementimit të politikave tatimore është sfidë për shkak të shtrirjes territoriale. Bashkia synon që të rishikojë për çdo periudhë, bazën e taksueshme në mënyrë që të shfrytëzojë maksimalisht potencialet.

Bashkia Skrapar: Rritja e të ardhurave nga tarifat me qëllim mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e kryera nga bashkia si pastrim ndriçim dhe gjelbërim, dhe shërbime të tjera publike nëpërmjet rritjes së bazës së tatueshme dhe rritjen e subjekteve taksapaguse dhe uljen e debitorëve.

Bashkia Tiranë: Krijimi i një sistemi të ri taksash e tarifash të mbështetura mbi ndërtesën dhe krijimi i një sistemi online të komunikimit dhe kontrollit nga ana e inspektorëve të terrenit, implementimi i ploti i taksës së ndërtesës në përputhje me ndryshimet ligjore të vitit 2018 dhe VKM nr.132 datë 7.3.2018, i ndryshuar.

Problemet dhe sfidat

- Sfidë është ngritja e një sistemi eficient për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe rritja e bashkëpunimit midis pushtetit vendor dhe qendror për të parandaluar ekonominë joformale.
- Krijimi i një sistemi të ri taksash e tarifash të mbështetura mbi ndërtesën dhe krijimi i një sistemi online të komunikimit dhe kontrollit nga ana e inspektoreve të terrenit;
- Implementimi i plotë i taksës së ndërtesës në përputhje me ndryshimet ligjore të vitit 2018 dhe VKM nr.132 datë 7.3.2018, i ndryshuar.
- Procesi i implementimit të politikave tatimore është sfidë për shkak të shtrirjes territoriale në disa bashki, c'ka sjell edhe problem në aftësinë inspektuese të strukturës vendore për të mbuluar territorin e zgjeruar të bashkive mbas Reformes Administrative dhe Territoriale.
- Hartimi i politikave tatimore në nivel vendor me qëllim nxitjen e ekonomisë, uljen e debitorëve dhe informalitetit.

Rekomandime

- Forcimi i kapaciteteve inspektuese në terren nga administrata tatimore vendore dhe sigurimi i bashkëpunimit efektiv me drejtoritë rajonale të tatimeve.
- Thjeshtëzimi i sistemit të tatimeve duke inkurajuar rritjen e pajtueshmërisë së tatimeve. Institucionet duhet të trajtojnë në mënyrë sistematike shfaqjen e vonesave për rimbursimet e TVSH dhe të shmangë prapambetjet e mëdha.
- Zbatimi i plotë i fiskalizimit dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për formalizimin e bizneseve.
- NJQV të rritin të ardhurat në mënyrë miqësore dhe të forcohet qeverisja fiskale.
- Të zgjidhen pengesat ligjore për zgjidhjen e huave me probleme, ekzekutimin e kolateralit dhe procedurat e paaftësisë paguese¹²¹.
- Bashkitë duhet të përmirësojnë transparencën mbi performancën në ofrimin e shërbimeve publike dhe ekzekutimin e buxhetit të tyre për qytetarët e tyre, kundrejt rritjes së pajtueshmërisë me sistemin e tatimeve dhe rritjen potenciale të tarifave vendore përkundrejt përmirësimit në ofrimin e shërbimeve publike.

PËRFUNDIME PËR TAKSAT

Pushteti vendor ka realizuar të ardhura të veta tatimore dhe jotatimore rreth 24.2 miliard lekë ose ndryshe rreth 1.4 miliard lekë më pak se realizimi i të ardhurave gjatë vitit 2019, por kanë qenë me trend rritës me çdo vit paraardhës. Në raport me të ardhurat publike, të ardhurat vendore janë rritur nga 5.02% në vitin 2019 në 5.16% në vitin 2020.

Në vitin 2020, 49 bashkitë kanë miratuar programe të politikave tatimore, duke mbetur në nivel të njëjtë me vitin 2019. Për shkak të situatës së COVID-19, më pak kontrolle dhe inspektime janë kryer nga strukturat vendore në bizneset kundrejt vitit 2019. Mbetet ende shqetësim përfundimi i ngritjes së dhe funksionalizimi i databesës së të dhënave për debitorët. Mbeten sfida për bashkitë, rritja e aftësisë inspektuese të strukturës vendore për të mbuluar territorin e zgjeruar të bashkive mbas Reformes Administrative dhe Territoriale, hartimi i politikave tatimore në nivel vendor dhe sigurimi i bashkëpunimit efektiv me drejtoritë rajonale të tatimeve.

3.6 Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi

“Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje lidhur me politikën sociale dhe punësimin. Është bërë disa përpjekje për zbatimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm, veçanërisht për rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës. Shqipëria ka vazhduar ristrukturimin e sistemit të saj të qeverisjes së punësimit, në përputhje me ligjet për arsimin dhe formimin profesional dhe promovimin e punësimit. Niveli i punësimit dhe pjesëmarrja në tregun e punës mbetet e ulët, dhe ekonomia informale është ende një ofrues i rëndësishëm i punës. Reforma e shërbimeve sociale po përparon, por përpjekjet financiare dhe administrative duhet të rriten për të forcur nivelin lokal.¹²²”

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019-2022 identifikon qëllimet dhe objektivat për Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndhimës Ekonomike, lidhjen me skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre. Për politikën e punësimit, Shqipëria po zbaton Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS) 2020-2022. Si përgjigje ndaj krizës COVID-19, gjatë muajit mars 2020, Qeveria ndërmori disa masa urgjente për t’iu përgjigjur dhe mbrojtur grupet më të rrezikuara.

Gjatë vitit 2020 janë diskutuar disa projektatke në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore sic janë:

Projektvendimi për “Rastet dhe mënyra e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit qendror dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore për krijimin ose shtimin e fondit publik të banesave sociale” është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 873, dt:11.11.2020.

Projektvendimin “Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillimi Kombëtar të Strehimit, si dhe Marrëdhëniet me Institucionet e tjera shtetërore që veprojnë në këtë fushë”.

Projektvendimi “Mbi kriteret për përzgjedhjen, mënyrën e kontraktimit, formën dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin”.

Projektvendimin “Për përcaktimin e masës, kriterëve, proce-

durave dhe dokumentacionit, për personat me aftësi të kufizuara si dhe ndihmësit personal të tyre” miratuar me VKM nr. 182, dt:26.02.2020.

Projektvendimi “Mbi kriteret për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimin, mënyra e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, forma e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, për strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre”.

Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit mbi Deinstitutionalizimit 2020-2022 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e tij”. Miratuar me VKM nr. 706, dt:09.09.2020.

Progresi në zbatimin e politikave në fushën sociale dhe punësimin në nivel vendor lidhet me tre objektiva specifike dhe vlerësimin e 23 treguesve të performancës.

Objektivi specifik: Mbrojtja sociale në nivel vendor

Shërbimet e kujdesit social përbëjnë vetëm 0.35% të buxhetit të qeverisë në vitin 2020. Transferrat cash vazhdojnë të përbëjnë rreth 95% të buxhetit të përgjithshëm të sektorit të mbrojtjes sociale. Vlerësimi i nevojave për shërbime sociale i kryer për vitin 2020 nga Shërbimi Social Shtetëror në 12 qarqet e Shqipërisë thekson se 28% e bashkive nuk ofrojnë asnjë shërbim të kujdesit social¹²³.

Progresi i objektivit specifik mbrojtja sociale në nivel vendor vlerësohet me treguesit e mëposhtëm:


Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki për vitin 2020¹²⁴ në total është 280 (N=58) respektivisht për kategoritë: Njësia për mbrojtjen e fëmijëve 128 nëpunës ose mesatarisht 2,21 për bashki; 80 nëpunës për barazinë gjinore ose mesatarisht 1,38 për bashki dhe 72 nëpunës për dhunën në familje ose mesatarisht 1,24 nëpunës për bashki.

Kapacitetet njerëzore në bashki me nëpunës shtesë për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike (NE) kanë pësuar rritje ku në total janë raportuar 248 (N=58) ose mesatarisht 4,28 punonjës në bashki. Treguesi ka përmirësim me gati 50 % nga mesataja 2,18 për bashki që ishte në vitin 2019. Shtesat në punonjës kanë ndodhur në 38 bashki. Sic shihet dhe nga grafiku i mëposhtëm janë rritur kapacitetet e bashkive me nëpunës shtesë për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike (NE) në Bashki ka pësuar rritje gjatë vitete të fundit ku në 2020 janë 3.1 herë më shumë

122 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)

123 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

124 Këta tregues janë futur për herë të parë në 2020 ndaj nuk mund të bëhet krahasimi me vitet e tjera




Grafiku 64: Numri i nëpunësve shtesë për ndihmën ekonomike në vite 2017-2020

punonjës krahasuar me vitin 2017.


Zhvillimi i aftësive profesionale të stafit për sektorin e përkrahjes dhe mbrojtjes sociale ka vijuar përmes trajnimeve në lidhje me politikat kombëtare, masat për mbrojtjen sociale dhe statistikat sociale sipas standarteve të BE. Në vitin 2020 janë trajnuar në total 239 nëpunës vendorë (N=58) ose mesatarisht 4.12 punonjës për bashki. Numrin më të madh të personave të trajnuar gjatë vitit 2020 e ka Tirana me 35 e pasuar nga Kruja me 22 dhe Shkodra me 21.

Megjithë përpjekjet për të rritur numrin e nëpunësve të trajnuar në vite mbi politikat dhe masat e mbrojtjes sociale, numri i tyre ka qënë në nivele të njëjta për vitet 2018 dhe 2020, nivel më i ulët se ai i vitit 2017.

57% e bashkive kanë ofruar kontributin e tyre për hartimin e Raportit të Vlerësimit për mbrojtjen sociale në vitin 2020. Treguesi shënon një rritje prej 13 p.p. krahasuar me vitin 2019.




Grafiku 65: Nëpunës të administratës të trajnuar për politikat kombëtare të mbrotjes sociale, 2020



Grafiku 66: Nëpunës vendor të trajnuar mbi masat për mbrojtjen sociale 2017-2020

Sektori i vlerësimit të nevojave dhe referimit është bërë funksional në 50% të Bashkive në vitin 2020 duke pësuar një rritje prej 11 p.p. krahasuar me 2019 dhe 17 p.p. krahasuar me 2018. Në vitin 2020, buxheti i bashkive i planifikuar për shpenzime të kujdesit social përbën 10,26% të buxhetit total të tyre. Numri i personave nga grupet vulnerabel që përfitojnë shërbime sociale në qendrat e themeluara të kujdesit social në 2020 janë raportuar në total 11,092 ose mesatarisht 191 persona/bashki. Numrin më të madh e raporton Bashkia Shkodër me 6600 persona pasuar nga Bashkia Tiranë me 1487.



Grafiku 67: Plan Veprimi për Përfshirjen Sociale i miratuar nga Bashkitë në 2017-2020


Objektivi specifik: përfshirja sociale në nivel vendor

Progres i mirë është bërë në drejtim të hartimit të planit vendor për përfshirjen sociale. 90% e Bashkive kanë hartuar dhe kanë miratuar atë me vendim të Këshillit Bashkiak; treguesi evidenton rritje +26 p.p., krahasuar me vitin 2019. Bashkitë që nuk e kanë miratuar ende janë: Belsh, Pustec, Kolonjë, Këlcyrë dhe Memaliaj. Bashkia Shijak nuk ka raportuar asnjë të dhënë.

Gjatë 2020 janë zhvilluar 183 trajnime (N=57) për nëpunës vendor mbi metodologjitë e matjes së treguesve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale ose mesatarisht 3.21 tranime për bashki.



Harta 14 Plan Veprimi për Përfshirjen Sociale përfshirjen Sociale




Harta 15 Bazë të dhënash për përfshirjen sociale

Ky tregues ka një përmirësim të ndjeshëm me një rritje prej 48% krahasuar me vitin 2019 (88 trajnime), me 2018 (66 trajnime) dhe 2017 (79 trajnime). Numrin më të madh të trajnimeve e raporton Bashkia Kukës me 32 trajnime, Bashkia Devoll me 20 trajnime dhe Bashkia Krujë 18 trajnime¹²⁵.

Baza statistikore për përfshirjen sociale është ngritur dhe bërë funksionale në 56 % të Bashkive treguesi evidenton përmirësim me +3.27 p.p., në krahasim me vitin 2019. Gjithsej, 3733 nxënës (N=57) kanë ndjekur arsimin profesional të cilët kanë përfituar bursa për vitin shkollor ose mesatarisht 65.45 nxënës për bashki.

Numri i të papunëve që marrin ndihmë ekonomike të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional në përputhje me nevojat e tregut në nivel vendi janë raportuar gjithsej 10,859 persona, ose mesatarisht 217 persona për bashki (N=50). Numrin më të madh e ka Bashkia Dibër me 5248 persona dhe bashkia Kavajë me 1612 persona.

Sic shihet dhe nga grafiku i mësipërm numri i personave të papunë punëkërkuar ka ardhur duke u ulur nga mbulimi me skemën e Ndihmës Ekonomike. Ky tregues tregon përmirësim të situatës në lidhje me punësimin e personave të cilat janë orientuar drejt tregut të punës përmes formimit profesional duke sjellë uljen e tyre me gati 41% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2018.



Grafiku 68: Të papunë të mbuluar nga skema Ndihmës Ekonomike në bashki 2017-2020

*Në 2017 kanë raportuar vetëm 8 bashki ndaj shifra nuk është e plotë

Problemet dhe sfidat

- Kapacitetet njerëzore dhe financiare të sektorit të vleresimit të nevojave dhe referimit edhe pse të rritura ende janë të pamjaftueshme.
- Bashkëpunim i ulët mes Organizatave të Shoqërisë Civile me pushtetin qendror për ofrimin e trajnimeve të specializuara të punonjësve për politikat sociale dhe temat e lidhura me të.
- Bashkëpunim i pamjaftueshëm i NJQV me aktorët e interesit për përcaktimin e politikave në arsim dhe trajnim profesional për personat me aftësi ndryshe.
- Burime të kufizuara njerëzore, teknike dhe financiare për krijimin e bazës së të dhënave statistikore sipas treguesve të BE-së për përfshirjen sociale nga të gjitha bashkitë në vend.
- Shërbimet lokale të kujdesit social janë të pazhvilluara dhe mungojnë investimet dhe burimet adekuate njerëzore në shumë bashki.
- Kapaciteti i bashkive për të vlerësuar nevojat, për të aplikuar për fondet e qeverisë dhe për të menaxhuar shërbimet sociale mbetet i dobët.
- Shpenzimet publike për programet e shërbimeve të kujdesit social janë ende të ulëta dhe nuk ka mekanizma për monitorimin e situatës së personave vulnerabël.

Rekomandime

- Trajnim i vazhdueshëm për të rritur cilësinë e administrimit të sektorit dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara tek qytetarët.
- Miratimi i planeve sociale vendore nga të gjitha bashkitë dhe harmonizimin e tyre me programin buxhetor afatmesëm.
- Rritja e investimeve dhe zhvillimi i shërbimeve të reja të kujdesit social dhe mbulim më i gjerë gjeografik. Njësitë e qeverisjes Vendore duhet të vlerësojnë nevojat në territorin e tyre dhe të përgatisin planet vendore të kujdesit social.
- Krijimi i një baze të dhënash për indikatorë të ndryshëm në lidhje me shërbimet sociale për grupe të ndryshme vulnerabël.
- Menaxhimi me efikasitet i të dhënave vendore dhe monitorimi i zbatimit përfshirë edhe raportimin periodik për të siguruar që gjetjet janë përfshirë në hartimin e politikave kombëtare.
- Krijimi i qendrave komunitare për të gjitha grupet vulnerabël në secilën bashki me qëllimin e marrjes së shërbimeve.

Objektivi specifik:

Mbështetje për programet aktive të punës


Një nga objektivat e Strategjisë për Mbrojtjen Sociale 2015-2022 është Transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë integrimi përmes krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të Programit të daljes nga skema e NE. Transformimi i skemës së NE do të arrihet përmes: i) zhvillimit të politikave për Programin e Integruar Social; ii) nxitja dhe promovimi i ndërmarrjeve sociale dhe iii) vlerësimin të impaktit të mbështetjes së familjeve përmes skemës së NE.

Për integrimin e personave me aftësi ndryshe (PAK), në vitin 2020 janë mbështetur gjithsej 230 individë (N=55) nëpërmjet frekuentimit të programeve për aftësim profesional. Ky tregues rezulton të jetë më i vogël krahasuar me 2019, gjatë të cilit janë mbështetur 262 individë.


Në total 176 të rinj që kanë përfunduar arsimin universitar dhe programin e formimit profesional janë mbështetur nga shërbimet e bashkisë dhe aktorë të tjerë për hapjen e një biznesi në fushat e tyre respektive, në 2020 ose mesatarisht 3.26 individë për bashki. Ky tregues është pothuajse i njëjtë me vitin 2019 gjatë të cilit përfituan 179 të rinj.

Në 2020 janë raportuar 1477 të rinj që kanë përfituar nga iniciativat e zbatuara në bashkëpunim me Zyrën e Punës mbi përmirësimin apo zgjerimin e mundësive për arsim dhe aftësim profesional, mesatarisht 31.43 të rinj (N=47). Në vitin 2019 janë raportuar vetëm 59 të rinj që kanë përfituar.

Memorandumi i bashkëpunimit midis Bashkisë dhe Zyrës e Punës është një instrument i rëndësishëm për të rritur bashkëpunimin e institucioneve vendore për punësimin e të rinjve si edhe për riintegrimin socio-ekonomik të personave të trajtuar me Ndhmë Ekonomike. Deri në vitin 2020 kanë firmosur Memorandumin e Bashkëpunimit 41 Bashki ose 67 % e Bashkive të vendit.



Grafiku 69: Numri i PAK të mbështetur nga Bashkia për arsim profesional kundrejt numrit total, 2020



Grafiku 70: Numri i të rinjve që kanë përfituar nga iniciativat e bashkëpunimit me Zyrën e Punës, 2020

Problemet dhe sfidat

- Mbetet sfida rritja e burimeve financiare dhe njerëzore për analizën në terren dhe për nxitjen e punësimit, si dhe bashkërendimi më i mirë i veprimeve ndërmjet bashkive, ministrive të linjës, agjencive rajonale dhe zyrave shtetërore në nivel vendor;
- Forcimi i qendrave të formimit profesional dhe paisja e tyre me baze materiale bashkëkohore; krijimi i disa qendrave të reja të formimit profesional është specifikuar si nevojë nga disa bashki.
- Mungesa e fondeve dhe kapaciteteve profesionale në bashki për personat që trajtohen nga skema e NE me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës.
- Mungesë koordinimi ndër-institucional për të nxitur punësimin dhe në mënyrë të veçantë për shtresat në nevojë.
- Mungesë informimi dhe edukimi i të rinjve për mundësitë e integrimin të tyre në tregun e punës dhe bashkëpunimi jo i mirë me OSHK që veprojnë në këtë fushë.

Rekomandime

- Pushteti qendror dhe ai vendor duhet të sigurojnë nxitjen e mundësive aktuale të punësimit përmes politikave të efektshme të tregut të punës.
- Rritja e kapaciteteve dhe përcaktimi i programeve të kualifikimit në institucionet e arsimit profesional sipas nevojave të tregut vendor të punës.
- Ndërtimi dhe forcimi i bashkëpunimit me bizneset që të krijojnë mundësi punësimi si dhe të ndihmojnë kryesisht shtresat dhe kategoritë e grupeve në nevojë.
- Nxitja e ndërmarrjeve sociale si një mekanizëm që siguron mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël përmes ofrimit të mundësive për punësim dhe integrimin ekonomik dhe shoqëror.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e arsimit, formimit profesional, punësimit si dhe me shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, integruese, rehabilituese, për të krijuar një rrjet mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara.
- Bashkëpunimi me organizatat që ofrojnë shërbime psiko-sociale, shkëmbimin e informacionit lidhur me vlerësimin, si edhe marrjen e informacionit nga këto ofrues shërbimesh për përfituesit.

PËRFUNDIME MBI POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMIN

Politikat sociale dhe të punësimit kanë vijuar të jenë ndër prioritetet kresore të bashkive në zbatim të reformave strukturore dhe masave për reduktimin e varfërisë dhe nxitjen e punësimit. Viti 2020 solli sfida të paparashikuara, të cilat kërkuan që sistemi i mbrojtjes sociale të reagojë menjëherë. Me shpalljen e situatës të emergjencës dhe zbatimin e masave kufizuese, qeveria qendrore dhe vendore mori disa masa në ndihme të familjeve të varfra dhe në nevojë.

Progres është shënuar në ndërmarrjen e reformave për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale. Përmirësime janë bërë duke filluar nga reformimi rrënjësor i programit të ndihmës ekonomike dhe paafësisë, sistemi i shërbimeve të integruara të përkujdesit socialë, si dhe plotësimin e programeve të ndihmës ekonomike me programe aftësimi e integrimi social. 90% e Bashkive kanë tashmë planin vendor për përfshirjen sociale. Kapacitetet njerëzore në bashki me nëpunës shtesë për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike (NE) kanë pësuar rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2019.

Rregjistri Elektronik Kombëtar për aplikantët e NE, i lidhur dhe me sisteme të tjera informacioni, si ai i tatimeve/taksa, zyrat e punës, ka lehtësuar procedurat për aplikim të personave për pjesëmarrje në skemën e ndihmës ekonomike dhe thjeshtëzimin e dokumentacionit. Tashmë, verifikimi i të dhënave me institucionet e tjera bëhet në kohë reale nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit, i cili lehtëson punën e agjencive të ndryshme shtetërore dhe në nivel vendor. Ky sistem ka mundësuar rritjen e saktësisë së të dhënave dhe shkëmbimin në kohë reale të informacionit lidhur me përcaktimin e statusit real të varfërisë së familjeve aplikuese. Raportimi periodik i bazuar në të dhënat e regjistrimit elektronik mbetet një drejtim me mangësi të mëdha në nivel lokal.

Progres është shënuar në drejtim të rritjes së numrit të personave që dalin nga skema ekonomike dhe ri-integrimin në tregun e punës përmes formimit profesional apo bashkëpunimit me zyrat e punës duke sjellë uljen e tyre me gati 41% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2018.

3.7 Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë


“Politikat rajonale janë instrumenti kryesor i BE-së për investime në rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Shtetet anëtare janë përgjegjëse për zbatimin e tyre, gjë e cila kërkon kapacitete të përshtatshme administrative dhe menaxhim të shëndoshë financiar për projektimin dhe ekzekutimin e projektit. Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturorë¹²⁶”.

Në vitin 2020 është miratuar LIGJi Nr. 102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal Dhe Kohezionin”. Qëllimi i ligjit është: (i) të përcaktojë, instrumentet e posaçme dhe kuadrin institucional e financiar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin në Republikën e Shqipërisë; (ii) të përcaktojë kuadrin strategjik dhe institucional të hartimit të politikave afatgjata zhvillimore rajonale në zbatim të politikave kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal; (iii) të sigurojë që autoritetet politikëbërëse të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të rajoneve; (iv) të sigurojë harmonizimin e strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët zhvillimore rajonale, duke e mbështetur atë edhe me buxhetin përkatës.

Objektivi specifik: forcimi i bashkëpunimit në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë (të sigurohet kohezioni ekonomik dhe social ndërmjet rajoneve).

Në 2020 janë ndërmarre në total 134 iniciativa me interes të përbashkët me bashkitë e tjera ose mesatarisht 2.44 iniciativa për bashki (N=55), duke ngelur pak a shume në të njëjtat nivele më vitin 2019 (139 iniciativa), por duhet theksuar se 34.4% e bashkive nuk kanë raportuar asnjë iniciativë për bashkëpunim me bashki fqinje ose në nivelin rajonal. Numrin më të madh të bashkëpunimeve e ka Bashkia Krutë me 32 iniciativa dhe Korçë me 12.

Janë raportuar në total 102 pjesëmarrje në iniciativa të përbashkëta rajonale dhe Europiane me synim reduktimin e diferencave rajonale (programet e bashkëpunimit rajonal dhe transnacional. Ky numër i përket vetëm 41% të bashkivë, ku numrin më të madh e ka Bashkia Tiranë me 26. Treguesi ka përmirësim të dukshëm pasi në 2019 nuk janë raportuar pjesëmarrje në iniciativa të përbashkëta rajonale dhe Europiane.



Grafiku 71: Numri i bashkëpunimeve ndërmjet NJQV, 2020

Kutia 12:

Praktika të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar

Bashkia Përmet: Bashkia Përmet është pjesë e 4 projekteve të programeve IPA Cross-Border, bashkëpunime ndërkufitare Greqi-Shqipëri. Gjithashtu si pjesë e Forumi i Strategjise se Zhvillimit te Qendrueshem te Rajonit te Vjoses, ku marrin pjesë Bashkitë fqinje dhe qytetet brenda dhe jashtë vendit pjesë e luginës së Vjosës.

Bashkia Pogradec: Bashkëpunime në kuader të përbushjes së Rekomandimeve të UNESCO-s me: I. Joint World Heritage Centre/ICOMOS/IUCN. Reactive Monitoring mission to the World heritage property Natural and Cultural Heritage of the Ohrid Region II. Bashkinë Wissmar (Gjermani). Bashkëpunim në kuadër të Marrëveshjes së Binjakimit III. ECRI –në kuadër të programit ROMACTED IV. GVI-Global Ventures Investment: Qendra e Inovacionit pranë bashkisë Pogradec. V. Kaleiçi Muratpasa Municipality –Arts and Promotion of the city of Pogradec (Cultural Heritage).

Bashkia Shkodër: I. Anëtarësimi në forumin e qyteteve që ligen nga deti Adriatik dhe Jon, FAIC II. Bashkëpunimi me Hungarian Watertechnology Cooperation për çështje që kanë të bëjnë me ujësjellës kanalizime. III. Bashkëpunimi me Bashkinë e Strasburgut, pjesë e rrjetit europian të solidaritetit – IV. Klubi i Strasburgut në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. V. Bashkëpunimi me Bashkinë e Triestes në kuadër të projektit Yes Future. VI. Bashkëpunimi me rajonin Emilia Romagna në kuadër të projektit DEAR. VII. Bashkëpunimi me rajonin Friuli Venezia Giulia për liqenin e Shkodrës, etj.

Bashkia Tropojë: Bashkia Tropojë është përfshirë në programe të bashkëpunimit rajonal me Kosovën kryesisht për emergjencat dhe turizmin dhe me Malin e Zi ku u fitua projekti i thirrjes IPA II për bimët medicinale ku komuna e Plavës është lider.

Rekomandime

- Forcimi i bashkëpunimit midis NJQV-ve në kuadrin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar për të rritur mundësitë për të përfituar nga fondet IPA.
- Përcaktimi në mënyrë të qartë i kompetencave vendore, rajonale dhe qendrore me qëllim që të shmanget mbivendosja e tyre dhe të ketë një harmonizim të strukturave në çdo nivel.
- Krijimi i instrumentave financiarë dhe metodologjikë të bashkëpunimit rajonal për nxitjen e e pjesëmarrjes së bashkive në inisiativa rajonale dhe ndërkombëtare.
- Rritja e bashkëpunimit të midis institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor për një zhvillim më të mirë rajonal dhe kohezionin social.

PËRFUNDIME MBI POLITIKAT RAJONALE

Politika rajonale është mjeti kryesor i BE-së për të investuar në ekonomi të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse rritje. Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të bëjnë më shumë përpjekje në drejtim të forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndër-rajonal, dhe të harmonizojnë veprimet për çështje ndërbashkiake, si mjedisi, transporti, mobiliteti, eficienta energjitike, dhe shkëmbim eksperience për praktika të mira.

Pjesëmarrja e bashkive në programet e financuara në kuadër të programeve të BE-së ka ardhur në rritje por duhet më tepër bashkëpunim për projekt-propozime dhe për partneritete në thirrjet në kuadër të programeve IPA dhe programe të tjera. Ende më pak se gjysma e Bashkivë janë përfshirë në bashkëpunime të përbashkëta rajonale dhe Europiane me synim reduktimin e diferencave rajonale.

Miratimi i ligjit “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin” ka shënuar një progres domethënës për zbatimin e strategjisë së zhvillimit të balancuar të rajoneve në përpunje me politikën e BE-së të zhvillimit dhe kohezionit social. Megjithatë në kuadrin institucional, duhen miratuar aktet nënligjore përkatëse për krijimin e një politike rajonale gjithëpërfshirës duke përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e secilit prej aktorëve të përfshirë në politikën e kohezionit.


3.8 Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

“Në lidhje me të drejtat themelore, Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor në përputhje me standardet evropiane. Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria është përpjekur të përmbushë detyrimet që lidhen në këtë kuadër. Megjithatë, zbatimi i përgjithshëm mbetet për t’u forcuar. Sa i takon zbatimit të ligjit “Për strehimin social”, janë miratuar nëntë akte nënligjore pas një procesi të gjerë konsultimi. Edhe kuadri ligjor për fushat e të drejtave të njeriut dhe drejtësisë për të miturit është përmirësuar përmes akteve nënligjore. Po vijohet me përpjekjet për të zbatuar një reformë gjithëpërfshirëse të sektorit të tokës dhe për të konsoliduar të drejtat e pronësisë¹²⁷”. Progresi në ushtrimin e funksioneve dhe rolit të NJQV për këtë fushë vlerësohet mbi bazën e 47 treguesve të performancës për gjashtë objektiva specifike.


Objektivi specifik: forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve

Zbatimi i Programit Kombëtar për të drejtat e fëmijëve 2017-2020 ka njohur arritje të qenësishme në drejtim të plotësisimit të kuadrit ligjor dhe të politikave që synojnë promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në të gjithë sektorët: drejtësi, shërbime shoqërore, arsim, shëndetësi dhe kulturë. Risia që ka sjellë Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” është mandati i qartë i strukturës së Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF) dhe ngritja e mekanizmit lokal për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në marrjen e masave të mbrojtjes dhe në menaxhimin e rastit¹²⁸.

Në 2020 janë raportuar 53 Bashki që kanë ngritur Njesisë e Mbrojtjes së Fëmijëve në administratën vendore. Njësia rezultoi e pa ngritur ende në shtatë bashki¹²⁹ ndërsa bashkia e Shijakut nuk ka dhënë informacion mbi këtë tregues.




Harta 16 NJMF e ngritur në NJQV



Harta 17 Sistemi i monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve

127 Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)
 128 Raporti i zbatimit të Agjencës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017- 2020, MSHMS
 129 Fushë-Arrëz, Konispol, Mat, Patos, Polican, Roskovec, Sarandë,



Grafiku 72: Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve e ngritur në Bashki krahasuar 2017-2020

Sistemi i monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në territorin e bashkisë është funksional në 72% të Bashkive. Treguesi ka shënuar progress nga 68.85% që ishte në 2019; Ndërkohë që 13 Bashki nuk e kanë ngritur ende sistemin e monitorimit dhe 4 bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme¹³⁰.


Mesatarisht janë kryer 13.5 takime të përbashkëta të grupeve ndërdisiplinore në nivel bashkie (N = 58¹³¹) për rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, nga 10.85 që ishte në 2019 dhe 2018. Numri gjithsej i rasteve të identifikuara dhe të trajtuara për shkelje të të drejtave të fëmijëve është raportuar 1,134 ose mesatarisht 19.55 raste (N=58). Numri i rasteve ka pësuar ulje nga viti 2019 ku janë raportuar mesatarisht 21.84 raste dhe në vitin 2018 mesatarisht 24 raste të identifikuara. Numrin më të madh e raportojnë Bashkia Tiranë me 371 raste, Bashkia Durrës me 146 raste dhe Bashkia Fier me 101 dhe Shkodër 100 raste.

Shkalla mesatare e urdhërave për mbrojtje të lëshuara ndaj numrit të rasteve të identifikuara është rreth 39.61% (N=59). Referuar shërbimeve të posaçme, mesatarisht për 40.42% të rasteve të identifikuara të fëmijëve, bashkitë kanë mundësuar ofrimin e shërbimeve të veçanta. Treguesi ka rritje nga 2019 ku shërbimet ishin ofruar në 31.86% të rasteve, por përsëri mbetet e ulët shkalla e ofrimit të shërbimeve kundrejt rasteve të identifikuara.

Mesatarisht, 2.63% e buxhetit për mbrojtjen sociale është përdorur nga NJQV për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve (N=54); Treguesi ka pësuar ulje nga 4.04% në 2019 dhe 2018. Pesë bashki nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin¹³².

Bashkitë kanë raportuar 177 punonjës (N=59) në 2020, ose mesatarisht 3 nëpunës vendorë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Treguesi ka progres nga viti 2019 por është i njëjtë me atë të vitit 2018. Numri i punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) është miratuar 235 në të gjithë vendin. Bashkitë Vlorë dhe Shijak nuk kanë ofruar të dhëna.

Në vitin 2020, janë organizuar në total 361 aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve ose mesatarisht 6.12 aktivitete (N = 59), por rënie krahasuar me vitin 2019. Numrin më të madh të aktiviteteve e ka Bashkia Shkodër me 65 aktivitete të organizuara në 2020.



Grafiku 73: Aktivitete të organizuara nga NJQV për promovimin e të drejtave të fëmijëve, 2017-2020


130 Bashkitë Vlorë, Tepelenë, Shijak dhe Krujë
 131 Bashkitë Vlorë dhe Shijak nuk kanë raportuar të dhëna për të gjithë treguesit
 132 Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Maliq, Pogradec

Problemet dhe sfidat


- Burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe kapacitetet e ulëta të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel local.
- Mungesa e një planifikimi buxhetor koherent me nevojat për trajtimin e rasteve të dhunës apo mbrojtjen e fëmijëve në gjithë territorin e Bashkisë.
- % e buxhetit për mbrojtjen sociale të përdorur nga NJQV për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve mbetet në nivele shumë të ulëta.
- Sistemi i monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve nuk është ende funksional në të gjitha bashkitë.
- Funksionimi jo i plotë i grupeve ndërdisiplinore në nivel bashkie për rastet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve.
- Aktivitetet ndërgjegjësuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve kanë ardhur në ulje dhe të pamjaftueshme.
- Bashkëpunimi jo i vazhdueshëm me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe institucionet e tjera ndërkombëtare me mision mbrojtjen e fëmijëve.

Rekomandime

- Përmirësimi i sistemit të monitorimit dhe përmirësimi i shërbimeve publike, shërbimeve ligjore dhe psikologjike për mbrojtjen e fëmijëve.
- Ndërgjegjësimi dhe mobilizimi i institucioneve publike dhe jopublike në nivel qendror dhe vendor për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës.
- Rritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor në lidhje me zbatimin e legjislacionit, procedurat e mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin proaktiv dhe bashkëpunimin ndër-sektorial.
- Sigurimi dhe ofrimi i shërbimit të ndërhyrjes dhe të pritjes për të ndihmuar fëmijët 24 orë në ditë nga të gjitha bashkitë në nivel kombëtar.
- Krijimi i grupeve ndër-sektoriale (shumë-disiplinore) për të ofruar shërbime për fëmijë në secilën bashki dhe njësi administrative.
- Krijimi i grupeve të punës (nga punonjësit e institucioneve ose të organizatave vendore) për të identifikuar fëmijët në situatë rruge në të gjithë vendin.
- Monitorimi dhe kontrolli i mediave që publikojnë raste që kanë të bëjnë me çështjet e fëmijëve (për të ruajtur parimin e konfidencialitetit dhe për të shmangur ri-viktimizimin e fëmijës).



Grafiku 74: Sistemi i monitorimit të rasteve për diskriminim në territorin e Bashkive 2017-2020



Grafiku 75: Sistemi i monitorimit të rasteve të identifikuara të diskriminimit është ngritur në 24 Bashki në vitin 2020

Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Në vitin 2020 trajnimet për nëpunësit vendorë mbi ligjin 10221/2010 dhe aktet nën ligjore kanë pësuar rritje me 256 persona në total ose mesatarisht 4.65 për Bashki (N=55). Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e ka bashkia Krujë me 101, Elbasani me 45 dhe Lezhë me 22.¹³³ Ndërkohë 21 bashki nuk kanë ndjekur trajnime mbi ligjin kundër diskriminimit.

Sistemi i monitorimit të rasteve të identifikuara të diskriminimit është ngritur në 24 Bashki në vitin 2020 me vetëm dy bashki më shumë krahasuar me 2019. Sistemi i monitorimit të rasteve është një instrument për trajtimin efektiv të rasteve nga nëpunësit vendorë në bashkërendim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹³⁴.


Grafiku i mësipërm karahasues për periudhën 2017-2020 evidenton progress shumë të ngadaltë në ngrijen e sistemit të monitorimit në territorin e Bashkive. Numri total i Bashkive mbetet ende i ulët me vetëm 39% e Bashkive që kanë një sistem monitorimi për rastet e diskriminimit.

Në 2020 kanë vazhduar fushatat ndërgjegjësuere të organizuara nga NJQV në shkolla dhe komunitete për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI. Janë organizuar në total 21 aktivitete nga vetëm 11 bashki¹³⁵. Numri fushatave është në rritje krahasuar me 14 fushata në 2019.

Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 96/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e pakicave etnike”

Në vitin 2020 sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave është ngritur dhe është funksional në 20 bashki nga 12 që ishin në 2019.¹³⁶

- Në 2020 janë organizuar 163 aktivitete të ndryshme kulturore dhe fushata ndërgjegjësimi për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike ose mesatarisht 2.76 për bashki (N=59)¹³⁷.
- Ka vazhduar trajnimi i nëpunësve të cilët punojnë me pakicat etnike rome dhe egjiptiane, për 31 bashki ose 50 % me një rritje krahasuar të konsiderueshme krahasuar me vitin 2019 ku kanë marrë trajnime vetëm 23% e bashkive. Numrin më të madh të trajnimeve e kanë Bashkitë Korçë, Himarë dhe Delvinë me nga 3 secila.




Grafiku 76: Sistemi për monitorimin e rasteve për shkelje të së drejtës së pakicave 2017-2020

133 Bashkitë Fushë-Arrëz, Këlcyrë, Rrogozhinë, Shijak, Vlorë, Maliq nuk kanë dhënë informacion
 134 Bashkitë Vlorë, Shijak, Fushë-Arrëz, Durrës, dhe Cërrik nuk kanë dhënë informacion
 135 Peqin, Memaliaj, Libohovë, Lezhë, Krujë, Korçë, Këlcyrë, Kavajë, Elbasan, Durrës, Divjakë
 136 Bashkitë: Vlorë, Shijak, Sarandë, Memaliaj, Maliq, Durrës, nuk kanë dhënë informacion
 137 Bashkitë Shijak dhe Pustec nuk kanë dhënë informacion


Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të punës ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e minoriteteve Rome dhe Egjiptianë 2016-2020

- Në 2020 janë trajnuar gjithsej 31 nëpunës civil të administratës lokale për angazhimet e Bashkisë për Planin Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët. Mesatarisht 1person i trajnuar për bashki (N=56).
- Në 2020, rreth 44% e bashkive kanë raportuar se plani i veprimit për integrimin e pakicave etnike rome dhe egjiptiane në nivel vendor është hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak, treguesi ka rritje me +9.8 p.p. në krahasim me 2019. Bashkite Shijak, Malësi e Madhe dhe Maliq nuk japin ansjë informacion për këtë tregues.
- Në vitin 2020, trajnimet për grumbullimin e të dhënave dhe raportimin në kuadër të sistemit ROMALB janë ndjekur nga 72 nëpunës (N=53); treguesi është në nivel të krahasueshëm me vitin 2019 ku ishin 46 nëpunës të trajnuar. Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e ka Bashkia Tiranë me 18, dhe Bashkia Korçë me 7.
- Në 2020, shfrytëzimi i rregullt i sistemit ROMALB për statistika dhe analiza, si dhe raportim për vendimmarrjen e Bashkisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është raportuar nga 33 bashki.




Grafiku 77: Plani lokal i veprimit për përfshirjen e R&E, 2017-2020


- Rreth 22% janë përfitues R/E nga programet e strehimit social ne bashki në raport me numrin gjithsej të aplikimeve për vitin e raportimit.
- Në 2020 janë 77 projekte, ose mesatarisht 1.33 projekte për bashkitë përfituese janë zbatuar në mbështetje të pakicave rome dhe egjiptiane nga 65 projekte vitin 2019. Numrin më të madh e ka Bashkia Tiranë me 23 projekte.
- Numri i përgjithshëm i punëkërkuessve të regjistruar pranë zyrave vendore dhe rajonale të Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim ka qenë 27436 (N = 49). Ky tregues ka pësuar një rritje të konsiderueshme (nga 7362 punëkërkuess në 2019. Numri i të punësuarve nga pakicat R&E në total është 837 pra vetëm 3% e punëkërkuessve.
- Numri i të punësuarve të pakicave rome dhe egjiptiane nga shërbimet e bashkisë dhe në projekte publike është 280, ose 33.5% e numrit gjithsej të të punësuarve nga këto komunitete në vitin 2020. Numrin më të madh të punësuarve në institucionet e bashkisë të komunitetit R/E e kanë Bashkia Kamëz me 74, Bashkia Dibër me 45, Pogradeci me 35 dhe Përmet 28.



Harta 18 PV për Integrimin e pakicave, 2020



Grafiku 78: Numri i përfutuesve R&E nga programet e strehimit, 2020



Grafiku 79: Numri i të punësuarve R/E në institucionet e Bashkisë gjatë vitit 2020


Problemet dhe sfidat

- Burime të pakta financiare për të mbuluar shërbimet ligjore në përputhje me Ligjin «Për mbrojtjen nga diskriminimi».
- Numri i ulët i organizatave të shoqërisë civile të specializuara që ofrojnë shërbime për qytetarët në luftën kundër diskriminimit dhe njohjen e të drejtave të minoriteteve.
- Qëndrueshmëri e ulët financiare në bashki për ofrimin e shërbimeve pas përfundimit të projekteve të financuara nga donatorët, c'ka ndikon ndjeshëm në qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara dhe mungesën e tyre për qytetarët.


Rekomandime

- Rritja e bashkërendimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore në zbatim të kartës evropiane të të drejtave të njeriut dhe edukimi qytetar.
- Rritja e burimeve njerëzore pranë shërbimit social të bashkive për çështjet e pakicave rome dhe egjiptiane për të kryer vizitat në terren.
- Miratimi i planeve vendore për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane në PBA.
- Përdorimi i sistemit ROMALB nga të gjitha bashkitë.

- Në 2020, numri i programeve të trajnimit për çështjet e barazisë gjinore (programe të ofruara nga ASPA dhe ofrues të tjerë) është raportuar 293 në total ose 4.97 trajnime për bashki (N=59) me një rritje krahasuar me vitin 2019 me mesatarisht 3 trajnime për bashki.
- Për rastet e raportuara dhe të identifikuara të viktimave të dhunës në familje, bashkitë ofrojnë shërbime të specializuara në qendra komunitare të përkujdesit social, shërbime me psikologë dhe trajtime të tjera; në vitin 2020 janë ofruar 441 Shërbime (N=59) me një rritje rreth 4 herë më shumë në krahasim me 2019. Numrin më të madh të shërbimeve e ka Bashkia Kamëz me 179 në total, pasuar nga Gjirokastra me 50 dhe Kavaja me 48.
- Bashkitë përditësojnë të dhënat rregullisht në sistemi REV-ALB dhe raportojnë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Janë bërë në total 490 raportime (N=52) ose mesatarisht 9.42 raportime për Bashki. Numrin më të madh të raportimeve e ka Bashkia Korçë me 110 dhe Pogradeci me 61. Vetëm 40 Bashki kanë deklaruar numrin e raportimeve ndërkohë, 8 Bashki nuk kanë asnjë të dhënë dhe bashkitë e tjera kanë vlerë 0.
- Raportime për çështje të barazisë gjinore në MSHMS janë kryer nga 55 bashki me një total prej 146 raportimesh ose mesatarisht 2.65 raportime për bashki; Numri i raportimeve ka pësuar ulje në krahasim me 2019që ka qënë në total 298 ose mesatarisht 5.84 (N=51) dhe në 2018 në total 487 ose mesatarisht 8.85 raste (N=55).
- Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile janë realizuar në total 250 aktivitete kundër diskriminimit gjinor ose mesatarisht 4.46 aktivitete për bashki (N=56). Treguesi ka një rritje të lehtë nga 206 aktivitete në 2019. Numrin më të madh të aktiviteteve e kanë Bashkitë Shkodër (28), Lezhë (25) dhe Malësi e Madhe (20). 34% e bashkive nuk kanë patur aktivitete.




Grafiku 80: Shërbime të specializuara të ofruar nga NJQV për viktimat e dhunës në familje, 2020




Grafiku 81: Aktivitete të Bashkive dhe OSHC për diskriminimin gjinor, 2020

- Në vitin 2020, janë raportuar gjithsej 501 shërbime për menaxhimin e rastit ose mesatarisht 9.28 për bashki (N=54). Treguesi ka rritje gati 50 % me vitin 2019 ku janë raportuar 230, ose mesatarisht 4.34 shërbime. Bashkia Kamëz raporton numrin më të madh me 179 shërbime pasuar nga Kavaja me 88.
- Në 2020 janë raportuar 732 kopshte dhe çerdhe që kanë marrë shërbime për mirëmbajtje dhe rindërtimi nga bashkitë (N=57) ose mesatarisht 12.84 për bashki¹³⁸. Treguesi ka rënie nga viti 2019 me 1,032 kopshte dhe çerdhe kanë patur gjatë vitit 2019.
- Vetëm 7.24% e buxhetit të bashkive (N=51) është alokuar në vitin 2020 për çështje të mbrojtjes së viktimave nga dhuna në familje. Fondi ka pësuar rënie të dukshme në karahasim me vitin 2019 ku është raportuar 25.53% (N=47).
- Janë ndërmarrë në total 231 aktivitete për promovimin e barazisë gjinore dhe në zbatim të Kartës Evropiane për barazinë e personave M/F në jetën vendore ose mesatarisht 3.92 aktivitete për Bashki (N=59). Treguesi shënon rritja nga viti 2019 me 198 aktivitete.



Grafiku 82: Numri i shërbimeve sipas menaxhimit të rasteve, 2020



Grafiku 83: Aktivitete promovimi për barazinë gjinore, 2017-2020


138 Bashkitë Shijak, Maliq dhe Mallkaster nuk kanë raportuar të dhëna.

Edhe pse me hapa të ngadaltë konstatohet progress në krijimin e infrastrukturës së aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe. Mesatarisht 33% e shkollave të sistemit para-universitar kanë infrastrukturë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe (N=58), i krahasuar me 2019 traguesi ka rritje me 6 p.p. Treguesi varion në një shkallë të gjerë nga 100% në 1%; ndërkohë që 15% e bashkive kanë raportuar zero përqind (9 bashki) dhe tre bashki nuk kanë ofruar të dhëna¹⁴⁰.


Në 2020, vlera mesatare e raportit të institucioneve publike të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe kundrejt numrit

gjithsej të institucioneve në nivel vendor ka qenë 36 % (N=59), ose 3 p.p. krahasuar me 2019; Rreth 10 % e bashkive kanë raportuar zero përqind infrastrukturë publike të aksesueshme¹⁴¹.


Në 2020 janë raportuar 240 nëpunës vendorë të punësuar në strukturat e përkrahjes dhe mbrojtjes sociale për PAK, ose meatarisht 4 nëpunës për bashki (N=59) me një rritje prej 80% krahasuar me 2019 . Bashkitë Sarandë dhe Kukës kanë raportuar zero nëpunës për PAK dhe bashkitë Shijak dhe Vlorë nuk kanë ofruar të dhëna.



Grafiku 84: Numri i shkollave të aksesueshme për fëmijët me aftësi ndryshe, 2020



Grafiku 85: Shkalla mesatare e aksesueshmerise së infrastrukturës shkollore nga fëmijët me aftësi ndryshe 2017-2020




Grafiku 86: Shkalla e institucioneve publike të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe, 2020

140 Bashkitë Shijak, Maliq dhe Bulqizë nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin


141 Bashkitë Bulqizë dhe Shijak nuk kanë dhënë informacion

Rreth 28.8% është mesatarja e infrastrukturës rrugore e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe në raport me gjatësinë e rrjetit urban në territorin e bashkisë (e shprehur në përqindje të km rrugë urbane. Treguesi shënon rritje me 5.4 p.p. krahasuar me 2019. 13 bashki kanë raportuar zero përqind rrugë urbane të aksesueshme, ndërsa 8 bashki¹⁴² nuk kanë ofruar të dhëna. Bashkitë Roskovec dhe Vau i Dejës raportojnë se 100% e rrugëve urbane janë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe.


Në 2020 është raportuar për hërë të parë lidhur me numrin e qendrave historike dhe kulturore në territorin e Bashkisë të pajisura me infrastrukturën e duhur për personat me aftësi ndryshe. Në total raportohen 179 qendra historike dhe kulturore të pajisura me infrastrukturën e duhur nga të cilat 100 janë raportuar nga Bashkia Roskovec. Rreth 38% e bashkive (23 bashki) kanë raportuar se nuk kanë infrastrukturën e duhur dhe 6 bashki¹⁴³ nuk kanë dhënë asnjë informacion.



Grafiku 87: Nëpunës vendor për çështje të personave me aftësi ndryshe, 2020



Grafiku 88: Shkalla e rrjetit urban e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe, 2020



Grafiku 89: Numri i qendrave historike dhe kulturore të aksesueshme nga personat PAK, 2020

142 Berat, Bulqizë, Fushë- Arrëz, Maliq, Pustec, Rrogzhinë, Shijak, Vlorë
 143 Divjakë, Mallkastër, Memaliaj, Shijak, Tepelenë, Vlorë

Problemet dhe sfidat

- Mungesë e burimeve të mjaftueshme njerëzore për të mbuluar nevojat e këtij grupi të synuar në nivelin vendor.
- Mbeten sfida zhvillimi i një databaze në nivel kombëtar për grumbullimin e të dhënave për personat me aftësi ndryshe.
- Rritja e nivelit të aksesueshmërisë në shkolla, institucione publike dhe shërbime të ndryshme, përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe objekteve kulturore.
- Krijimi i më shumë instrumentave dhe mundësive për punësim në përputhje me nevojat dhe aftësitë për punë të PAK me qëllim rritjen e punësimit të tyre.
- Në institucionet bazë mungon aksesimi për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të marrin edhe ata shërbimin e duhur në kohë dhe me cilësi.

Rekomandime

- Rekomandohet ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve referuese, vlerësuese dhe monitoruese dhe koordinimi ndër-institucional i reformës së sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuara.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e arsimit, formimit profesional, punësimit si dhe me shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, integruese, rehabilituese, etj. për të krijuar një rrjet mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara.
- Bashkëpunimi me organizatat që ofrojnë shërbime psiko-sociale do të ketë të bëjë me rekomandime për shërbime për individët pranë këtyre organizatave, shkëmbimin e informacionit lidhur me vlerësimin, si edhe marrjen e informacionit nga këto ofrues shërbimesh për përfituesit.
- Ngritja e kapaciteteve për personelin përgjegjës vendor për përdorimin e sistemit të integruar të informacionit dhe asistimin e NJQV nga SHSSH.
- Përmirësimi i koordinimit midis aktorëve të ndryshëm në nivel lokal dhe qendror si dhe monitorimi periodik i shërbimeve të përkujdesit shoqëror që ofrohen për kategoritë në nevojë.
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në mënyrë që të lehtësohet aksesimi Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe i infrastrukturës shkollore që përmbush standardet për fëmijët me aftësi të kufizuara.

PËRFUNDIME MBI GJYQËSORIN DHE TË DREJTAT THEMELORE

Progres është shënuar në plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”; Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”¹⁴⁴, të cilët përcaktojnë të drejtat dhe shërbimet që gëzon çdo fëmijë, si dhe mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, janë plotësuar me të gjitha aktet nënligjore në zbatim të tyre. Sistemi i monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve në territorin e bashkisë është funksional në 72% të Bashkive duke shënuar progress nga 68.85% që ishte në 2019.

Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm që ka pësuar kuadri ligjor, veçanërisht atij për luftën kundër dhunës në familje, zbatimi efektiv i tij në praktikë mbetet një sfidë, sidomos në lidhje me vlerësimin e riskut dhe lëshimin e urdhrave për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme. Për më tepër, mbetet i rëndësishëm ngritja e mekanizmave të përshtatshëm në nivel qendror dhe lokal të përfshirjes efektive të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Një vend të veçantë në drejtim të luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe parandalimit, por edhe adresimit të diskriminimit ndaj grave ka zënë kontributi i organizatave të shoqërisë civile, përmes shërbimeve të mbështetjes dhe monitorimeve të vepërimitarive institucionale. Këto organizata kanë konstatuar se, situata e pandemisë vështirësoi aksesin e viktimave të dhunës në familje në sistem dhe në disa raste Mekanizmat e Koordinuar të Referimit janë gjendur të papërgatitur për t’iu përgjigjur rasteve me masa të menjëhershme dhe të përshtatura, me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje. Institucionet përgjegjëse për barazinë gjinore në nivel qendror dhe mekanizmat kundër dhunës në familje vuajnë nga mungesa në burime njerëzore dhe financiare¹⁴⁵.

Sistemet që gjenerojnë të dhëna në lidhje me viktimat e dhunës në familje rezultojnë se nuk janë të sinkronizuara ndërmjet tyre. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, fuqizimi i strukturave të barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje, zgjerimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe buxhetimi i shërbimeve, janë disa nga rekomandimet më të rëndësishme që adresohen në këtë raport si të domosdoshme, me qëllim përmirësimin e zbatimit të legjislacionit kundër dhunës në familje. Krijimi i sektorit të barazisë gjinore vazhdon me ritme të ngadalshme, ndërkohë që në bashkitë ku janë ngritur këto struktura konstatohet një rritje rreth 4 herë më shumë të numrit të shërbimeve të ofruara në krahasim me 2019.

Megjithëse, gratë dhe vajzat përballen me diskriminim për shkak të gjinisë dhe/ose të shumëfishtë, përdorimi i mjeteve ligjore si ankesa për Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi apo paditë drejtuar gjykatës kanë qenë instrumente të kufizuara dhe pak të përdorur. Në 2020 vetëm 39% e Bashkive që kanë një sistem monitorimi për rastet e diskriminimit brenda territorit të Bashkisë së tyre.


Lidhur me zbatimin efektiv i ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara” rëndësi të veçantë ka forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional me strukturat e arsimit, formimit profesional, punësimit si dhe me shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, integruese, rehabilituese, etj. për të koordinuar përpjekjet për të krijuar një rrjet mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, bashkëpunimi me organizatat që ofrojnë shërbime psiko-sociale për shërbime për individët pranë këtyre organizatave, shkëmbimin e informacionit lidhur me vlerësimin, si edhe marrjen e informacionit nga këto ofrues shërbimesh për përfituesit. Në 2020 nuk ka patur progres në miratimin e Planit Vendor për Përfshirjen Sociale të Personave me Aftësi Ndryshe dhe planifikimi i tij në PBA.

144 <https://e.vendime.al/ligj-nr-1212016-per-sherbimet-e-kujdesit-shoqeror-ne-republiken-e-shqiperise/>
145 Vlerësimi i të Drejtave të Njeriut dhe Shtetit të së Drejtës teksta Shqipëria kryeson OSBE-në, Raport i OSHC Janar 2021


Progres është bërë nga bashkitë për ngritjen e Këshillit të Sigurisë Vendore gjatë 2020, si një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar tashmë i ngritur në rreth 72% të Bashkive. Treguesi ka rritje të konsiderueshme +23 p.p. më shumë krahasuar me 2019.

Ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet në secilën njësi administrative raportohet me një mesatare prej 35.4% (N=48). Ndërkohë janë 13 Bashki që nuk kanë ofruar informacion për këtë tregues i vendosur në raportimin e këtij viti për herë të parë.


Numri i rasteve të referuara pranë Zyrës së Policimit në komunitet nga qytetarët në total në vitin 2020 kanë qënë 3,345 ose mesatarisht 81,59 raste për bashki (N=41). Numrin më të madh të rasteve të referuara e ka Bashkia Tiranë me 1944 raste. Edhe ky tregues është raportuar për herë të parë në 2020 ndaj ka mungesë të theksuar raportimi nga 20 Bashki.



Grafiku 90: Hartimi i dokumentit të strategjise për sigurinë publike në periudhën 2017-2020



Harta 24: Këshilli i Sigurisë Vendore kundër krimit të organizuar



Grafiku 91: Ngritja e Këshillave të Sigurisë Vendore: 2017 - 2020

Kutia 13: Praktika të mira në funksionimin e Këshillit të Sigurisë Vendore dhe Policimit në Komunitet

Bashkia Dropull: Këshilli i Sigurisë Vendore është ngritur në Janar të vitit 2020. Kryesuar nga kryetari i bashkisë, këshilli vendor i sigurisë përbëhet nga aktorë vendorë që përfaqësojnë policinë e shtetit dhe atë bashkiake, shërbimet sociale, arsimin, shërbimet shëndetësore, shërbimin pyjor dhe mjedisin, prefekturën, shoqërinë civile, bashkësitë fetare, komunitetin e biznesit, mediat lokale, grupet vullnetare, dhe organizata të tjera vendore. Këshilli vepron sipas një rregulloreje të miratuar nga anëtarët e saj, ku përcaktohet qëllimi dhe struktura si dhe modalitetet e funksionimit, sekretariati, bashkëpunimi dhe raportimi.

Bashkia Kamëz: Këshillit për Sigurinë Vendore përbëhet nga një grup drejtorish, shoqëri civile, OJF, komisarati etj sipas rregullores të miratuar nga Bashkia duke specifikuar detyra të ndryshme, të cilat i janë lënë drejtorive përkatëse.

Bashkia Klos: Këshilli i Sigurisë Vendore konsiston në cdo problematikë që mund të përballë komuniteti i Bashkisë Klos.

Bashkia Librazhd: Këshilli i Sigurisë Vendore është miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak. Përfaqësues janë nga të gjitha institucionet, bashkia, policia, komunitetet fetare etj.

Bashkia Patos: Bashkia ka ngritur Komisionin Vendor për Sigurinë Publike ku marrin pjesë përfaqësues nga Policia e Shtetit, Bashkia, përfaqësues të Shoqërisë Civile etj. Ky komision zhvillon mbledhje të përvitshme.

Bashkia Mallakastër: Njesia e policimit në komunitet është ngritur për secilën njësi administrative.

Bashkia Berat: Në të gjitha njësitë administrative janë funksionale Zyrat e Policimit në komunitet

Bashkia Dibër: Zyrat e policimit në komunitet janë ngritur në çdo NJ.A.

Bashkia Tropojë: Zyrat e Policimit në komunitet janë ngritur në bashki dhe në shtatë njësitë administrative.

Problemet dhe sfidat

- Për disa bashki mbetet sfida krijimi i grupit të punës në luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit.
- Mungesë e personelit të kualifikuar për luftën ndaj Krimit të Organizuar.
- Bashkëpunimi i ulët me autoritetet e tjera publike dhe mungesa e fushatave ndërgjegjësuere në komunitet.
- Mungesa e Strategjive të Sigurisë Publike për një pjesë të bashkive ka krijuar sfida në menaxhimin e situatës.
- Funksionimi i Këshillave të Sigurisë Vendore jo në mënyrë të organizuar dhe eficiente.
- Sfidë është ngritja dhe funksionimi i zyres së policimit në komunitet.
- Sigurimi i burimeve njerëzore dhe financiare për trajnimin e grupeve të punës dhe për zbatimin në terren të rregullores “ Për përbërjen , detyrat , përgjegjësit dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit Vendor Për Sigurinë Publike”.
- Mbetet sfida krijimi i një databaze për mbajtjen e të dhënave të sakta për numrin e rasteve.

Rekomandime

- Rritja e kapaciteteve të Këshillave Vendore të Sigurisë Publike për të funksionuar në mënyrë të plotë dhe për të pasur një ndikim më të madh në sigurinë publike.
- Ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet në të gjitha bashkitë dhe në secilën njësi administrative.
- Vendosja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm midis të gjithë aktorëve vendorë, përfshirë shoqërinë civile, policinë, shërbimet sociale, etj., për të identifikuar dhe trajtuar çështjet e komunitetit vendor mbi sigurinë personale dhe për të rritur sigurinë publike.
- Të ofrohet mbështetje me ekspertizë për të rritur aftësitë e anëtarët të Grupeve të Punës dhe KK si struktura vendore në luftën kundër krimit të organizuar.
- Funksionimi i plotë i shërbimit të policimit në komunitet. Forcimi i bashkëpunimit për menaxhimin e rasteve me të gjithë partnerët e përfshirë në proces.

PËRFUNDIME MBI DREJTËSINË LIRINË DHE SIGURINË

Çështjet e lirisë dhe sigurisë në komunitet gjithnjë e më shumë po orientohen drejt prioriteteve të agjendës së Shqipërisë për anëtarësimin në BE. Në këtë kuadër progres është bërë në ndërtimin e një koncepti të ri të shërbimeve të të gjithë aktorëve në lidhje me sigurinë publike. Ky koncept synon që të krijojë një marrëdhënie të re ose të përforcojë përgjegjësitë aktuale të të gjithë aktorëve përkatës të tillë si organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, institucionet ligjzbatuese, Policisë së Shtetit si dhe rolin të qytetarëve, komuniteteve, si dhe institucionet e tjera jo qeveritare, duke përfshirë organizatat jo qeveritare, forumet qytetare, bizneset, institucionet fetare, mediat etj. Progres është bërë nga bashkitë për ngritjen e Këshillit të Sigurisë Vendore gjatë 2020, si një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar tashmë i ngritur në rreth 72% të Bashkive.

Progres i moderuar është bërë lidhur me hartimin dhe miratimin e Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor nga 62% e bashkive. Ky dokument është në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, ku theksohet siguria në komunitet është përgjegjësi e të gjithë aktorëve përgjegjës në këtë fushë dhe në përputhje me standardet dhe eksperiencat më të mira perëndimore.

Ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet ende mbetet në nivele të ulta (30 %) . Ngritja e kësaj strukture në të gjitha bashkitë dhe Njësitë Administrative do të luajë një rol të rëndësishëm në sigurinë publike dhe në garantimin e rendit dhe sigurisë, me një koncept më demokratik duke bërë bashkë të gjithë aktorët institucionalë qendrorë dhe vendorë.

3.10 Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura


“Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e arsimit dhe kulturës. Është bërë ca progres lidhur me zbatimin e rekomandimeve nga raporti i mëparshëm në këtë fushë, veçanërisht për krijimin e një kuadri politikash për arsimin parashkollor. Lidhur me arsimin dhe formimin profesional (AFP), është shënuar ca progres me krijimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, ristrukturimi i Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, zbatimin e Ligjit Kuadër të Kualifikimeve dhe miratimin e legjislacionit zbatues për ligjin e AFP-së. Gjithashtu, është miratuar strategjia për kulturën për periudhën 2019-2023¹⁴⁷”.

Referuar pikës 12 të nenit 23 të ligjit nr. 139/2015, të ndryshuar, administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe e kanë njësitë e vetëqeverisjes-vendore. Ndërkaq, klasat përgatitore janë nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Gjithpërfshirja ka qenë në fokus të politikave arsimore në Shqipëri, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël.

Shkollat ende nuk përmbushin gjithë standardet e gjithëpërfshirjes, si infrastruktura dhe ambientet fizike në shkolla, kurrikula, vlerësimi, pajisjet për aftësinë e kufizuar. Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore janë të lidhura kryesisht me: (i) Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; (ii) Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Në Këshillin Konsultativ të vetëqeverisjes qendrore dhe vendore në vitin 2020 është diskutuar projektvendimi “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme”.



Grafiku 92 Numri i fëmijëve/nxënësve në arsimin para-universitar sipas niveleve
Burim: Ministria Arsimit dhe Sportit

Objektivi specifik: rritja e pjesëmarrjes në klasa përgatitore për arsimin parashkollor

Në vitin 2020, kanë funksionuar 1658 kopshte në total, ose mesatarisht 28.1 kopshte (N=59)¹⁴⁸. Treguesi ka një rritje të lehtë krahasuar me 2019 ku janë raportuar 1614 kopshte. Numrin më të madh vazhdon ta ketë bashkia Elbasan me 103 kopshte dhe Tirana me 95.


Në 2020 raportohet se vetëm 8.14 % e kopshteve janë mbi kapacitetet e lejuara (mbipopullim). Përqindjen më të lartë të mbipopullimit e raportojnë Bashkia Krujë me 62% dhe Bashkia Pukë me 50%. Ndërkohë 23.61% e kopshteve janë me numër fëmijësh nën kapacitetet e lejuara sipas raportimeve të Bashkitë në total (N=56).

Raportet mesatare në nivel kombëtar raportohen të jenë:


- Raporti mesatar fëmijë/edukatorë në zonën urbane është 14,74 (N=53)
- Raporti mesatar nxënës/mësues në zonat urbane është 12,96 (N=49)¹⁴⁹
- Raporti mesatar nxënës/mësues në qytetin - qendër e bashkisë është 15,56 (N=48)
- Raporti mesatar iL nxënësve/klasë në zonën është 18,14 (N=49)

Shkalla e regjistrimi të fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor në nivel kombëtar, në vitin e raportimit është 67% (N = 52¹⁵⁰). Treguesi ka ulje në krahasim me 2019 që ka qënë në nivelet e 75% dhe 2018 në 71%. Në 2020 raportohet se bashkitë kanë ndërmarrë 223 fushata ndërgjegjësimi ndaj prindërve ose mesatarisht 3.91 për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor. Numrin më të madh e ka Bashkia Berat me 104 fushata.

- Në 2020 ka patur ulje të ndjeshme të fondit të alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja në vetëm 2.36 % (N=53). Rreth 52% e bashkive (32 bashki) kanë raportuar zero përqind fond. Treguesi ka ulje me fondin vendor të planifikuar në 2019 ka qënë më vlerë mesatare 6.73% por edhe me 2018 (2.9%).
- Në 2020, numri i fëmijëve të rregjistruar në arsimin bazë që i përkasin grupeve të marxhinalizuara është raportuar në total 9,850 (N=48) ose mesatarisht 205 fëmijë për Bashki. Numri ka pësuar ulje me vitin 2019 ku janë raportuar 19,917 fëmijë të regjistruar.




Grafiku 93 Numri i kopshteve sipas NJQV, 2020



Grafiku 94 Shkalla e regjistrimit të fëmijëve të grup moshës 3-6 vjec, 2020

148 Bashitë Shijak dhe Vlorë nuk kanë raportuar
 149 Raportimi ka probleme pasi disa Bashki kanë raportuar për numrin e nxënësve disa për raportin nxënës/mësues
 150 Nuk kanë raportuar bashkitë Shijak, Patos, Mat, Mallakastër, Maliq, Malësi e Madhe, Fushë-Arrëz, Dimal, Devoll




Grafiku 95 Shkalla e Rregjistrimit të fëmijëve të grup moshës 3-6 vjec, 2017-2020

Objektivi specifik: rritja e pjesëmarrjes në institucionet e arsimit të detyrueshëm për fëmijët e grupeve të marxhinalizuara

Në 2020, numri i raportuar i fëmijëve të grup-moshës së arsimit të detyrueshëm që i përkasin grupeve të marxhinalizuara është 9,850 nga të cilët 1,393 ose 14.14% është numri i fëmijëve braktisës të shkollës të grup moshës së arsimit bazë që i përkasin grupeve të marxhinalizuara, duke rezultuar në 86% që kanë ndjekur rregullisht shkollën. Treguesi ka rritje në krahasim me vitin 2019 ku vetëm 52.8% të fëmijëve të grupeve të marxhinalizuara kanë ndjekur rregullisht shkollën.

Janë 8 bashki që nuk kanë parashikuar infrastrukturën për PAK dhe 6 bashki që nuk raportojnë asnjë të dhënë¹⁵¹. Treguesi ka përmirësim nga viti 2019 e infrastrukturës shkollore për fëmijët me aftësi ndryshe ishte planifikuar nga 67.2% e bashkive.

Mesatarisht është alokuar 5.64% e fondit të investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstrukcionin e shkollave ekzistuese në raport me buxhetin vendor të miratuar në vitin 2020. Treguesi shënon ulje nga viti 2019 ku fondi i parashikuar për rindërtimin e shkollave ekzistuese ose ndërtimin e shkollave të reja ka qënë mesatarisht 7.55%.




Grafiku 96 Numri i fëmijëve në Bashki të arsimit bazë që i përkasin grupeve të marxhinalizuara, 2020

Objektivit specifik: Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes në shkollat e arsimit parauniversitar

Treguesi mbi përfaqësimin e nëpunësit të bashkisë në bordin e shkollës ka pësuar rritje duke shkuar në nivelet e 95% ose 3.2 p.p. më shumë në krahasim me 2019. Nuk ka të dhëna të vlefshme për treguesin “nisma të bashkisë për të mbështetur ngritjen e komunikimit shkollë-prindër-qeveri”.

Parashikimi i infrastrukturës PAK në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në bashki është bërë nga 77% e bashkive.



Grafiku 97: Përfaqësues i bashkisë në vendimmarrjen e shkollave, 2017-2020

151 Cerrik, Finiq, Libohovë, Maliq, Shijak, Skrapar,

Problemet dhe sfidat

- Fonde shumë të pakta nga disa bashki për ndërtimin dhe rikonstrukcionin e ndërtesave të kopshteve dhe shkollat e arsimit parauniversitar.
- Mungesa e infrastrukturës adekuate në kopshte e shkolla sidomos në sistemin e ngrohjes dhe mirëmbajtjes së godinave.
- Kapacitete të pamjaftueshme për kopshte me ushqim dhe fjetje në mënyrë që të plotësohen të gjitha kërkesat e prindërve.
- Distanca e largët e shtëpive në zonat e thella rurale nga kopshtet gjë që e bën të pamundur frekuentimin e femijeve ne institucioneve parashkollore (Bashkia Gramsh).
- Vështirësia për të rregjistruar në asrsimin parashkollor vecanërisht fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjyptian si një prioritet për integrimin e këtyre komuniteteve në arsim.
- Mungesa e infrastrukturës për sigurimin e aksesit në Personave me Aftësi të Kufizuar në disa institucione arsimore.
- Koordinim jo i mirë institucional në nivel local për të mundësuar përfundimin e arsimit bazë nga të gjithë fëmijët romë dhe egjyptianë.

Rekomandime

- Përmirësimi i kopshteve dhe i aksesit në arsimin parashkollor në zonat rurale. Është e rëndësishme të sigurohet infrastruktura e nevojshme dhe aksesit në zona të thella pa arsim parashkollor, në mënyrë që të përmirësohen mundësitë e arsimimit të të gjithë fëmijëve brenda territorit të bashkisë.
- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave duke planifikuar dhe akorduar më shumë buxhet për këtë qëllim. Pajisja me laboratorët e mësimdhënies, arritja e standardit për numrin e fëmijëve në klasë, krijimi i shkollave miqësore për fëmijë, prindër dhe komunitet.
- Hartimi i politikave për barazimin e mundësive arsimore për fëmijët që janë pjesë e grupeve vulnerabël dhe zhvillimi i një sistemi vendor (veprime konkrete) për përfshirjen sociale të të tyre.
- Bashkitë duhet të ndërmarrin nisma për të rritur vetëdijësimin shoqëror dhe gjetja e mekanizmave vendorë për të ndërtuar kanale komunikimi ndërmjet prindërve, mësuesve dhe bashkisë në mënyrë që të rriten njohuritë dhe vetëdijësimi për arsimin, si dhe ngritja e zërit për shqetësime të ndryshme.
- Rritja e kapaciteteve të administratës vendore për monitorimin dhe raportimin vjetor mbi përgjegjësitë dhe detyrat e NJQV në mirëadministrimin e kopshteve dhe shkollave ; bërja publike e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të bashkisë.
- Krijimi i qendrave rinore për të rinjtë, të cilët nuk kanë pothuajse asnjë ambient argëtimi në qytetet e vogla. Ndërtimi i bibliotekave/ose bërja funksionale e atyre ekzistuese, ndërtimi i fushave të sportit.

Objektivi specifik: Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale, thesari kombëtar i gjenerimit të popullit shqiptar

Me miratimin e Ligjit nr. 27/ 2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” filloi një reformë e thellë në menaxhimin e trashëgimisë kulturore dhe muzeve me qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare si dhe një ndryshim në tërësi i qasjes së shoqërisë ndaj pasurive kulturore. Objektivat kryesore të tij janë:

1. Decentralizim i administrimit dhe financimit të trashëgimisë kulturore dhe muzeve;
2. Licencim të vlerësuesve të pasurive kulturore;
3. Licencim të tregtarëve të pasurive kulturore, Akreditim i Muzeve, etj¹⁵².

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025 identifikon këto problematika kryesore të sektorit:

1. Shteti financuesi kryesor i institucioneve kulturore të varësisë dhe operatorëve të pavarur;
2. Infrastruktura e institucioneve kulturore jashtë standardeve;


3. Mungesa e kapaciteteve njerëzore në institucionet e varësisë dhe të operatorëve të pavarur;
4. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm mes institucioneve qendrore dhe vendore; (V)
5. Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i teknologjisë për informim dhe produkte kulturore.

- Rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore janë raportuar nga 7 bashki (ose 11.47%), gjithsej 35 raste (N=56). Është shqetësues fakti që treguesi shënon rritje me gati 46 % nga viti 2019 dhe 2018 me 6 raste të shkeljeve. Numrin më të madh e ka raportuar Bashkia Gjirokastrës me 17 raste ose 50% të totalit.
- Në vitin 2020, janë ndërmarrë gjithsej 106 masa kundër shkeljeve dhe masa të tjera për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore; (nga 978 masa në 2019). Numrin më të madh të masave të marra e ka Bashkia Korçë me 38, Bashkia Krujë me 34 dhe Bashkia Gjirokastrë me 17 masa të njëjtë me numrin e shkeljeve.

Objektivi specifik: mbështetja e krijimtarisë dhe veprimtarisë krijuese të artistëve shqiptarë përmes forcimit të veprimtarisë kulturore dhe përfshirjes së artistëve

Në vitin 2020, numri i aktiviteteve kulturore të miratuara nga Bashkia për promovimin e kulturës dhe traditës lokale si dhe në mbështetje të veprimtarisë krijuese të artistëve shqiptarë ishte në total 943 (N=58), por u realizuan më pak aktivitete, gjithsej 729 ose mesatarisht 12 aktivitete për bashki (N=60).

Treguesi varion në një shkallë të gjerë nga 194¹⁵³ në 1 aktivitet; Në vitin 2020 u organizuan më pak aktivitete kulturore, krahasuar me vitin 2019 ku janë raportuar 807 në total. Kjo situatë shpjegohet nga efekti i pandemisë dhe masave kufizuese të detyruara për t'u zbatuar si nga bizneset dhe bashkitë.



Grafiku 98: Aktivitete kulturore të organizuara nga NJQV, 2020

152 Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025
153 Bashkia e Tiranës

Problemet dhe sfidat

- Kosto e lartë e mirëmbajtjes së banesave që janë pjesë e fondit të trashëgimisë kulturore. Banorët e disa zonave dhe qyteteve të mbrojtura gjenden midis nevojës për përmirësim të kushteve të banesave dhe kërkesave për ruajtjen e autenticitetit të trashëgimisë kulturore.
- Kapacitete të kufizuara nga NJQV për ndjekjen e rasteve të shkeljeve dhe trajtimin e tyre.
- Mungesë të fondeve për të inspektuar si dhe për të ngritur një strukturë operative në Bashki për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në zonat e trashëgimisë kulturore.
- Burime të kufizuara financiare nga NJQV për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore ku pjesën më të madhe e mbulojnë fondet nga qeveria.
- Mungesa e bazës së të dhënave nga disa bashki për objektet e trashëgimisë kulturore në territorin e tyre.
- Niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe informimit të qytetarëve dhe subjekteve të ndërtimit mbi procedurat që duhet të ndjekin në zbatim të ligjit, me qëllim uljen e numrit të shkeljeve të kryera.
- Sfidë mbetet promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, mungesa e aktiviteteve dhe fushatave të ndërgjegjësimit.

Rekomandime:

- Hartimi i planeve të veprimit për zbatimin e strategjisë Kombëtare të Kulturës 2019-2025 në nivel vendor.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të pasurive kulturore. Evidentimi më i detajuar sipas llojit të monumentit dhe objektit me vlera të trashëgimisë kulturore.
- Aplikimi i skemave financiare mbështetëse që të mundësojnë ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore që janë në pronësi të qytetarëve.
- Rritja e kapaciteteve financiare për zhvillimin e aktiviteteve kulturore të miratuar nga bashkia për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare.
- Rritja e fondit vendor për restaurimin e objekteve me vlera të veçanta dhe rritja e kapaciteteve inspektuese të NJQV për të parandaluar shkeljet dhe ndërtimet e paligjshme.
- Aplikimi i Instrumentave stimuluese, lehtësuese dhe financuese për bashkëpunime ndër -rajonale dhe ndër-kufitare.

PËRFUNDIME PËR ARSIMIN DHE KULTUREN

Është zhvilluar legjislacioni për sektorin e arsimit parauniversitar dhe siguruar decentralizimi i kompetencave në nivel vendor. Megjithë përpjekjet për të rritur pavarësinë e institucioneve vendore në menaxhimin e sistemit të arsimit parashkollor sërish varësia e financiare nga qeveria qendrore mbetet e lartë duke çenuar thellë cilësinë e shërbimeve.

Kapacitetet e pamjaftueshme financiare dhe burimet e kufizuara njerëzore e bëjnë akoma më sfiduese zbatimin e legjislacionit dhe objektivave të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 në nivel vendor. Mungesa e infrastrukturës adekuate dhe standarteve cilësore në ndërtesat e shkollave dhe kopshteve kanë ndikuar në uljen e cilësisë së edukimit. Sërisht, numri mesatar i nxënësve për mësues mbetet e lartë si dhe kapacitetet e shkollave dhe kopshteve në disa bashki vuajnë nga mbipopullimi. Shkalla e regjistrimit të fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor në nivel kombëtar, në 2020 është 67%, duke treguar rënie krahasuar me vitin 2019.

Mbetet sfidë rritja e fondit vendor për rindërtimin dhe mirë-

bajtjen e infrastrukturës shkollore dhe parashkollore, ulja e madhësisë së grupeve të fëmijëve në kopshte për një edukatore, rritja e numrit të edukatorëve. Në 2020 ka patur ulje të ndjeshme të fondit të alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja. Progres është shënuar në parashikimin e infrastrukturës PAK në projektet për rindërtimin dhe ndërtimin e shkollave në bashki. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore si dhe organizimi i aktiviteteve kulturore ka shënuar progres të ulët. Sërisht bashkitë ndeshen me pronblematikat e ndërtimeve të paligjshme apo shkelje të legjislacionit për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore. Përballë kësaj situatë janë strukturat e pushtetit vendor me burime njerëzore edhe financiare të pamjaftueshme. Mungesa e planeve vendore për menaxhimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe financimet e pamjaftueshme kanë sjelle një qasje jo eficiente në administrimin e tyre. Rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore shënuan rritje me gati 46% në krahasim me vitin 2019.

3.11 Kapitulli 27: Mjedisi dhe ndryshimi i klimës

“Shqipëria ka treguar një lloj niveli përgatitjeje në këtë fushë. Është bërë progres i kufizuar në lidhje me përafrimin e mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me acquis-në, në fusha të tilla, si menaxhimi i mbetjeve dhe ujit, krimi mjedisor dhe mbrojtja civile. Megjithatë, nevojiten ende përpjekje të konsiderueshme për zbatimin, veçanërisht për menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ujit dhe ajrit dhe ndryshimet klimatike¹⁵⁴”.

Gjatë vitit 2020 në Këshillin Konsultativ janë diskutuar aktet e mëposhtme ligjore: Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në Mjedisi”, miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr. 128/2020, dt:22.10.2020.

Projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”.

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 11.07.2012 “Për lëndfillet e Mbetjeve”, miratuar në Këshillin e Ministrave me VKM nr.846/2020.

Projektvendimi “Për miratimin e rregullave teknike në projektimin dhe ndërtimin për furnizimin me ujë dhe kanalizimin”. Projektvendimi “Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese përkatëse, flamurin, stemën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”.

Projektvendim “Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie”

Objektivi specifik: Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe menaxhimit të pyjeve


Përgjegjësitë e NJQV në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhen më sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, sigurimin e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike, dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese mbi mbrojtjen e mjedisit.

Në 2020, janë trajnuar gjithsej 90 nëpunës vendorë mbi legjislacionin dhe zbatimin e masave të politikave qendrore në fushën e mjedisit, ose mesatarisht 1.5 (N=60); treguesi mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2019 ku ishin trajnuar 88 nëpunës). Numrin më të madh të trajnimeve e ka Bashkia Tiranë me 13. Bashki pjesëmarrëse në trajnime kanë qënë 43 (ose 71%), katër bashki më pak krahasuar me 2019 (47).

Bashkitë kanë organizuar më pak fushata ndërgjegjësimi në mbrojtje të mjedisit dhe minimizimin e ndotjes në bashkëveprim më aktorë të tjerë vendorë dhe OSHC, në 2020: gjithsej 221 fushata, mesatarisht 3.88 (N=57).

Objektivi specifik: Edukimi i gjeneratave të reja për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes

Në 2020, nga bashkitë janë organizuar 167 fushata ndërgjegjësimi ose mesatarisht 2.93 (N=57)¹⁵⁵ për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes me shkollat e mesme dhe 9-vjeçare, në bashkëveprim me institucione të tjera dhe aktorë vendorë, përfshirë organizata të shoqërisë civile; Numri është në ulje me -114 fushata më pak , në krahasim me 2019 me mesatarisht 4.95 fushata.



Grafiku 99 Fushata ndërgjegjësimi për ruajtjen e mjedisit në shkolla, 2020

154 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)
155 Bashkitë Tiranë, Shijak, Maliq, Dimal nuk kanë raportuar për këtë tregues


Objektivi specifik: hartimi i planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit mjedisor në nivel lokal

Shqipëria duhet të bëjë më shumë përpjekje për të përafruar me acquis për cilësinë e ajrit, duke përfshirë edhe zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit të monitorimit të ajrit¹⁵⁶.

Bashkitë kanë detyrim të hartojnë planet vendore të veprimit në zbatim të politikave qëndrore për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Në 2020 janë vetëm 9 Bashki që raportojnë që kanë hartuar Planet e Veprimit ndërkohë që 48 Bashki raportojnë që nuk ekanë hartuar. Bashkitë që raportojnë për hartimin e planeve vendore janë: Shkodër, Rrogozhinë, Pukë, Polican, Peqin, Kavajë, Elbasan, Divjakë, Delvinë.

Vetëm 2 Bashki Elbasan dhe Shkodër të cilët kanë miratuar Planin e Veprimit kanë raportim të saktë për planifikimin e masave në PBA (nga 5 bashki të raportuara¹⁵⁷). Treguesi evidenton ulje nga 2019 dhe 2018 dhe pasaktësi në raportime për Bashkitë që nuk kanë miratuar Planin e Veprimit por raportojnë për përfshirjen në PBA të fondeve¹⁵⁸.

Në 2020, numri i masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit të përfshira në PBA është 19 (N=16) nga të cilat vetëm 5 bashkitë, Kucovë, Elbasan, Fier, Korçë dhe Shkodër kanë raportuar numrin e masave.



Harta 25: PV për përmirësimin e cilësisë së ajrit

Problemet dhe sfidat

- Numri i ulët i nëpunësve të kualifikuar dhe trajnuar për legjislacionin mjedisor në nivel vendor për zbatimin e legjislacionit në fushën së mjedisit të lidhura dhe me acquis të BE.
- Mungesa e planeve të veprimit dhe masave konkrete për zbatim apo veprimesh për përmirësimin e cilësisë së ajrit nga disa bashki.
- Pamjfatueshmëria e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese me publikun dhe shkollat nga ana e Bashkive si dhe përfshirja e ulër e nxenesve në aktivitete për trajtimin e ceshtjeve mjedisore.
- Bashkëpunim jo i vazhdueshëm me OJF që veprojnë në fushën e mjedisit si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara për çështjet mjedisore.

Rekomandime


- Miratimi sa më shpejt i Planeve vendore të veprimit për përmirësimin e cilësinë e ajrit nga Bashkitë që nuk e kanë miratuar dhe integrimi i masave në programet Buxhetore të tyre.
- Rritja e numrit të nëpunësve vendorë që kanë si funksion mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, në disa bashki.
- Rritja e fondit specifik për trajnime nga buxheti vendor për trajnimin e punonjësve të bashkisë në fushën e mjedisit dhe standarteve evropiane.
- Edukimi qytetar, edukimi i të rinjve në shkolla dhe rritja e bashkëveprimit me aktorë të tjere në nivel vendor dhe organizatat e shoqërisë civile.

156 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2020)
 157 Tre prej tyre nuk e kanë hartuar planin e veprimit
 158 Bashkitë Fier, Kucovë, Pogradec


Objektivi specifik: Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve është pjesërisht i harmonizuar me atë të BE-së. Mbyllja e shumë venddepozitimeve të papërshtatshme mbetet sfidë. Mbledhja dhe ndarja e mbetjeve dhe futja e instrumenteve ekonomike për të nxitur riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara. Ndërtimi i një inceneratori të ri përveç dy atyre ekzistues në Elbasani dhe Fieri paraqesinshqetësime në rritje për sa i përket pajtueshmërisë me acquis të BE-së për mbetjet duke përfshirë parimin e hierarkisë së mbetjeve dhe objektivat e riciklimit. Shqipëria duhet të promovojë ekonominë ricikluese dhe duhet të stimulojë parandalimin, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve për prerje poshtë land-filling. Zbatimi i legjislacionit për administrimin e mbetjeve duhet të përshpejtohet¹⁵⁹.


- 67.2% e bashkive (ose 41 Bashki) kanë raportuar se mbledhja e mbetjeve dhe depozitimi i tyre në landfield dhe fushat e depozitimit të miratuara është kryer sipas sipas planit vendor të menaxhimit të mbetjeve¹⁶⁰. Treguesi shënon rritje vetëm me 1 Bashki nga 2019.
- Mbetjet e riciklueshme depozitohen sipas objektivave të planit vendor për menaxhimin e mbetjeve (PVMIM) nga 21.3% e bashkive me një rritje +5 p.p. krahasuar me vitin 2019.
- Në 2020 janë raportuar 83 vend-depozitime të paautorizuara nga 17 bashki (ose 27.8% e bashkive); bashkitë e tjera (72%) kanë raportuar zero vend-depozitime të paautorizuara. Numrin më të madh me gati 50% të totalit e ka Bashkia Kukës me 40 venddepozitime jasht standardeve.



Grafiku 100 Vend-depozitime të mbetjeve të paautorizuara sipas NJQV, 2020



Grafiku 101 Vend-depozitime të autorizuara, 2020




Grafiku 102 Largësia maksimale e qëndrës së bashkisë nga vend-depozitimi më i afërt, 2020

159 Raporti i BE 2021
160 Bashkitë Tiranë e Durrës nuk kanë dhënë asnjë informacion për këtë tregues

Treguesi shënon progress nga 2019 ku janë raportuar 140 vend-depozitime të paautorizuara.

- 65 vend-depozitime të autorizuara janë përdorur nga bashkitë për depozitim e mbetjeve në 2020 (N=60) ose mesatarisht 1 vend-depozitim për bashki. Numrin më të madh e ka Bashkia Krujë me 4. Bashkia Shijak nuk ka raportuar për këtë tregues.
- Në 2020 ndarja e mbetjeve në burim në 2 kosha sipas legjislacionit bëhet vetëm nga 8 Bashki¹⁶¹ (nga 3 bashki në 2019 dhe 2 bashki të raportuara për 2018). Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka dhënë informacion.
- Largësia mesatare e qendrës së Bashkisë nga vend-depozitimi i miratuar është 21.41 km duke shënuar progress nga 17.97 km në vitin 2019 dhe 2018.



Harta 26: Ndarja e mbetjeve ne burim

Problemet dhe sfidat

- Kapacitetet njerëzore dhe burimet financiare tejet të ulëta të bashkive për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Monitorimi i dobët i kontratave koncesionare dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga operatorët private për menaxhimin e mbetjeve.
- Numri i lartë i vend-depozitimeve që nuk përmbushin standartet dhe në vende të pa lejuara.
- Pamundësia e bashkive për të realizuar ndarjen në burim të mbetjeve për shkak të kostos së lartë dhe mungesës së pajisjeve të duhura.
- Niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe edukimit qytetar, përfshirë dhe të rinjtë, për rëndësinë e ndarjes në burim. Edhe aty ku egziston infrastruktura banorët vazhdojnë që mbetjet ti hedhin të përzjera nëpër kontenierë.

Rekomandime

- Hartimi i planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga të gjitha bashkitë dhe integrimi i masave të tij në Programin Buxhetor Afatmesëm. Sigurimi i financimit dhe monitorimi i zbatimit të tij me efektivitet dhe efikasitet të lartë financiar.
- Monitorimi i vazhdueshëm nga Bashkitë të shërbimeve të operatorëve private dhe atyre koncesionare të kontraktuar për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, depozitimit dhe riciklitimit të mbetjeve.
- Shtimi i numrit të projekteve të investimit për riciklimin e mbetjeve në bashki apo qarqe dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore për realizimin në kohë të tyre.
- Bashkëpunimi më i mirë i organeve ligjzbatuese dhe administratës së bashkisë për të ndaluar aktivitetet e paligjshme dhe në dëm të mjedisit, lumenjve dhe shëndetit të popullatës.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit qytetar nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

161 Devolli, Durrësi, Gjirokastra, Korçë, Kurbini, Malësi e Madhe, Peqin, Polican


Objektivi specifik: Integrimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike në planet vendore në përputhje me përparësitë dhe objektivat kombëtare.

Qeveria Shqiptare ka miratuar në vitin 2019 Dokumentin Strategjik dhe Planet e Veprimit për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Dokumenti strategjik përmban detyrime për tu zbatuar në nivel vendor.


Në përputhje me prioritetet dhe masat kombëtare për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës, kërkohet që bashkitë, me risk më të madh, të hartojnë dhe përditësojnë planin vendor të masave për zbutjen e rreziqeve; rreth 19 % e bashkive kanë plan vendor të masave ose krahasuar me vitin 2019 janë 4 bashki më shumë.

Objektivi specifik: Rritja e aftësisë për t'u përshtatur me efektet sfiduese të ndryshimit të klimës në nivelin lokal

- Në zbatim të detyrimeve kombëtare që rrjedhin nga nënshkrimi i Konventës Ndërkombëtare për ndryshimet klimatike, në nivel vendor, vetëm 3 bashki Elbasan, Fier, dhe Shkodër kanë raportuar mbi buxhetin e shpenzuar për investime të projekteve (miqësore) që adresojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe uljen e shkarkimeve të CO2 në¹⁶².
- Në 2020, numri i specialistëve të punësuar dhe trajnuar në nivel vendor për ndryshimet klimatike, eficiencën e energjisë dhe energjitë e rinovueshme është në total 50 nëpunës ose më pak se 1 nëpunës mesatarisht në Bashki (N=50). Numri i specialistëve varion nga maksimalja 12 nëpunës në Bashkinë Klos dhe në disa bashki me vetëm 1 punonjës¹⁶³.



Harta 27: Plani vendor i masave për zbutjen e rreziqeve, 2020



Harta 28: PV mbi menaxhimin e qendrueshëm të fondit pyjor


162 Treguesi ka mangësi të mëdha në raportim nga bashkitë ku 58 bashki nuk kanë dhënë informacion
163 36 Bashki (59%) raportojnë 0 nëpunës specialist të emëruar për ndryshime klimatike

Objektivi specifik: Pyllëzimi i zonave të degraduara përmes riciklimit të destinacionit të burimeve pyjore dhe eliminimin e borxheve të subjekteve që veprojnë në fondin pyjor


Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë detyra që lidhen me administrimin e fondit pyjor vendor (nivel planifikimi), të tilla si hartimi i strategjive, planin e menaxhimit për fondin pyjor, programin e zhvillimit të sektorit dhe planin e mbarështimit të pyjeve vendore.

- Rreth 55.7% e bashkive (N=60)¹⁶⁴ kanë hartuar planin për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor, i cili integron dhe masat e mbarështimit të pyjeve, kullotave dhe bimëve mjekësore; treguesi evidenton rritje 8.2 p.p. krahasuar me 2019.
- Numri i përgjithshëm i specialistëve vendorë për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në 2020 është 394 ose mesatarisht 7 punonjës (N=58). Treguesi mbetet në nivele të njëjta me 2019. Siç shihet nga grafiku Bashkia Tiranë (34)


- dhe Bashkitë Tropojë e Maliq me (25) kanë edhe numrin më të madh të specialistëve të punësuar ndërsa bashkitë Fushë Arrëz, dhe Vlorë dhe nuk kanë raportuar për treguesin.
- Ndërmjet detyrave dhe përgjegjësiave të NJQV që lidhen me ushtrimin e funksionit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave është krijimi i databzës mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari dhe krijimi i kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor. Në 2020 janë 47 bashki (ose 77%) kanë ngritur databazën¹⁶⁵. Treguesi tregon rritje me 13p.p. në krahasim me 2019.



Grafiku 103 PV mbi menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor 2017-2020



Harta 29: Databaza për subjektet që ushtrojnë aktivitet mbi fondin pyjor dhe kullësor



Grafiku 104: Shkalla e punësimit të specialistëve të fondit pyjor sipas legjislacionit, 2020

164 Bashkia Fushë Arrëz nuk ka raportuar të dhëna për këtë tregues

165 Bashkitë Kamëz, Malësi e Madhe dhe Vorë nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin

Problemet dhe sfidat

- Hartimi i planit vendor për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor dhe mbarështimit të pyjeve dhe kullotave si pjesë e tij nga të gjitha bashkitë.
- Parashikimi i kostove shoqëruese të masave të planit vendor në dokumentin e planifikimit të buxhetit afat-mesëm (PBA)
- Rritja e numrit të punonjësve vendorë për administrimin dhe inspektimin e duhur të Fondit Pyjor dhe Kullor sipas standartit të përcaktuar me ligj.
- Sigurimi i trajnimeve për punonjësit vendorë për të rritur nivelin e profesionalizmit dhe zbatimin efektiv të kompetencave vendore.
- Rekrutimi i specialistëve për administrimin e fondit pyjor dhe kullor të bëhet sipas kërkesave ligjore dhe në nivelin e kuotave të kërkuara.

Rekomandime

- Të marren masa të menjëhershme për të rishikuar dhe përmirësuar ndikimin mjedisor dhe strategjik për projektet, planet dhe programet ekzistuese dhe të planifikuara, veçanërisht në sektorët e hidroenergjisë, ndërtimit, turizmit, transportit dhe minierave¹⁶⁸;
- Zbatimi i strategjisë kombëtare për ndryshimet klimatike dhe planeve përkatëse të veprimit për zbutjen dhe përshtatjen, miratimin e legjislacionit përkatës dhe zhvillimin e tij të integruar.
- Miratimi i Planeve vendore dhe përfshirja e masave në programin buxhetor për financimin e tyre në përputhje me objektivat e parashkuara në to.
- Forcimi i bashkëpunimit midis bashkisë dhe qytetarëve dhe përfshirja e tyre në aksione për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në veprime që synojnë monitorimin dhe ndikimin e ndotjes së mjedisit nga operatorët ekonomikë, dhe ushtrimi i presionit mbi ta për të ndërmarrë masa për të shmangur ndotjen.

Objektivi specifik: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimet¹⁶⁶

Ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve përballen me sfida të tilla si mungesa e licencimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të zeza, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme, të ardhurat e pakta dhe ndikimi i kufizuar për shkak të rrjetit të pazhvilluar të kanalizimeve si dhe lidhjet shtëpiake. Ekziston një nevojë urgjente për harmonizimin e plotë me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane, zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve, licencimi dhe aplikimi i tarifave adekuate për të gjitha impiantet e trajtimit dhe ndërtimit të ujërave të zeza të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare me zhvillim të lartë turistik¹⁶⁷.

Në vitin 2020 raportohet se:

- Mesatarisht 86.2 % e familjeve janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane. Bashkitë Tiranë, Pustec dhe Mamaliaj nuk kanë raportuar për këtë tregues.
- Mesatarisht 71.2% e familjeve janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat rurale. Vetëm Bashkia Tiranë nuk ka raportuar për këtë tregues.
- Nuk raportohet asnjë e dhënë për % e familjeve të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat urbane.
- Mesatarisht 23.42% % e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale
- Rreth 19.7 % e bashkive (ose 12 Bashki) raportojnë se Impianti i pastrimit të përpunimit të ujërave të zeza është i ngritur dhe funksional. Bashkitë Tiranë dhe Shijak nuk kanë raportuar.
- Mesatarisht 47.7% e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut është i rehabilituar dhe funksional.¹⁶⁹ Ndërkohë 21.3 % e bashkive¹⁷⁰ raportojnë 0% të rrjetit të kanalizimeve të ujërave.


166 Ky objektivi specifik është futur në matricën e vitit 2020 ndaj nuk mund të bëhen krahasime me vitet e mëparshme

167 Raporti i progresit i BE 2021


168 Raporti I BE 2021

169 11 Bashki nuk kanë raportuar për këtë tregues


170 Vorë, Mat, Mallakastër, Malësi e Madhe, Lushnjë, Kurbin, Kukës, Kucovë, Dropull, Dimal, Delvinë, Bulqizë




Grafiku 105: % e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane, 2020



Grafiku 106: % e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat rurale



Grafiku 107: % e familjeve të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale




Grafiku 108 % e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut i rehabilituar dhe funksional

Objektivi specifik: Rritja e kapaciteteve për përbalimin e emergjencave natyrore¹⁷¹


Miratimi i Ligjit për Mbrojtjen Civile në vitin 2019 solli krijimin në vitin 2020 Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile (NACP). Kërkohej një rishikim i shpejtë të strategjisë kombëtare, Planit kombëtar të Emergjencave Civile dhe planeve përkatëse të emergjencës prefekturale dhe lokale. Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme. Përmbajtjet e shpeshat në dekadën e fundit, tërmetet e vitit 2019, si dhe zjarret e fundit në pyje kanë nxjerrë në pah urgjencën e ndërtimit të sistemeve efikase të mbrojtjes civile dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe për të rritur qëndrueshmërinë e vendit ndaj fatkeqësive natyrore dhe krizave¹⁷².

- Në vitin 2020, janë 43 Bashki (71%) që raportojnë se kanë hartuar Planin Vendor për përbalimin e emergjencave civile në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile. Bashkitë që nuk raportojnë mbi këtë tregues janë tetë: Bashkia Tiranë, Shijak, Durrës, Divjakë, Vlorë, Himarë, Dropull, Devoll.

- Në vitin 2020, rreth 93% e bashkive kanë ngritur shtabin e emergjencave civile. Bashkia Memaliaj raporton që nuk e ka ngritur shtabin dhe dnërkohë janë tre Bashki Tirana, Shijaku dhe Kavaja që nuk raportojnë asnjë të dhënë.
- 88.5% e bashkive (54 Bashki) kanë ngritur strukturën e emergjencave civile. Nuk e kanë ngritur Bashkitë e Vorës, Sarandës, Memaliaj, Himarë dhe Durrës. Bashkitë Shijak e Tiranë edhe për këtë tregues nuk raportojnë
- Mbulimi i buxhetit për emergjencat civile nga Qeveria qendrore për vitin 2020 është mesatarisht 2.24 % e buxhetit të emergjencave civile. Ky mbulim është më i vogël se norma 4% e caktuar. Ndërkohë që 39% e bashkive raportojnë 0 % mbulim dhe 11 bashki nuk kanë të dhëna.
- 6.79 % është mesatarja e fondeve shtesë për emergjencat civile të alokuar për 39 bashki nga 53 që raportojnë në total. Bashkitë Divjakë, Durrës, Maliq, Memaliaj, Polican, Shijak, Vlorë dhe Vorë nuk kanë të dhëna.



Harta 39. Hartimi i Planit Vendor për përbalimin e emergjencave civile



Harta 40: Bashkia ka ngritur strukturën e emergjencave civile

171 Ky objektivi specifik është futur për herë të parë në matricën e vitit 2020 ndaj nuk mund të bëhen krahasime me vitet e mëparshme
172 Raporti i progresit i BE 2021

Problemet dhe sfidat

- Ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve përballen me sfida të mëdha si mungesa e licencimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të zeza, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme dhe të ardhurat e kufizuara për shkak të rrjeteve të pazhvilluara të kanalizimeve dhe lidhjet shtëpiake.¹⁷³
- Mungesa e projekteve të investimit nga qeverisja qendrore për disa bashki për të rehabilituar sistemin e ujësjellës kanalizimeve
- Performanca e ulët financiare e Shoqërive të ujësjellës kanalizimeve e cila ka sjelë në ofrimin e shërbimit jo cilësor.
- Infratsuktura e amorizuar dhe humjet e mëdha në rrejtin e ujësjellës kanalizimeve
- Ndërhyrjet e paligjshme të rrejtin e ujësjellës nga banorët/familjet dhe bizneët private
- Aktivitetet e pamjaftueshme dhe bashkëpunimi jo i mirë me OSHC për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit qytetar në raport me zbatimin e ligjit.
- Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme¹⁷⁴.

Rekomandime

- Monitorim i ngushtë dhe asistencë nga Ministria e Mbrojtjes për hartimin dhe miratimin e Planit Vendor për përballimin e emergjencave civile në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile nga të gjitha Bashkitë.
- Ekziston një nevojë urgjente për zgjerimin e rrejtin të kanalizimeve licencimi dhe aplikimi i tarifave adekuatë për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndërtimi i impianteve të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare me zhvillim të lartë turistik¹⁷⁵.
- Ngritja dhe bërja funksionale nga të gjitha bashkitë të strukturës së emergjencave civile dhe trajnimi i stafeve.
- Respektimi nga ana e Qeverisë Qendrore e detyrimit për mbështetjen e bashkive me fonde buxhetore për parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave civile.

173 Raporti i BE 2021

174 Raporti i BE 2021

175 Raporti i BE 2021

PËRFUNDIME MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMIN E KLIMËS

Me gjithë përpjekjet e bëra dhe në nivel qendror dhe vendor sërish ka patur progres të ulët në përmbushjen e objektivave dhe treguesve të fushës së Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike nga Njësitë e Qeverisjes Vendore. Ushtrimi i funksioneve të NJQV has në problematika të mëdha që lidhen me kapacitetet e ulëta njerëzore dhe financiare si dhe mungesa e programeve dhe projekteve zhvillimore të investimit.

Kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve është pjesërisht i harmonizuar me atë të BE-së dhe zbatimi i tij është në nivele të ulta. Mbledhja dhe ndarja e mbetjeve dhe futja e instrumenteve ekonomike për të nxitur riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara. Forcimi i kapaciteteve të bashkive për monitorimin efektiv të shërbimit të ofruara nga kontraktorë të jashtëm për shërbimin e mbetjeve dhe rritja e ndërgjegjësimit qytetar në mbrojtje të mjedisit është domosdoshmëri. Mbyllja e shumë venddepozitimeve të papërshtatshme mbetet problematikë edhe në vitin 2020.

Progress të ngadaltë ka patur për sa i përket hartimit të planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe marrjen e masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës. Niveli i pjesëmarrjes së bashkive në trajnime mbi zbatimin e masave të politikave kombëtare për ndryshimet klimatike ka qenë i kufizuar.

Pavarësisht investimeve në rrjetin e ujësjellës kanalizimeve sërish hasen problematika si mungesa e licensimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të zeza, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme, rrjeti i pazhvilluar i kanalizimeve dhe lidhjet shtëpiake. Ekziston një nevojë urgjente zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve, licencimi dhe aplikimi i tarifave adekuate për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe ndërtimin e impianteve të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare me zhvillim të lartë turistik.

Progres i kufizuar evidentohet lidhur me performancën e bashkive për administrimin e fondit pyjor vendor. Mbeten sfida hartimi i planit vendor për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor nga të gjitha bashkitë, parashikimi i tij në buxhetit afat-mesëm (PBA), si dhe rritja e burimeve njerëzore për këtë funksion sipas dispozitave ligjore.

Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme. Përmbytjet e shpeshta, tërmetet, si dhe zjarret e fundit në pyje kanë nxjerrë në pah urgjencën e ndërtimit të sistemeve efikase të mbrojtjes civile dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Progres është bërë në ngritjen e strukturave të emergjencës civile në vitin 2020, dhe strukturës së emergjencave civile. Financimi nga qeveria qendrore mbulon vetëm 2.24 % të buxhetit të emergjencave civile duke mos respektuar detyrimin ligjor për mbështetje në masën 4%.

3.12 Kapitulli 32: Kontrolli financiar

“BE promovon reformën e sistemeve të qeverisjes kombëtare për të përmirësuar përgjegjshmërinë menaxheriale, menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kontrollin e jashtëm të fondeve publike. Gjithashtu, rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së kundër mashtrimit në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe euros kundër falsifikimit.

Shqipëria është përgatitur mesatarisht në këtë fushë. Është bërë ca progres gjatë periudhës së raportimit, veçanërisht lidhur me ratifikimin e konventës ndërkombëtare për shtypjen e falsifikimit të monedhave dhe miratimin e një metodologjie të rishikuar për monitorimin e performancës së kontrollit të brendshëm. Megjithatë, Shqipëria nuk ka miratuar ende një dokument politik gjithëpërfshirës të kontrollit të brendshëm financiar publik, për t'u përqëndruar në llogaridhënien menaxheriale, dhe nuk ka bërë ndryshimet e nevojshme në legjislacion. Funksionimi i duhur dhe efektiv i kontrollit të brendshëm ende nuk është siguruar në të gjitha njësitë buxhetore”¹⁷⁶.

Gjatë vitit 2020, progress është bërë nga bashkitë në drejtim të planifikimit të buxhetit afatmesëm¹⁷⁷. Bashkitë raportojnë mbi përdorimin e fondeve publike sipas disa formateve të reja të menaxhimit financiar (Raport Monitorimi të Zbatimit të Buxhetit) dhe kanë hartuar raportet e performancës në ofrimin e shërbimeve publike, si një format miqësor i zbatimit të buxhetit (për vitin 2020, raportet e performancës u përgatitën nga 59% e bashkive).

Puna e NJQV në mbledhjen e të ardhurave, ka bërë që pesha e buxhetit vendor të rritet nga 2.5% e PBB-së në vitin 2013 në mbi 4% të PBB-së në 2020¹⁷⁸. Në vitin 2020, detyrimet e prapambetura të bashkive u reduktuan por mbetën mbi nivelin e synuar. U krye rishikimi dhe përmirësimi i paketave fiskale të NJQV dhe janë organizuar mjaft aktivitete të zhvillimit të kapaciteteve të bashkive për kontrollin e brendshëm dhe auditimin në nivel vendor, si dhe vlerësimin e nevojave për trajnime lidhur me planifikimin strategjik, monitorimin dhe vlerësimin e performancës mbi bazën e objektivave dhe treguesve, si dhe u hartua një Plan Kombëtar të të Dhënave Sistematike (NSPD) 2020-2027, i cili adreson nevojat për këtë vlerësim¹⁴⁸.

Gjatë vitit 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vazhdoi të forcojë masat për të siguruar përputhshmëri të angazhimeve (alokimeve të buxhetit) dhe kontrollit të shpenzimeve. Një grup pune u krijua për të monitoruar ecurinë e detyrimeve

të prapambetura dhe për të dhënë rekomandime sistematike. Gjithashtu, u rishikuan dokumenta të rëndësishëm lidhur me menaxhimin e kontrollit të brendshëm, si (a) Document të politikave në zhvillimin e mëtejshëm të KBFB (PIFC) për 2020-2021, (b) Instruksione në delegimin e detyrave, (c) Metodologji të Rishikimit të Cilësisë të kontrollit të brendshëm¹⁷⁹.

Bazuar në një vlerësim të kryer, në 2020, mbi bazën e përgjigjeve të 142 njësite të sektorit publike, rezulton se, nga 17 parime të kontrollit të brendshëm, 13 (trembëdhjetë) parime janë pjesërisht efektive dhe 4 (katër) prej tyre janë efektive. Është kryer standartizimi i rregullave të brendshme të njësite të qeverisjes së përgjithshme, nëpërmjet përcaktimit të qartë të detyrave dhe objektivave në përputhje me funksionalitetin e strukturave të kontrollit të brendshëm. 14 (katërmëdhjetë) bashki pilot kanë miratuar Grupin e Menaxhimit dhe Koordinimit të Riskut me rregulloren përkatëse mbi përgjegjësitë e drejtuesve dhe koordinuesve të riskut, procesin e vendimarrjes dhe monitorimit të risqeve deri tek Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Kryetari i Bashkisë.

Në vitin 2020, janë trajnuar rreth 160 persona, nëpërmjet trajnimeve të zhvilluara në bashkëpunim me Projektin e Financave Lokale në kuadër të zbatimit me rigorozitet të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin¹⁸⁰.

Rreth 67 njësi auditimi kanë raportuar gjetje dhe rekomandime mbi detyrimet e prapambetura për vitin 2020. Gjithashtu, një udhëzim u hartua mbi auditimin e detyrimeve i cili do të ndihmojë auditorët për të kryer më mirë kontrollet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet janë përfshirë në raportin vjetor të KBFB (PIFC). Përmirësime janë bërë në drejtim parashikimit të likuiditetit dhe monitorimit të tij. Pjesa më e madhe e rekomandimeve të Bankës Botërore dhe FMN për përmirësimin e parashikimit të kesh-it janë adresuar gjatë vitit 2020. Analiza e qëndrueshmërisë së borxhit është kryer në mënyrë të rregullt. Draft Strategjia afat-mesme për borxhin u hartuar gjatë vitit 2020 dhe u miratua në fillim të vitit 2021. Programi vjetor i huamarrjes nuk u miratuar për shkak të sfidave të mëdha që Drejtorja e Borxhit në MFE për shkak të instrumentave të lëshuar në 2020 për shkak të pandemisë COVID-19, kërkesës së rritur për likuiditet dhe largimeve të staftit¹⁸¹.

Më shumë Njësi Auditimi të Brendshëm u krijuan në institucionet e nivelit qendror dhe nivelin vendor; Rreth 77% e auditorëve të brendshëm u çertifikuan nga Komisioni për Kualifi-

176 Raporti i Progresit të KE (2020)

177 Raport progresi SNDQV, PV 2020-2022 (MB, 2021)

178 Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

179

180 Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (2020), MFE

181 Raport progresi i Strategjisë Menaxhimi i Financave Publike (2020)

kimin e Auditorëve të Brendshëm.


Pjesë e sistemit të kontrollit dhe auditimit të financave publike është mbikqyrja e jashtme e financave publike që ushtrohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), në përputhje me standartet ndërkombëtare INTOSAI, nëpërmjet auditimeve financiare dhe të performancës për të siguruar që vlera dhe përfitimet për shoqërinë janë maksimizuar.

Në vitin 2020, plani vjetor i auditimit u hartua mbi bazën “Metodologjia e planifikimit strategjik dhe vjetor të auditimit mbi bazën e riskut”. Gjithashtu, u përmirësua kuadri rregullator i KLSH, duke përfshirë rishikimin e manualeve të auditimit financiar dhe të performancës, rregullat e auditimit, dhe Regjistri Institucional i Rekomandimeve. KLSH ka evidentuar problematika në menaxhimin e fondeve, asetëve dhe pasurisë publike, si dhe përgjegjësitë përkatëse nga zyrtarët e çdo niveli të qeverisjes qendrore, vendore dhe enteve në varësi të tyre për 91 subjekte, përfshirë qarqe dhe bashki. Nga auditimi i subjekteve për aktivitetin auditues gjatë vitit 2020, është konstatuar dëm ekonomik, për shpenzimet dhe të ardhurat në vlerën gjithsej 167,708 mijë lekë, për të cilat janë rekomanduar gjithsej 64


masa, për t’u zhdëmtuar e gjithë vlera, në përqindje ndaj totalit sipas natyrës së shpenzimit. Janë rekomanduar 161 masa organizative, 90 masave disiplinore dhe 24 masa administrative¹⁸³.

Të ardhurat e pushtetit vendor pësuan rënie në vlerë absolute, gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë COVID-19, por në raport me të ardhurat publike janë rritur me 5.16% në vitin 2020, kundrejt 5.02% rritje në vitin 2019.

Rritja e potencialit ekonomik jo vetëm nga të ardhurat e veta të NJQV por edhe nga ato të buxhetit qendror janë një faktor shumë i rëndësishëm në nxitjen për rritjen e cilësisë së shërbimeve të pushtetit vendor. Në raport me vitin 2019, gjatë vitit 2020 transferata e pakushtëzuar ka pësuar një rënie të lehtë me rreth 430 milion lekë. Rënia e transfertës së pakushtëzuar vjen për shkak të rënies tërësore të produktit të brendshëm bruto gjatë vitit 2020, si pasojë e pandemisë, për shkak se transferata e pakushtëzuar është një tregues që llogaritet si përqindje e produktit të brendshëm bruto¹⁸⁴.



Grafiku 109 Të ardhura vendore në raport me totalin e të ardhurave publike dhe PBB
Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Financave Vendore



Grafiku 110: Të ardhurat nga transferata e pakushtëzuar, 2011 - 2020
(në milion lekë) Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/
Drejtoria e Financave Vendore¹⁸²


182 Raporti vjetor i financave publike vendore (MFE, 2021)

183 KLSH: Raporti vjetor (2020); <https://panel-klsh.almotech.co/storage/phpuzoCEn.pdf>

184 Raport Vjetor i Financave Publike Vendore (2020)

Efekti i pandemisë COVID-19 dhe ngadalësimi ekonomik gjatë vitit 2020 reflektohet në rënien e disa nga burimeve të rëndësishme për financimin e buxhetit vendor: me rreth 500 milion lekë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, 150 milion lekë nga taksa e zënës së hapësirës publike, dhe rënie me 270 milion lekë të të ardhurave jotatimore në raport me vitin 2019, ndërsa rritje pësuan të ardhurat nga tarifa e shërbimeve publike të ofruara nga bashkitë. Rreth 30 njësi të vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2020 kanë patur një rënie të të ardhurave të veta vendore kundrejt 2019. Normën më të lartë të rënies me rreth


61% me pak të ardhura e ka bashkia Libohovë, bashkia Lezhë me 57% (për shkak të rënies së turizmit) dhe bashkia Kamëz me 37%. Rreth gjysma tjetër e njësisë të vetëqeverisjes vendore kanë patur një rritje në norma të ndryshme të të ardhurave, ku normën më të lartë të rritjes e ka bashkia Pukë me 93% më shumë të ardhura dhe pas saj vjen bashkia Kukës me 36% më shumë të ardhura krahasuar me vitin 2019¹⁵². Norma mesatare e realizimit të të ardhurave të planifikuara vjetore, në vitin 2020, ka qenë rreth 73.3% (n=53)




Grafiku 111: Norma e ndryshimit të të ardhurave vendore të bashkive 2020/2019
Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e Financave Vendore

Shpenzimet gjatë vitit 2020 në raport me PBB, kanë pësuar rënie të lehtë prej 0.07% kundrejt vitit 2019. Gjithashtu, rënie patën shpenzimet e pushtetit vendor në raport me shpenzimet publike, me 1.8% kundrejt vitit 2019. Shpenzimet e pushtetit vendor, në 2020, pësuan rënie me rreth 8% në raport me vitin 2019 (ose me 5 miliard lekë më pak). Peshën më të madhe të shpenzimeve e zëne pagat dhe sigurime (rreth 43% të totalit të shpenzimeve vendore). Edhe shpenzimet për investime pësuan rënie me 4976 milion lekë në 2020/2019. Për financimin e shërbimeve publike, u rishikua buxheti për rialokime buxhetore duke ulur nivelin fillestar të investimeve të planifikuara.


Shkalla e realizimit të shpenzimeve publike në vitin 2020 ka qenë e ndryshme për bashkitë, rreth 39 bashki kanë patur rënie kundrejt vitit 2019. Bashkitë që kanë patur rënie më të madhe janë bashkia Vorë (me 44%), Bashkia Vau I Dejës (me 38%), Bashkia Kamëz (me 23%), ndërsa 22 bashki kanë patur rritje të shpenzimeve. Rritjen më të madhe e ka patur bashkia Rrogozhinë (48%), Bashkia Prrrenjas (27%). Norma mesatare e realizimit të shpenzimeve ka qenë rreth 76.9% (n=54) kundrejt 78.2% në vitin 2019¹⁸⁵.



Grafiku 112 Ndryshimi i shpenzimeve të pushtetit vendor në vite dhe në raport me totalin e shpenzimeve publike e PBB
Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Financave Vendore



Grafiku 113 Shpenzime sipas llogarive ekonomike të pushtetit vendor për vitin 2020/2019




Grafiku 114 Shkalla e realizimit të shpenzimeve të planifikuara vjetore

Detyrimet e prapambetura

Detyrimet e prapambetura të bashkive në fund të vitit 2020 ishin 6.9 miliard lekë (ose 1.2 miliard lekë më pak krahasuar me stokun e detyrimit në fund të vitit 2019¹⁸⁶).

Norma mesatare e ndryshimit të stokut të bashkive ka qenë 26.8% në 2020 kundrejt normës mestare të ndryshimit me 27% në 2019. Rreth 14 bashki raportojnë se nuk kanë detyrime të prapambetura¹⁸⁷. Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia Tiranë në vlerën rreth 762 milion lekë, e cila përbën 11% të totalit të detyrimeve, bashkia Kavajë në vlerën rreth 728

milion lekë, e cila përbën 10.5% të totalit të detyrimeve, bashkia Vorë në vlerën rreth 703 milion lekë, e cila përbën 10.1% të totalit të detyrimeve, bashkia Pogradec në vlerën rreth 339 milion lekë, e cila përbën 4.9% të totalit të detyrimeve. Sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 54.4%, kategoria “Të tjera” 17.3%, “Shërbime” 10.3%, dhe “Vendime Gjyqësore” 10%¹⁵⁴. Bashkitë kanë organizuar dëgjesa publike mbi realizimin faktik të buxhetit, gjithsej rreth 170 dëgjesa, ose mesatarisht 3 dëgjesa në vitin 2020 (n=55).



Grafiku 115 Norma e ndryshimit të shpenzimeve vjetore, 2020/2019

186 Raport Vjetor i Financave Publike Vendore (2020), MFE

187 Matrica e treguesve të performancës MFE (2020)

Kutia 14: Probleme dhe sfida të bashkive në menaxhimin financiar

Bashkia Mallakastër: Rritja e të ardhurave të arkëtuara.

Bashkia Pogradec: Plani i të ardhurave ka qënë i vështirë që të realizohej; gjithashtu dhe frenimi i shpenzimeve të bashkisë për shkak të situatës së pandemisë. Borxhet e prapambetura përfshijnë një pjesë shume të madhe në buxhet dhe duhet një financim nga qeveria pasi nga të ardhurat e bashkisë është e pamundur të likujdohen.

Bashkia Sarandë: Bashkëpunim nga dega e Thesarit, brenda afateve, për lirimin e fondeve dhe mos krijimin e vonesave në procedurat e prokurimit.

Bashkia Kamëz: Forcimi i kapaciteve të pushtetit lokal në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit të financave vendore.

Bashkia Selenicë: Ulja e detyrimeve financiare dhe menaxhimi i borxhit. Rritja e të ardhurave për vitin 2021. Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë ndaj palëve të treta konsiderohet sfidë parësore për vitin 2021.

Bashkia Shkodër, Përmet, Berat, Kurbin: Situata e pandemisë vështirësoi menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Bashkia Tropojë: Realizim 100% shpenzim e të ardhura pa difiçite. Likuidimin e detyrimeve dhe mos krijim të detyrime në vazhdim.

Bashkia Mirditë: Rritja e performancës në realizimin e të ardhurave me qëllim realizimin e shpenzimeve për të rritur nivelin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Përpjekje maksimale për të ulur borxhin, por mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara penalizon Bashkinë në lidhje me shlyerjen e borxheve si dhe krijon borxhe të reja.

Bashkia Patos: Planifikim sa më real dhe realizim në kohë i mbledhjes së të ardhurave

Bashkia Librazhd: Rritja e të ardhurave duke shtuar bazën e taksueshme në ndertesat, etj.

Bashkia Berat: Sfidat janë pagesat e detyrimeve të prapambetura, shmangia e krijimit të borxheve te reja, dhe rritja e burimeve të financimit nëpërmjet rishikimit të politikave vendore fiskale.

Bashkia Bulqizë: Në vitin 2021, është planifikuar që të mos ketë detyrime të prapambetura.

Bashkia Devoll: Ulje të stokut të borxhit deri në 50%.

Bashkia Roskovec: Sfidë është zvogëlimi i borxhit të prapambetur të Bashkisë kundrejt paleve të treta.

Bashkia Dibër: Angazhimi kryesor mbetet ulja e detyrimeve te prapambetura, në zbatim të VKM për krijimin dhe shlyerjen e borxheve te prapambetura.

Problemet dhe sfidat

- Situata e shkaktuar nga pandemia COVID-19 solli vështirësi për NJQV në realizimin e të ardhurave vendore dhe shpenzimeve kundrejt parashikimit në planin vjetor të buxhetit për vitin 2020.
- Realizim i plotë i shpenzimeve dhe të ardhurave pa difiçite dhe likuidimi i detyrimeve ndaj palëve të treta.
- Vihet re një mungesë e raportimeve periodike si dhe ndërhyrja e masave konkrete për adresimin e çështjeve në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm, gjë e cila evidenton nevojën për hartimin dhe miratimin e bazës rregullative në lidhje me raportet e përhershme, standarde që duhet ti raportohen drejtuesit si dhe menaxherëve të tjerë të strukturave; ka një mungesë progresi në menaxhimin e riskut, pavarësisht se shumica e njësive kanë hartuar një regjistër risku¹⁸⁸.
- Kapacitete të ulta financiare për disa bashki që kanë një stok të konsiderueshëm të detyrimeve të prapambetura për të cilat kërkojnë mbështetje nga qeveria.
- Bashkëpunim më i mirë me degët e Thesarit, për lirimin e fondeve, brenda afateve, dhe mos krijimin e vonesave në procedurat e prokurimit.
- Aplikim efektiv dhe sistematik i parimeve dhe instrumentave për menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kontrollin në përdorimin e fondeve publike dhe fondeve të BE.

Rekomandime

- Ruajtja e qëndrueshmërisë së Transfertsës së pakushtëzuar pavarësisht rënies së ndjeshme të Produktit të Brendshëm Bruto si pasojë e pandemisë COVID-19¹⁸⁹.
- Ruajtja e niveleve të të ardhurave të veta vendore në nivele të kënaqshme pavarësisht rënies ekonomike gjatë vitit 2020¹⁵⁶.

- Ruajtja e standardeve ligjore për buxhetimin mbi bazë programi dhe funksioni në të gjitha njësitë vetëqeverisjes vendore.
- Përmirësimi i funksionimit në praktikë për kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP/PIFC) dhe raportimit ndërmjet njësive buxhetore¹⁹⁰.
- Vlerësimi dhe menaxhimi aktiv i riskut me qëllim rritjen e ndikimit në minimizimin e situatave të pavaforshme. Për këtë është e nevojshme rritja e vëmendjes së menaxherëve për adresimin e problematikave të evidentuara¹⁵⁷.
- Përmirësimi i procedurave të monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe krijimin e një kulture të qëndrueshme në përdorimin më të mirë të fondeve publike¹⁵⁷.
- Realizimi i trajnimeve të vijueshme mbi zbatimin e kërkesave ligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe forcimi i mëtejshëm i objektivitetit dhe cilësisë gjatë procesit të vetëvlerësimit¹⁹¹.
- Rritja e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor përmes rritjes së cilësisë dhe përkundrejt standarteve të shërbimeve, administrimit dhe qeverisjes më të mirë të financave publike.
- Rritja e alokimit të buxhetit në shërbimet publike që kanë patur një fond më të vogël se 2% të buxhetit vendor, në vitin 2020, për shërbime të rëndësishme në konsultim me qytetarët (psh mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi dhe mbrojtja civile¹⁹²).
- Rritja e cilësisë së raportimit mbi performancën e shërbimeve me synim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me qytetarët dhe për autoritetet e bashkisë për një vendimarrje të informuar.
- Forcimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në menaxhimin e vështirësive financiare¹⁵⁶.

188 Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (2020), MFE

189 Raporti vjetor për financat publike vendore (2020)_MFE

190 Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)

191 Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (2020), MFE

192 Draft raporti mbi performancën e shërbimeve publike të ofruara nga NJVV (2020), SHAV

PËRFUNDIME MBI KONTROLLIN FINANCIAR

Përparim është bërë në shumicën e objektivave të Strategjisë të Menaxhimit Financiar Publik, pavarësisht situatës mbas tërmetit të 2019 dhe pandemisë COVID-19; Është përmirësuar baza rregullatore me synim lehtësimin dhe thjeshtëzimin e kriterëve me bazë risku për mobilizimin e të ardhurave, dhe ka vijuar puna për automatizimin e proceseve të taksave kryesore dhe procesin e fiskalizimit, si dhe përmirësimin e rregjistrimit për taksapaguesit. Gjithashtu përparim është bërë në drejtim të forcimit të sistemit për kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP/PIFC).

Ndërsa reforma e taksimit të pronës u vonua në 2020 (sipas parashikimit), draft ligji për taksën e pronës kaloi në proces konsultimi. Programe të politikave tatimore janë miratuar nga shumica e bashkive por më pak kontrolle/inspektimi janë kryer në biznese gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019.

Gjithashtu, në 2020, përparim është bërë nga bashkitë në drejtim të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe në drejtim të organizimit të dëgjësive publike për zbatimin e buxhetit (më shumë dëgjesa publike të organizuara në krahasim me vitin 2019).

Ndonëse të ardhurat vendore janë ulur në vlerë absolute në 2020, në raport me të ardhurat publike, ato janë rritur në 5.16% (kundrejt 5.02% në 2019). Detyrimet e prapambetura të bashkive u reduktuan por mbetën mbi nivelin e synuar.

Sfida për bashkitë mbeten realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe ulja e stokut të detyrimeve të prapambetura, ruajtja e standarteve ligjore për buxhetimin mbi bazë program, ofrimi eficient dhe cilësor i shërbimeve publike për qytetarët, zbatimi i rregullave për menaxhimin e financave publike duke siguruar disiplinë fiskale dhe raportimi i zbatimit të buxhetit mbi bazën e treguesve të performances, si dhe përmirësimi i procedurave të monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe krijimi i një kulture të qëndrueshme në përdorimin më të mirë të fondeve publike.

